

**Zgjerimi**  
Zaevi e do  
**BESËN** bashkë  
në Qeveri

Fq.3



**SISTEMIMI NË  
VENDE PUNE**  
Përfundon  
"pushimi" për  
958 administratorë

Fq.4



**"EFEKTI DOMINO"**  
i trajnerëve për  
gigandët e Evropës



# Koha

www.koha.mk



**Humori që të  
mban në  
këmbë**

Fq.12-13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3329 · e enjte 29 mars, 2018

3°C | 17°C

15 DEN

## FORUM

**Facebook-un  
siç nuk  
e njihni**



Një nga ngjarjet më të mëdha ndërkombëtare këtyre ditëve është çështja e gjithë të dhënave që eksitojnë në botën digjitale dhe si janë përdorur për qëllime politike. Për ta thënë më direkt, çdo "like" në Facebook, krijon gjurmë, nga të cilat, ata që i shohin mund të krijojnë profilin tuaj politik. Pra, preferencat tuaja zbulojnë preferencat politike dhe si rrjedhojë ju mund të "sulmoheni" me propagandë të targetuar veç ndaj jush, me qëllim që të ndryshoni mendjen dhe në fund të votoni kundër opsionit që preferoni...

Fq.10

## GLOBI

**Nataliteti në  
Gjermani më i  
larti në 20 vjet**

Fq.15

## RAJON

**Rusia ndërhyt  
në tensionet  
mes Kosovës  
e Serbisë**

Fq.14



## GJETJE TË REJA NË RASTIN E VRASJES SË ALMIRALIUT

# EKSPERTI PA LICENCË E LIROI BOBAN ILIQIN



Është vet kërkesa e Branislav Stefanovskit drejtuar Ministrisë së Drejtësisë që ka nxjerr dritë mbi të vërtetën e gjithë rastit. Stefanovski në Ministrinë e Drejtësisë kishte dorëzuar kërkesë për vazhdimin e licencës më 10 nëntor 2017, ose 17 muaj pas skadimit të licencës paraprake. Pikërisht në kohën kur i njëjti ka bërë ekspertizë, ai nuk ka poseduar licencë

Fq.5

## Diskriminim i fshehur për kompanitë shqiptare

Shkup, 28 mars - A mjafton mbështetja shtetërore prej 50 milionë euro për biznesin privat, që është parapa për siviljet? Kësaj pyetje i përgjigjen me skepticizëm si përfaqësuesit e biznesit privat, ashtu edhe analistët ekonomikë, të cilët vlerësojnë se një kujdes i shprehur nga ana e shtetit vetëm për 10 për qind të kompanive, nga 73 mijë kompani sa janë gjithsejt, është i pamjaftueshëm, por nuk mund të kon-

siderohet edhe si fakt i kryer. Fatmir Bytyqi, analist ekonomik, thotë se krijimi i një politike vetëm për 10 për qind të kompanive kundrejt 90 për qind të kompanive tjera, është politikë jofavorizuese dhe shumë e gabueshme. Edhe pse 10 për qind e kompanive që i plotësojnë kushtet për të aplikuar për ndihmën shtetërore në bazë të raporteve vjetore financiare të tyre, jam më se i sigurt se jo të...

Fq.7



## EDITORIAL

# VUÇIQI A KISHTË NË PLAN TA PUSHTONTE KOSOVËN?



Emin AZEMI

Dërgimi i një mesazhi kërcënues nga ana e presidenti Serb, Vuçiq, që kishte të bënte me arrestimin e Marko Gjuriqit nga ana e policisë speciale të Kosovës, ditën e hënë, nuk është thjeshtë vetëm retorikë luftënxitëse e Beogradit, që në këtë rast shprehej përmes paralajmërimit për të dërguar ushtrinë serbe në pjesën jugore të Kosovës, por edhe politikë e betonuar shtetërore serbe e kundrejt Kosovës.

"Presidenti Aleksandar Vuçiq kishte ndaluar depërtimin e mëtejshëm të forcave speciale shqiptare në veri të Kosovës e Metohisë dhe për të parandaluar eskalimin e dhunës, mesazhi ishte i qartë se ushtria serbe është e gatshme për të hyrë në provincën jugore, nëse njësia ROSU nuk tërhiqet mbrapsht në Prishtinë dhe nëse Marko Gjuriq nuk lirohet menjëherë", shkruan gazeta beogradske "Novosti", duke u thirrur në burime të veta pranë institucioneve qeveritare.

Ky kërcënim i hapur që nuk është bërë publik nga vetë Vuçiqi, por është transmetuar nga mediat, do të duhej të verifikohet nga zyrrat përkatëse në Bruksel, të cilat kohë më parë na kishin bindur se Serbia paska bërë përparime të dukshme dhe si e tillë ajo po i plotësoka disa kritere që nuk i kanë plotësuar vendet tjera të rajonit për të qenë më afër rrugës së anëtarësimit në BE. Nëse i bëjmë një lexim me hile kësaj retorike diplomatike të Brukselit, i bie që edhe vendet tjera të rajonit duhet të cenojnë nga pak sovranitetin shtetëror të fqinjëve, siç po bën Serbia me Kosovën, për të gëzuar dhe merituar përkëdhelinë e diplomacisë europiane.

Nëse informacioni i mësipërm del i saktë dhe nëse i njëjti nuk demantohet nga vet Presidenti serb, atëherë nuk është diçka në rregull me standardet e BE-së ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor, parasegjithash nuk është në rregull kur këto standarde në vetvete kanë kolizione, të shoqëruara me huti e paqartësi të panevojshme. Ajo që tash më është bërë refren i rregullt i diplomatëve të Brukselit sa i përket nevojës së përkushtimit ndaj kriterëve për përaftrim me BE-në, (një nga kriteret e Kopenhagës, ndërlikohet me fqinjësinë e vendeve të Ballkanit Perëndimor), e që duhet të jenë tregues nëse këto vende prodhojnë klimë mirëbesimi në mes veti për të qenë nesër pjesë e familjes europiane, apo veprojnë në kundërshtim me këtë klimë, siç po vepron aktualisht Serbia duke refuzuar ta heqë nga kushtetuta e saj Kosovën dhe duke e shantazhuar atë çdo ditë me kërcënime e provokime të natyrave të ndryshme.

Serbët lokalë të Kosovës, të instrumentalizuar skajshmërisht nga Beogradi tash së fundmi kanë dalë me një ultimatum që detyron Prishtinën për tre javë të punojë në Asociacion e Komunave Serbe, në të kundërtën komunat vetë do të fillojnë krijimin e këtij Asociacioni. Ky ultimatum shoqërohet me urdhra të Beogradit drejtuar Prishtinës, që nënkupton anashkalimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, dhe kalimin menjëherë në formimin e AKS. Nëse Prishtina nuk i përfill këto urdhra dhe sillet sipas frymës së Kushtetutës së Kosovës, atëherë Beogradi përmes serbëve lokalë do të bëjë edhe një agresion mbi sovranitetin territorial të Kosovës, duke instaluar boshnjizimin e saj.

A do të lejojë Brukseli dhe Uashingtoni një Bosnjë të dytë në Ballkan? Nëse vërtetë e kemi kuptuar drejt porosinë se duhet të jemi konstruktiv dhe parimor në sjellje dhe veprime për të zbrapsur influencimet ruse në rajon, atëherë edhe përgjigja e Brukselit e Uashingtonit do të duhej të jetë e qartë për të gjitha ato forca që duan ta përforcojnë ndikimin rus në Ballkan përmes dezintegritimit territorial të Kosovës.

## ËSHTË KAQ E THJESHTË TË DALLOSH SE NË VEND TË KUSH, DUHET TË PËRDORËT CILA

"Kush janë shkaqet? Kush janë shtetet? Kush janë kafshët? Kush janë faktorët?..."

Kështu flasin e shkruajnë Blendi, Dudushi e gjithë moderatorët e gazetarët shqiptarë, Rama, Meta, Luli dhe gjithë politikanët e Shqipërisë. Për fat të mirë, jo dhe të Kosovës dhe Maqedonisë, sepse këtu ende nuk ka depërtuar KJO SHMANGIE E PALOGJIKSHME nga rregullat e gjuhës shqipe. Sepse: KUSH përdoret kryesisht për njerëz: Kush është kryetar, Kush punon? Kush flet, Kush është Ai?... Nuk e di, është kaq e thjeshtë të dallosh se në vend të KUSH, duhet të përdoret CILA(AT,ËT...): CILAT janë shkaqet, cilat janë shtetet, cilat janë kafshët e egra, cilët faktorë shkaktajnë ngrohjen globale, cilat janë parakushtet e një zhvillimi... Do të doja që gjuhëtarët e Shqipërisë t'u ngrenë më shpesh veshin atyre që nuk e vërejnë se e kanë gabim!", ka shkruar në profilin e tij në FB, publicisti nga Shkupi, Daut Dauti.



## KUR NDËRROHEN ROLET

"Më drejtohej mua e fliste për Rexhep Selimin. Nuk e kuptova pse. Rexha doli nga salla e seancës plenare, e kryeministri Haradinaj mori fjalën dhe fliste kundër tij. Pasi që ju përgjigj Rexha, m'u bë e qartë shumëçka nga reagimi i dytë i kryeministrit. Ai kishte humbur toruan dhe gjaknxehtë shfrynte kundër Rexhës. Çka i kishte bërë Rexha? Po, Rexha nuk është arrestuar nga 'drejtësitë' me gjemba vendore e ndërkombëtare të pasluftës dhe nuk u vra në luftë siç nuk u vra as Haradinaj. Ndoshta kryeministri s'kishte çka t'i bënte Hashim Thaçit, Kadri Veselit e Xhavit Halitit me të cilët u bashkua dhe po i sulej Rexhep Selimit? Ç'ishte ky siklet i papërmbajtur i kryeministrit?"

Ramush Haradinaj e ka pasur në dorë Hashim Thaçin derisa nuk ia ratifikoi 'demarkacionin' pardje. Tash janë ndërruar rolet: Hashim Thaçi e ka në dorë Ramush Haradinajn. Duket që Haradinaj ka besuar se është bërë kryeministër për shkak të ideve të tija zhvillimore në fushën socio-ekonomike dhe edukativo-arsimore. Ai ka harruar se me 10 deputetë nuk bëhesh dot kryeministër, se kryeministër ai është bërë pikërisht për ta kaluar 'demarkacionin' në Kuvend. Thaçi, Veseli e Haliti që kanë shpëtuar pa asnjë therrë nga lufta e paslufta nuk ia kanë më nevojën Haradinajt si para 21 marsit. Haradinaj dikur i kishte rënë gjarpërit në kokë porse tash e kapi për bishti. Dihet pjesa e mbetur e fabulës...

Me fjalë të tjera, Haradinaj nuk e ka me Rexhën, e ka me vetveten e tij. Nuk e ka me Rexhën që e kishte afër në luftë e protesta, por me vetveten e tij që u largua prej Rexhës", shkruan në profilin e tij, lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti.



## KOSOVA I KA TË GDHENDUR EMRAT E TË RËNËVE

"Izbica, 19 vjet më parë tronditi tërë botën, por na dha forcën për t'u ngritur mbi dhimbjen, që rrugën tonë drejt lirisë ta jetësojmë me amanetin e të rënëve. Sot nderojmë e kujtojmë, të gjithë martirët e kësaj masakre. Duke kujtuar të kaluarën tonë, sidomos ata që u flijuan që ne të mund të gëzojmë të tashmen, sot nderojmë edhe dëshmorët Elez Geci dhe Maxhun Berisha, të rënë te Kryqi i Pozharit në Deçan. Kosova i ka të gdhendur emrat dhe veprën e të gjithë të rënëve në kujtesën e saj, përgjithnjë", shkruan në FB, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj.



## MEDIA Citate

### "ULTIMATUM" PËR FORMIMIN E ASOCIACIONIT

Nëse Prishtina zyrtare dhe Perëndimi nuk e formojnë Asociacionin apo Bashkësinë e komunave me shumicë serbe deri më 20 prill, atëherë këtë do ta bëjnë vetë përfaqësuesit serbë edhe me çmimin se do të arrestohen. Kjo është porosia nga mbledhja e kryetarëve dhe këshilltarëve të dhjetë komunave me shumicë serbe në Kosovë, e cila u mbajt në Mitrovicën Veriore.

Mbledhja ka pasur dy çështje në rend dite: e parë ishte ajo për situatën politike dhe të sigurisë në veri të Kosovës dhe e dyta lidhur me raportimin e kryetari të Listës Serbe, Goran Rakiq, pas takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Mbledhjes i janë përgjigjur 120 këshilltarë të komunave nga 152 sa janë gjithsej. Ministri i Administrimit të Pushteti Lokale në Qeverinë e Kosovës, Ivan Todosijević, u tha të pranishmëve se "popullit serb të Kosovës do t'u ndihmojë Serbia dhe Zoti". Ai ka theksuar se Asociacioni i komunave me shumicë serbe "është çështje politike kulmore dhe obligim ndërkombëtar". "Nëse Perëndimi dhe Prishtina nuk dëshirojnë ta formojnë Bashkësinë e komunave serbe, ne e kemi të drejtën e plotë legjitime që vetë ta marrin fatin në duar tonë dhe ta formojmë Bashkësinë e komunave serbe", tha Todosijević.

Kurse, Halil Matoshi, këshilltar i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj thotë për Radion Evropë e Lirë se Asociacioni do të formohet vetëm në bazë të verdiktit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. "Pozicioni i Qeverisë së Republikës së Kosovës është i njohur për qytetarët e Kosovës dhe për miqtë ose aleatët strategjikë të saj se Asociacioni i komunave me shumicë serbe do të bëhet vetëm sipas verdiktit të Gjykatës Kushtetuese dhe nga institucionet legale të Kosovës. Ndërkaq, çdo iniciativë unilaterale do të jetë e dënur për dështim", tha Matoshi. Lista Serbe ka marrë vendim të martën që të dalë nga Qeveria e Kosovës. Për këtë vendim asaj i është dhënë dhe mbështetja nga Beogradi zyrtar.

(REL, 28 mars)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

### Ç'ËSHTË "VALIDE SULLTANA"?

Në perandorinë otomane, Valide Sulltana ishte titulli që merrte nëna e ligjshme e sulltanit (të njëjtin kuptim ka dhe termi, nëna e sulltanit), e cila në varësi të personalitetit, ushtronte një pol të fuqishëm pushteti në oborr. Titulli u njoh dhe u përdor për herë të parë,

në shek. 16 për nënën e Sulejmanit të Madhërishtëm, Aishe Hafsa Sulltan. Si "post", ai u njihej vetëm nënave të gjalla të sulltanëve në pushtet. Me përjashtime, ka patur raste të veçanta kur "Valide Sulltana" bëhej edhe gjyshja, njerka apo edhe motra e sulltanit në fuqi.



Zëvendësministri Ristosvki u ndal në pikat kryesore të ndryshimit të këtyre ligjeve, mes të cilave edhe heqja e së drejtës së votës së Ministrit të Drejtësisë dhe kryetarit të Gjykatës Supreme në Këshillin gjyqësor, heqjen e notës mesatare 8 për pranimin kandidatëve në Akademinë për gjykatës dhe prokuror, heqja e kriterit për shkollim sipëror...

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 28 mars - Bashkëpunimi i deritashëm në grupet e punës mes pozitës dhe opozitës për një sërë ligjesh që prekin reformat në vend - ka filluar të jep frytet e para. Zëdhënësi i Qeverisë, Mile Bosnjakovski të mërkurën theksoi se Grupet e punës të partive politike tanimë po negociojnë për pakon në tërësi të ligjeve, si dhe për mundësin e zhblllokimit të punës së Parlamentit. Në të njëjtën ditë, në Parlament zëvendësministri i Drejtësisë, Oliver Ristovski, duke arsyetuar propozimin për ndryshimin e Ligjit për Gjykatat dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor, në lexim të parë në Komision politik dhe marrëdhënie midis bashkësive etnike, tha se shumica e vërejtjeve të opozitës janë inkorporuar në tekstin e ndryshimeve ligjore. Zëvendësministri Ristosvki u ndal në pikat kryesore të ndryshimit të këtyre ligjeve, mes të cilave edhe heqja e së drejtës së votës së Ministrit të Drejtësisë dhe kryetarit të Gjykatës Supreme në

MBLEDHJE E KOMISIONIT POLITIK PËR LIGJET NË GJYQËSOR

# PARLAMENTI NIS ME LIGJET REFORMUESE



Këshillin gjyqësor, heqjen e notës mesatare 8 për pranimin kandidatëve në Akademinë për gjykatës dhe prokuror, heqja e kriterit për shkollim sipëror duke e kthyer atë të mesëm për gjykatësit porotë, si dhe një varg ndryshimesh tjera të rëndësishme.

"Me ndryshimet e reja, gjithashtu parashihen masa për shkarkimin e kryetarëve të gjykatave që nuk e respektojnë Ligjin lidhur me shpërndarjen e lëndëve gjyqësore, propozohet shkurtim i mandatit të kryetarit të Këshillit Gjyqësor nga tre në dy vite pa të drejtë për

rizgjedhje, propozohet të kufizohet mundësia për anëtar të Këshillit që e zgjedh Parlamenti të jetë gjykatës i propozuar ose prokuror publik që në momentin e shpalljes kryen funksion gjyqësor ose të prokurorit publik. Kjo propozohet të mos prishet balanci i përfaqësimit të barabartë të gjykatësve dhe juristëve të shquar në Këshill", theksoi mes tjerash Ristovski. Ai sqaroi më tej se anëtarët e Këshillit gjyqësor do të mund të largohen përkohësisht nga kryerja e funksionit anëtar i Këshillit në rast kur për anëtar të Këshillit

është miratuar akt-prokurorial për vepër penale "keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit në kryerjen e funksionit" si anëtar i Këshillit ose vepër tjetër për të cilën është parashikuar burg i pakushtëzuar prej gjashtë muajsh. "Në nenin 11 vendoset nen i ri, me të cilin kufizohet mundësia e anëtarit të Këshillit që gjatë mandatit të tij, të jetë i zgjedhur për gjykatës në gjykatë më të lartë ose për kryetar të gjykatës. Me plotësimin e propozuar të Ligjit, hiqet mundësia për çdo anëtar të Këshillit që gjatë mandatit të tij si

anëtar i Këshillit, të ndikojë në punën e Këshillit", tha Ristovski. Sa i përket barazimit të kompetencave të disa gjykatave, Ristovski tha se kjo do të ndodhë në pakon e tretë të ndryshimeve që do të ndodhin në qershor të këtij viti. Për mundësinë që të shuhen disa Gjykata dhe të bëhen sektorë të gjykatës së përafërt, foli deputeti Sasho Kostov. I njëjti nuk ishte dakord me propozimin që kryetari i Këshillit gjyqësor të ketë mandat nga tre sa është aktualisht, në dy vite duke propozuar që mandati i tij të jetë vetëm një vit.

"Anëtarët kanë mandat 7 vite dhe me këtë rast do ti jepet mundësia më shumë personave të udhëheqin me Këshillin Gjyqësor, dhe do të mund të ndalohejshin ndikimet politike tek një individ në këtë institucion", tha Kostov, por që propozimi i tij nuk mori përkrahje nga anëtarët e Komisionit. Me propozim të zëvendësministrit të Drejtësisë u vendos që për këto dy ligje të mbahet debat publik nga grupet e njerëzve që preken nga këto ndryshime, si Oda e Avokatëve, Këshilli Gjyqësor, Këshilli prokuroria, gjykatës dhe juristë të njohur.

Ndërkaq deputeti i LSDM, Sebastian Kitev tha për gazetën KOHA se presin që opozita deri më 4 prill të kthehet në Parlament dhe të japë, siç tha ai, kontributin e saj edhe në Komisione dhe në seanca plenare për agjendën reformuese të vendit. "Jo vetëm për ligjet në gjyqësor, por edhe për Kodin Zgjedhor, ndjekjen e komunikimeve, ligjet e policisë, ligjin për deputetëve, dhe Ligji për Parlamentin, rregulloren e punës për të cilat do të bisedohet në kuadër të dialogut Zhan Mone, është biseduar deri më tani në Grupet e punës. Kështu që, presim që opozita deri më 4 prill të kthehet në Parlament dhe të jap kontributin e saj", tha Kitev.

HAPI I PARË DREJT ZGJERIMIT TË QEVERISË

## Zaevi e do BESËN e bashkuar në Qeveri

Shkup, 28 mars - Kryeministri Zoran Zaev paralajmëroi të mërkurën se është në bisedime me Partinë Demokratike Turke për zgjerimin e shumicës parlamentare, ndërsa deri të martën tha se do të zhvillojë bisedime edhe me të dyja krahët e Lëvizjes BESA dhe me deputetë tjerë të partive parlamentare mbi mundësinë e përfshirje në Qeveri. "Kjo parti do t'u japë mbështetje zgjidhjeve ligjore dhe bashkëpunimit dhe bashkëpunimi nuk është i kushtëzuar në disa vende, por duhet që të përmbillet. Mendoj të takohem me të dy grupet e Lëvizjes BESA, shpresoj që të gjejnë diçka që do t'i bashkojë në një, pasi e shoh se deputetët bashkëpunojnë mes vete. Më pas do të diskutojmë edhe me deputetët të cilët janë në opozitë", tha Zaev. Ai tregoi se në këtë temë nuk ka bise-



duar me kryetarin e partnerit koalicionues BDI, Ali Ahmeti, por se është e mundur që pauza e seancës së radhës këtë të enjte për pyetje të deputetëve të shfrytëzohet për këtë. Siç tha Zaev, ka pajtueshmëri të përgjithshme në koalicionin udhëheqës se dera për bashkëpunim ngelet e hapur për parti të reja. "Është e lënë mundë-

sia që kryeministri të bisedojë me deputetë, politikanë dhe me parti të cilët janë të gatshëm ta përkrahin Qeverinë në lidhje me çështjet aktuale, ashtu siç janë zgjidhja e çështjes së emrit që e ka Greqia me emrin tonë kushtetues, reformat, konceptin 'një shoqëri për të gjithë' dhe gjithçka që është për përmirësimin e kualite-

tit të jetesës së qytetarëve", tha Zaev. Ai shtoi se ka deputetë dhe parti politike të cilët janë në opozitë, por nuk pajtohen me partinë më të madhe opozitare dhe se qëndrimet e tyre janë më të afërta me Qeverinë aktuale. Zaev tha se sa të kalojë kjo fazë, edhe nga Ahmeti, por edhe nga partnerët tjerë koalicionues do të kërkojë pajtueshmëri për zgjerim të koalicionit dhe të shumicës parlamentare. Nga lëvizja BESA me kryetar Afrim Gashin thonë se janë të hapur për bisedime me kryeministrin Zaev për pjesëmarrje të mundshme në Qeveri, por se nuk paragjykojnë asnjë vendim pa u realizu takimi Gashi-Zaev. "Jemi të hapur për bisedime, por prej përpara nuk mund të prejdukim asgjë pa u takuar kryetari Afrim Gashi dhe kryetari i

LSDM, -së Zoran Zaev në lidhje me ndarjen e posteve në Qeveri", tha për gazetën KOHA, zëdhënësi partiak Orhan Murtezani. Nga Lëvizja BESA me kryetar Bilall Kasamin thonë se do ta shqyrtojnë me seriozitet ofertën e kryeministrin për pjesëmarrje në Qeveri, si dhe idenë e tij që të dy krahët do ti ketë në Qeveri. "Në vazhdimisht kemi pasur kontakte me kryeministrin Zaev për përkrahje të Qeverisë në politikat reformuese. Pas paralajmërimit që bëri kryeministri se do të nisë bisedimet me ne, do të shohim se çfarëdo të jetë oferta e tij dhe bashkë me opsionin që të dy së bashku të jemi në Qeveri, do ta shqyrtojmë me shumë seriozitet dhe do të marrim një qëndrim përfundimtar", tha Abdush Ymeri nga Lëvizja BESA e Kasamit.

(F.R)

Zëvendëskryeministri Lika tha se nuk është e saktë data e nisjes së punës, megjithatë menjëherë pas përfundimit të konferencës për mediat, administratorët e sistemuar do të thirren për të nënshkruar marrëveshjen. Kryesorja mbi të gjitha, tha ai, është nisja e këtij procesi

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 28 mars - Qeveria e Maqedonisë, në seancën e saj të fundit ka sjellë një vendim për të sistemuar nëpër vende të punës 958 administratorë, nga gjithsej 1600 sosh, sa qëndrojnë në shtëpi dhe marrin pagë mujore. Lajmi u bë i ditur nga zëvendëskryeministri për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe Sistem Politik, Hazbi Lika, dhe ministri për Shoqëri Informatike dhe Administratë, Damjan Mançevski, të cilët në një takim me gazetarë, thanë se vendimi ka kaluar në mbledhjen e mbrëmshme qeveritare, pasi paraprakisht është punuar shumë për të harmonizuar pritjet e administratorëve me mundësitë të cilat i kanë institucionet. Mançevski tha se kriteret që janë marrë në konsideratë gjatë sistemimit të 958 administratorëve nëpër vendet e punës kanë qenë fillimisht niveli i arsimit të

NIS SISTEMIMI I ADMINISTRATORËVE TË MO-së

# PËRFUNDON "PUSHIMI" PËR 958 ADMINISTRATORË



kyer, por edhe numri i të punësuarve në institucionet përkatëse për të shmangur stërngarkimin, si dhe adresa e banimit në kontekst të largësisë me vendin e punës. "Ligji parasheh që nëse e refuzojnë këtë ofertë, e cila është në përputhje me arsimin dhe vendbanimin e tyre, do të transferohen në Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratë, saktësisht në listën për transfer të ministrisë ku vlejnë rregullat e njëjta për të gjithë, ku do të marrin ofertë, dhe nëse sërish e refuzojnë, ndërpriten kontrata e punës", tha Mançevski.

Sipas tij, vendimtare në gjetjen e një zgjidhjeje për problemin i cili daton nga viti 2008, ka qenë gati-

shmëria politike në Qeveri përmes ndryshimeve në ligjin për nëpunësit administrativ dhe katër ligjeve tjera të cilat u miratuan në Kuvend, me çka këta administratorë, do të mund të sistemohen edhe në sektorin publik, siç janë shkollat dhe spitalet, të cilën gjë e pamundësonte ligji i vjetër.

Zëvendëskryeministri Lika tha se nuk është e saktë data e nisjes së punës, megjithatë menjëherë pas përfundimit të konferencës për mediat, administratorët e sistemuar do të thirren për të nënshkruar marrëveshjen. Kryesorja mbi të gjitha, tha ai, është nisja e këtij procesi. "Ne tashmë kemi grupet e punës të cilët do të kontaktojnë

me administratorët por nuk mund të flasim për një datë të sigurt, por kemi të përkufizuar një periudhë të përgjithshme, nga një deri në dy muaj të përfundojë me grupin e parë. Paralelisht me grupin e dytë i cili trajtohet më të njëjtat kriteret ashtu siç janë trajtuar edhe grupi i parë", tha Lika. Çështja e 1600 administratorëve të punësuar, kryesisht shqiptarë të cilët kanë qëndruar në shtëpi por duke marrë pagë mujore, daton nga viti 2008, dhe për qëllim ka patur të rrisë përfaqësimin e shqiptarëve nëpër institucionet publike, por ata asnjëherë nuk u sistemuan nëpër vende të punës.

## Çavkovi kthehet në Shutkë

Shkup, 28 mars - Ish-ministri i Punëve të Brendshme, Mitko Çavkov, dhe katër të akuzuar tjerë për ngjarjet në Parlament më 27 prill të vitit të kaluar, mëngjesin e së mërkurës sërish janë kthyer në Shutkë, edhe për 30 ditë tjera në paraburgim, ndërsa Gjykata Penale e refuzoi



kërkesën e Prokurorisë që masa e njëjtë t'ju shqiptohet edhe deputetëve Kërsto Mukovskit dhe Sasho Vasilevskit. Gjykata ua vazhdoi masën e arrestit shtëpiak. Deputetëve Lupço Dimovski, Johan Tarçullovski dhe edhe dy personave të tjerë u janë vazhduar masat për kujdes. "Për S.V. dhe K.M. të përfshirë me propozimin e Prokurorisë, propozimi zhvillohet si i pabazë, ndërsa vazhdohet masa e 'arrestit shtëpiak' të përcaktuar me vendim të Gjykatës Supreme të RM-së nga 26.03.2018, për L.D., J.T., E.D.B. dhe I.D. propozimi i Prokurorisë refuzohet si i pabazë, ndërsa vazhdohen masat për kujdes të përcaktuara me vendim të Gjykatës Supreme të RM-së nga 26.03.2018", theksohet në kumtesën e Gjykatës. Për personat e tjerë të përfshirë me aktakuzën, propozimi pjesërisht paraqitet dhe propozohen masat e paraburgimit dhe masat e arrestit shtëpiak, paraprakisht të përcaktuara me vendim të Gjykatës së Apelit Shkup. Paraprakisht, Këshilli Gjyqësor në sektorin për krim të organizuar dhe korrupsion pranë Gjykatës Themelore Shkupi 1, duke vepruar sipas propozimit të Prokurorisë Themelore Publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit, u ka caktuar 30 ditë paraburgim Çavkovit, M.P., D.P., O.L., dhe G.CJ. për shkak të dyshimit bazë se kanë bërë veprë penale "rrezikim terrorist të rendit kushtetues dhe sigurisë" nga neni 313 nga KP. Kundër këtyre vendimeve palët kanë të drejtë në ankesë në afat prej 24 orëve pas marrjes së vendimeve deri te Gjykata e Apelit Shkup.

## Disa opsione për Ligjin e shqipes

Shkup, 28 mars - Përveç iniciativës që Gjykata Kushtetuese të prononcohet për mosnënshkrimin e Ligjit për gjuhët nga presidenti Gjorgje Ivanov, ekzistojnë edhe opsione të tjera të cilat ekspertët juridikë ia kanë potencuar kryeministrit Zoran Zaev, por siç theksoi ai dje, nuk i janë transmetuar pasi që ata duhet të kenë siguri në sjelljen e vendimeve. "Qëllimi

është përfundimisht Parlamenti t'i njohë kompetencat e veta dhe atë që e punon të ketë impaktin e vet, presidenti gjithashtu. Edhe këtu me vendimin presidenti të mos e nënshkruaj ligjin bllokohet kompetenca e Parlamentit. Dhe tani ne mund të jemi dy anë të kundërshtuara, mund të jemi të ndryshëm politikisht, por nuk guxojmë të lejojmë asnjë insti-

tucion të bllokohet", tha Zaev, duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve në konferencën e sotme në Qeveri.

Nga ky aspekt, shtoi se nisja para Gjykatës Kushtetuese ka zgjidhje të sigurt, me qëllim që të përkufizohen kompetencat dhe të jepen udhëzime për zgjidhjen e situatës. "Juristët të cilët punojnë para së gjithash në

Kuvend, por edhe një pjesë këtu në Qeveri përpunojnë edhe mekanizma të tjera të zgjidhjes së këtij problemi, pasi që demokraci funksionale, shtet funksional do të thotë edhe gjetja e zgjidhjes së këtyre precedentëve apo rasteve, siç është mosnënshkrimi pas votimit të tretë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve", shtoi Zaev.

VENIZELOS INSISTON NË ZGJIDHJE TË PLOTË

## EMËR I PËRBËRË ERGA OMNES, SIPAS MUNDËSISË I PAPËRKTHYER

Athinë, 28 mars - Emëri i përbërë me përcaktim gjeografik, në gjuhën maqedonase, sipas mundësisë pa përkthim, për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm ndërkombëtar dhe dypalësh, madje edhe me vendet që tashmë e kanë njohur Maqedoninë me emrin kushtetues, janë pozicionet e ministrit grek të Punëve të Jashtme dhe ish-zëvendëskryeministrit, Evangelos Venizelos. Siç njoftoi korrespondenti i MIA-s nga Athina, në prezantimin e librit "Çështja e Maqedonisë", Venizelos tha se zgjidhja nuk duhet të jetë e pjes-

shme ose e përkohshme, por zgjidhje e plotë dhe e njëfishtë.

"Zgjidhja duhet të jetë me emër të përbërë me përcaktim gjeografik në gjuhën sllave, sipas mundësisë i papërkthyer, që nuk do të lë zbrazëtira dhe moskuptime në formulim dhe kryesisht, do të jetë erga omnes. Respektivisht do të jetë një edhe për përdorim të brendshëm edhe për të jashtëm, pa diferencë ekzistuese mes emrit të brendshëm kushtetues dhe emrit ndërkombëtar për përdorim në organizata ndërkombëtare. Kur flasim për përdorim të jashtëm, mendojmë në emër për të gjitha

përdorimet edhe në organizata ndërkombëtare edhe në aspektin dypalësh me Greqinë edhe në aspektin dypalësh me të gjitha vendet, që e kanë njohur vendin me emrin kushtetues, ndërsa do të duhet të deklarojnë se e njohin me emrin e ri kontraktues. Pastaj do të zgjidhen të gjitha problemet teknike, që kanë të bëjnë me gjuhën prodhimet, kombësitë etj", thotë Venizelos. Ai foli edhe për kornizën juridike të zgjidhjes. Pyeti, "nëse zgjidhja do të bazohet në të drejtën ndërkombëtare ose në revizion të Kushtetutës së Maqedonisë?". Konsideron se nevojiten

garanci juridike dhe politike.

Nga ana juridike zgjidhja do të vulozet me marrëveshje ndërkombëtare, ndërsa garanci politike për Greqinë do të ishte ndryshimi i Kushtetutës së Maqedonisë, por e votuar me shumicë të rritur në Kuvend. Venizelos, i cili është profesor i të drejtës kushtetuese, sqaron se garanci ndërkombëtare është marrëveshja ndërkombëtare "që do t'i obligojë palët, pavarësisht nga ndryshimet e brendshme politike, veçanërisht nëse kjo marrëveshje është e mbështetur nga Këshilli i Sigurimit". Lidhur me garancitë politike, tha

se nëse tani në Shkup nuk bëhen ndryshime kushtetuese me shumicë të rritur, atëherë mundet në të ardhmen ndonjë Qeveri tjetër të bëjë revizion të ri apo ta kthejë në Kushtetutën e vjetër.

Në prezantimin e librit, Venizelos tha se një ndër problemet e rëndësishme në këtë moment është edhe reagimi i një pjese të madhe të shoqërisë greke dhe mendimit publik grek. Shtoi se protestat e mbajtura në Selanik dhe Athinë, nuk janë vazhdim i protestave nga viti 1992, por reagim i mënyrës së politikës në periudhën e krizës në Greqi.

Është vet kërkesa e Branisllav Stefanovskit drejtuar Ministrisë së Drejtësisë që ka nxjerr dritë mbi të vërtetën e gjithë rastit.

Stefanovski në Ministrinë e Drejtësisë kishte dorëzuar kërkesë për vazhdimin e licencës më 10 nëntor 2017, ose 17 muaj pas skadimit të licencës paraprake. Pikërisht në kohën kur i njëjti ka bërë ekspertizë, ai nuk ka poseduar licencë

Shkup, 28 mars - Ekspertiza neuropsikiatrike në rastin e Almirit është bërë nga ekspert ligjor pa licencë. Branisllav Stefanovski ishte caktuar për ekspert në këtë rast, katër muaj pasi i kishte skaduar afati i licencës. Kështu ka raportuar televizioni Alsat-M, sipas të cilës, dokumentet e siguruar nga ky televizion tregojnë se licenca e Stefanovskit kishte skaduar para se të ndodhte vrasja e Almirit më 25 qershor të vitit 2016, në Kumanovë, ku vrasësi Boban Iliqi i shoqëruar nga vëllai dhe e dashura e tij, e shtypën për vdekje vogëlushin 4-vjeçar Almir Aliu.

Mbi bazën e ekspertizës së Stefanovskit është bërë edhe rikualifikimi i lëndës për rastin e Almirit nga "vrasje" në "aksident trafiku me pasojë vdekjen". Stefanovski është angazhuar si ekspert neuropsikiatër pikërisht nga Prokuroria e Kumanovës, e cila edhe kërkoi rikualifikim të lëndës bazuar edhe në "dëshminë" pa licencë të Stefanovski. Tani, nga kjo prokurori thonë se nuk mbajnë përgjegjësi duke adresuar rastin në Klinikën Universitare të Psikiatrisë në Shkup, e cila edhe cakton ekspertët ligjor.

"Urdhri për ekspertizë ishte bërë pranë Klinikës Universitare të Psikiatrisë në Shkup dhe jo nga eksperti Branisllav Stefanovski si person fizik, pas çka vetë institucioni në rastin konkret ka caktuar cilët persona, ekspert neuropsikiatër do ta bëjnë ekspertizën", thonë nga Prokuroria e Kumanovës për Alsat-M. Edhe Gjykata e Kumanovës ka tentuar të "shpëtojë" nga gjithë ky falsifikim i dëshmisë, duke u përgjigjur se "gjykata nuk ka

GJETJETË REJA NË RASTIN EVRASJES SË ALMIR ALIUT

# EKSPERTI PA LICENCË E LIROI BOBAN ILIQIN



dhënë urdhër për ekspertizë ndaj ekspertit neuropsikiatër dhe nuk ka asnjë të dhënë lidhur me licencën". Për më tepër, Gjykata thotë se "edhe gjatë procedurës nuk është kontestuar ekzistimi i licencës". Ky moment i ri ngrit dilemën nëse akuza do të mbetet e njëjtë apo nëse mbrojtja do të kërkojë ekspertizë të re.

Stefanovskit në ndërkohë në fillim të muajit qershor të vitit 2016 i kishte skaduar afati i licencës i ekspertizës. Sipas nenit 19 të Ligjit për ekspertizë, kërkesa për vazhdimin e licencës për ekspertizë duhet bërë dy muaj para skadimit të së vjetrës, ndërkohë që kjo nuk shihet të jetë

bërë në rastin e Stefanovskit. Prokurorja e rastit, Suzana Kusigerska aktakuzën ndaj Iliqit e kishte ngritur më 19 dhjetor 2016, ndërsa kërkesën për ekspertizë më 21 shtator 2016, raporton Alsat-M. "Ekspertiza" e Stefanovskit pa licencë ndërkohë si dëshmi ishte marrë pas ngritjes së aktakuzës, konkretisht pas dy seancave në fjalët hyrëse.

Është vet kërkesa e Branisllav Stefanovskit drejtuar Ministrisë së Drejtësisë që ka nxjerr dritë mbi të vërtetën e gjithë rastit. Stefanovski në Ministrinë e Drejtësisë kishte dorëzuar kërkesë për vazhdimin e licencës më 10 nëntor 2017, ose 17 muaj pas skadimit të licencës para-

prake. Pikërisht në kohën kur i njëjti ka bërë ekspertizë, ai nuk ka poseduar licencë. Madje, për të qenë ironia më e madhe, Alsat-M zbulon se Stefanovski kërkesë për vazhdimin e licencës ka paraqitur edhe në vitin 2018, konkretisht më 12 shkurt. Është Ministria e Drejtësisë ajo e cila kishte refuzuar t'i vazhdojë licencën Stefanovskit, pasi sipas Ligjit për ekspertizë, i njëjti nuk ka parashtruar kërkesë në afatin kohor, ose dy muaj para se t'i skadojë licenca. Madje, një hap më tutje ka shkuar Ministria e Drejtësisë, e cila kishte konstatuar dhe sjellë vendim se Stefanovskit duhet t'i merret licenca për tre vite, pasi i njëjti - përveç që ka shkëlur Ligjin për ekspertizë, ai nuk ka paguar as anëtarësinë për vitin 2014. Me këtë, Stefanovski ligjërisht nuk ka mundur të jetë ekspert neuropsikiatër në asnjë lëndë. Në një deklaratë për televizionin Alsat-M, nga Ministria e Drejtësisë kanë thënë se, "për marrjen e licencës për ekspertizë, ministri i Drejtësisë sjell vendim në bazë të nenit 26 të Ligjit për ekspertizë ligjore, ekspertin ta shlyejë nga Regjistri i ekspertëve ligjor". Ligji për ekspertizë ligjore është i qartë. Asnjë institucion nuk guxon që të angazhojë ekspertë pa licencë.

## SOT VENDOSËT PËR PARABURGIMIN ILIQIT

Gjykata e Apelit në Shkup sot do të vendos se vallë vrasësi i Almir Aliut, do të kthehet në vuajtjen e paraburgimit në Shutkë, ose do të qëndrojë në liri. Burime të gazetës KOHA brenda kësaj gjykate flasin se lëndën për shqiptimin ose jo të paraburgimit ndaj Iliqit e kryeson gjykatësi Enver Shabani. Këshilli Penalë pesë-anëtarësh, siç mëson KOHA, gjatë ditës së enjte do të mbledhet në Gjykatën e Apelit, dhe po të njëjtën ditë pritet të miratohet vendimi nëse vrasësi i Almirit do të kthehet në burgun hetues të Shutkës, apo seancën e radhës të caktuar më 2 prill, ai do të pret në liri. Ndryshe nga hera e fundit, kur Prokuroria e Kumanovës kërkoi lirimin nga paraburgimi, tani po kjo prokurori ka dorëzuar ankesë deri te Gjykata e Apelit, duke e arsyetuar kërkesën se ekzistojnë

rrethana ligjore për shqiptimin e masës së paraburgimi ndaj të akuzuarit nga Gjykata. Më 15 mars, pas parashtrimit zyrtar të kërkesës për rikualifikim të aktakuzës në rastin e Almirit, vrasësi Boban Iliqi pas 18 muajve në Shutkë, doli në liri. Gjatë largimit nga burgu i Shutkës, ai nuk shprehu asnjë lloj keqardhje për veprimin e bërë në ngjarjen tragjike të vrasjes së Almirit, por vazhdoi tutje dhe kërcënoi ekipin e gazetarëve të TV21. Ofendimet dhe kërcënimet nuk mjaftuan, por vrasësi Boban Iliqi, vetëdijën e tij të ulët e dëshmoi para hyrjes në veturën mercedes, me të cilën e realizoi veprën penale. Disa çaste para largimit, ai me një doze ironie e "ledhatoi" veturën dhe kësajsoj dërgoi porosi te opinioni se nuk ndjen as njëfarë pendimi për vrasjen e Almirit. (O.Xh)



## SHGM: Të shkarkohet prokurori Shabani

Shkup, 28 mars - Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) ka dënuar ashpër kërcënimet që dje i bëri njëri nga prokurorët e Këshillit etik të Maqedonisë gazetarit të televizionit Alsat-M. Kryetari i SHGM-së, Naser Selmani thotë se do të kërkojnë shkarkimin e tij, pasi siç u shpreh ai, kërcënimet është i pa denjë dhe qyqar. "Më lejoni që në mënyrë të ashpër të dënojmë këtë sjellje të papërgjegjshme të një prokurori i cili e ka emrin Bari Shabani, i cili në mënyrë brutale kërcën verbalisht një gazetar. Unë nga përvoja e di se gazetarët i kërcënojnë qyqarët dhe ata që kanë hendikep intelektual që të përballen me kritikën e gazetarëve në opinion. Unë mendoj se kjo sjellje e pahijshme, fatkeqësisht e këtij prokurori, e bën të padenjë të ushtrojë funksionin e prokurorit. Ne do të kërkojmë nga Këshilli i prokurorëve, do të kërkojmë nga të gjithë institucionet që janë përgjegjëse për punën e prokurorëve, të ngrenë procedurë për shkarkimin e këtij personi", tha Selmani. Ai njëherësh fton gazetarët të mos kenë frikë nga kërcënimet e tilla dhe të vazhdojnë të punojnë për të informuar drejtë dhe saktë opinionin. "Është një primitivizëm institucional, i cili neve na shqetëson shumë. Institucionet në vend që të mbrojnë gazetarët, ata paraqiten në rolin e banditëve. Kjo sjellje nuk guxon të tolerohet nëse ne vërtetë dëshirojmë të jemi shoqëri e hapur demokratike dhe integruar në Evropën e lirë dhe të bashkuar", u shpreh ai.

## Më të korruptuar politikanët, gjykatësit dhe mjekët

Shkup, 28 mars - Qytetarët nuk kanë shpresa të mëdha për çrënjosjen e korrupsionit në Maqedoni. Çdo i pesti vlerëson se ajo nuk mund të zvogëlohet, ndërsa afër 47 për qind vlerësojnë se çdoherë do të ekzistojë, por mund të zvogëlohet. Në vitin 2016, vetëm 145 persona janë të dënuar për keqpërdorim të detyrës zyrtar

apo mitmarrje, që do të thotë se efikasiteti i institucioneve ka shënuar rezultate pozitive vetëm në 0.03 për qind të rasteve të gjetura. Kjo u theksua ndër të tjerash në konferencën për ndjekjen e punës së Komisionit për Pengimin e Korrupsionit të përgatitur nga Qendra e Maqedonisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Gjithashtu,

analiza tregon më tej se Ministria e Punëve të Brendshme, Qeveria dhe Prokuroria Speciale publike gëzojnë besimin më të madh të qytetarëve në luftën kundër korrupsionit. Raporti më tej zbardh se për qytetarët, më e rëndësishme se korrupsioni e që renditet në vendin e pestë, janë çështjet e natyrës ekzistenciale si papunë-

sia, varfëria, dhe të ardhurat e ulëta si dhe jostabilitetit politik. Rezultatet nga raporti tregojnë se tre nga katër qytetarë konsiderojnë se gjykatësit dhe prokurorët publikë janë më të korruptuar, ndërsa mbi 65 për qind e qytetarëve i theksojnë deputetët, ministrat, liderët e partive politike dhe liderët lokalë për më të korruptuar.

Shkuar sipas sektorëve, në vendin e parë për të korruptuar janë gjykatat dhe prokuroria, ndërsa në vendin e dytë Ministria e Shëndetësisë dhe sektori publik dhe shëndetësor. Çdo i pesti qytetarë konsideron se korrupsioni nuk mund të zvogëlohet, ndërsa 46.9 për qind se çdoherë do të ekzistojë, por që mund të zvogëlohet. (F.P.)

Barrën më të madhe të studentëve (86.6%) dhe të punësuarve (81%) e mbajnë gjashtë universitete publike. Në 21 institucionet private janë të punësuar 497 profesorë apo 17 për qind të totalit, përderisa në dy institucionet fetare ishin 26 të punësuar apo 2 për qind

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 28 mars - Pavarësisht ndryshimeve të shumta, shpeshherë dramatike në sferën e arsimit të lartë, nëse shihen universitete dhe fakultete nga prizmi i numrit të studentëve nuk është e vështirë të konstatohet pavarësisht të gjithave ka pasur një stabilitet të qëndrueshëm. Ka pasur gjithashtu iniciativa dhe ndërmarrje konkrete për mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë të cilat nuk plotësojnë standardet për kryerjen e veprimtarisë arsimore dhe shkencore e megjithatë numri i tyre jo që nuk është zvogëluar por është rritur ndër vite. Në shënjestër të iniciativave për mbylljen e institucioneve që nuk plotësojnë kushtet ishin sidomos universitete dhe fakultete private, por prapë se prapë të njëjtat qëndrojnë në listën e institucioneve të akredituar. Në këtë listë janë hiq më pak se 19 universitete, fakultete dhe institute private duke kontribuar që në total numri i institucioneve të arsimit të lartë në Maqedoni të shkojë në 29 sosh.

Listën e institucioneve të akredituara të arsimit të lartë e prijnë

LISTA ZYRTARE ME 29 INSTITUCIONE TË ARSIMIT TË LARTË

# PRIVATËT MË NË NUMËR, POR TË KURSYER NË PUNËSIME



gjashtë universitete publike në vend, të cilat kanë edhe barrën më të madhe të veprimtarisë në fjalë. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, në institucionet publike të arsimit të lartë përfshihen 86.6 për qind e numrit të përgjithshëm të studentëve dhe 81 për qind e kuadrit arsimor të angazhuar në to. Me status të veçantë, të institucionit privat-publik jo fitimprurës veçohet Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë (UEJL) si dhe me statusin e institucionit të themeluar me Ligjin e Akademisë Ushtarake dallohet Akademia Ushtarake "Gje-

neral Mihajllo Apstolliki" në Shkup. Sakaq, mozaikut të institucioneve në fjalë i shtohen edhe dy institucionet fetare, Universiteti Ortodoks "Klimenti i Ohrit" në Shkup (UOSH) dhe Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup (FSHI). Pra në total në Maqedoni funksionojnë 29 institucione të cilat kanë leje për ushtrimin e veprimtarisë arsimore në nivelin e shkollimit të lartë. Nëse analizojmë numrin e studentëve nga viti shkollor 2011/2012 deri në vitin 2016/2017 për të gjitha bashkë do të vërejmë se ai numër lëvizën në kuota të njëjta me ujë të vogla në vite të caktuara. Konkreti-

sht, para gjashtë viteve (2011/2012) numri i studentëve të regjistruar ishte 58.747 ndërsa vitin e kaluar (2016/2017) raportohej për 58.083 studentë. MASH ka bërë të ditur se vitin që shkoi numri i studentëve të regjistruar në vit të parë (të gjitha institucionet e arsimit të lartë) përfshinte gati 30 për qind të numrit të përgjithshëm të studentëve që raportohej për atë vit. Pra, në vitin e parë të studimeve (duke mos përjashtuar ata që e kanë regjistruar vitin e parë për herë të dytë apo të tretë) ishin 16.710 studentë apo 28.8 për qind e totalit. Lidhur me numrin e të

punësuarve, në të gjitha institucionet e arsimit të lartë vitin akademik 2016/2017 numëroheshin 2.854 të punësuar në procesin e mësimdhënies në të gjitha thirrjet akademike: profesor i rregullt, profesor me korrespondencë (i asocuar), docentë dhe ligjërues i lartë. Pjesa dërmuese e tyre (2.331) sipas të dhënave të ESHS-së ishin të punësuar në universitete publike, konkretisht në "Kirili dhe Metodi" në Shkup, "Klimenti i Ohrit" në Manastir, Universiteti i Tetovës, "Goce Dellçev" në Shtip, "Apostol Pavle" në Ohër dhe "Nënë Tereza" në Shkup. Institucionet private pavarësisht listës së gjatë prej 21 universitete, fakultete dhe institute, duken të kursyera sa i takon numrit të punësuarve. Të gjitha bashkë në vitin 2016/2017 kishin vetëm 497 profesorë apo 17 për qind të totalit përderisa institucionet fetare (UOSH dhe FSHI) kishin 26 profesorë të punësuar ose 2 për qind e numrit të përgjithshëm të profesorëve punësuarve në sferën e arsimit të lartë.

Ligji për arsim të lartë, që është aktualisht në fuqi është miratuar në vitin 2008 dhe që atëherë është ndryshuar plot 21 herë. Vetëm në vitin 2015 kishte pesë herë ndryshime dhe plotësime, ndërsa në proces e sipër është nxjerrja e një Ligji tërësisht të ri.

TITULLI KALON NGA BEROVA NË DEMIR HISAR

## NJË TJETËR "QYTET KULTURE" I HUMBUR PËR SHQIPTARËT

Koha Evis HALILI

Shkup, 28 mars - Titullin "Qytet i kulturës 2018" nuk arriti ta fitojë asnjë komunë shqiptare në konkursin e Ministrisë së Kulturës për financimin e një prej projekteve me interes nacional, manifestimit "Qytet kulture". Rezultatet e konkursit, që qëndroi i hapur nga një muaj rresht (14 dhjetor - 15 janar) ende nuk janë publikuar zyrtarisht në faqen zyrtare të këtij institucioni, por mësohet se shqyrtimi i projekteve ka përfunduar dhe fitues është shpallur Demir Hisari, si një prej pesë komunave konkurrenente me programin më të kompletuar. Numri i komunave aplikuese në total ka qenë pesë, dy prej të cilave shqiptare, komuna e Strugës dhe e Tetovës. Por programi me projektet e prezantuara prej tyre nuk kanë arritur të mbledhin pikët e nevoj-

Numri i komunave aplikuese në total ka qenë pesë, dy prej të cilave shqiptare, Komuna e Strugës dhe ajo e Tetovës. Nga komisioni në ministri bëjnë me dije se programi me të cilin ka aplikuar Komuna e Strugës ka qenë më i kompletuar nga ana përmbajtjesore sesa ai i komunës së Tetovës, por asnjë prej tyre në nivelin e konkurrentit fitues, Komunës së Demir Hisarit

shme për t'u përzgjedhur si fituese, të kenë përmbajtje të pasuruar me më shumë ngjarje kulturore në të gjitha disiplinat dhe shumëllojshmëri zhanresh. Dhe kjo nuk është hera e parë për këto 15 vite sa zhvillohet ky manifestim, stafeta e Qytetit të Kulturës të mos pasohet në asnjë komunë shqiptare. Në vite pjesëmarrja në konkurs ka qenë e vogël, si Dibra, Gostivari apo Tetova, të cilat kanë konkurruar gjithsej një apo dy herë gjatë këtyre viteve. Mospjesëmarrjen e kanë justifikuar me vonesat në hartimin e programit, por edhe skualifikimet kur kanë

konkurruar. Këshilltari i ministrit, Petrit Saraçini thotë se qëllimi i këtij manifestimi është sigurimi i kushteve për një zhvillim të barabartë kulturor, akses dhe shfrytëzim masiv të vlerave kulturore për të gjithë qytetarët. Për këtë arsye, duke iu referuar rezultateve dhe interesimit të konkursit të sivjetshëm ai thotë se do të punojnë për rritjen e kapaciteteve dhe aftësimin e komunave për të qenë pjesë e projekteve nacionale por edhe ato ndërkombëtare, nga ky vit priten të organizohen punëtorive për menaxhmentin kulturor, të përforcohen kapaci-

tetet dhe bashkëpunimet institucionale. Titullin "Qytet i Kulturës" disa komuna e kanë mbajtur disa herë radhazi, duke u shndërruar në një traditë për qytete si Radovishi, Manastiri, Prilepi, Kumanova, e të tjera. Manifestimi "Qytet i kulturës" synon demetropolizimin e kulturës dhe zhvillimin e jetës kulturore në periferi, në qyteza dhe komuna ku manifestimet kulturore janë periodike, këtë vit iu nënshtrua një riformatimi, por pa ndryshime esenciale, si në koncept ashtu dhe kushtet e konkurrimit. Që nënkupton se procedurat e

aplikimit janë lehtësuar, ashtu si edhe metodologjia e vlerësimit të projekteve, për të mundësuar një garë të drejtë edhe për ato komuna që deri tani nuk kanë arritur të fitonin, apo edhe të konkurronin. "Me qëllim që të krijohet kushte për një zhvillim të barabartë kulturor dhe të mundësohet akses i qytetarëve tek vlerat kulturore, si edhe të nxitet gjallërimi i kulturës në nivel lokal, në vitin 2018 do të sigurohen mjete për realizimin e këtij manifestimi", thuhet në rregulloren e konkursit. Ky është viti i dytë me radhë që numri i aplikuesve në këtë konkurs është i vogël, duke i reduktuar nga dhjetëra konkurrues në vetëm 3 apo pesë pjesëmarrës në konkurs. Nuk përjashtohet mundësia që vitin e ardhshëm vazhdimësia e këtij manifestimi të vihet në pikëpyetje.

## Rritje ekonomike prej 3.2 për qind, konsideron Qeveria

Shkup, 28 mars - Politika të heqë duart nga biznesi dhe të lërë që mekanizmat ekonomikë t'i vendosin rregullat, të sundojë drejtësia që çdo investues të ndjehet i sigurt, ndërsa shteti të jetë stabil pse kapitali është druajtur dhe dëshiron të jetë i mbrojtur, tha zëvendëskryeministri Koço Angjushev në Forumin "Ekonomia e Maqedonisë midis vizionit dhe dilemës". Angjushev potencoi se për rritjen e ekonomisë së vogël si ajo e Maqedonisë nevojitet krijimi i kompanive të orientuara në eksport dhe investim në projekte të qëndrueshme dhe infrastrukturore. "Shumë para shpenzuan në firmat e falimentuara, që dështuan, i apsorbuuan paratë e tatimpaguesve, dhe nuk dhanë rezultate. Nëse duam rritje të ekonomisë duhet fillimisht të rritet kërkesa vendore, të rritet eksporti deri në 65 për qind nga BPV dhe të investohet në investime kapitale, por të qëndrueshme" theksoi zëvendëskryeministri.

Sipas tij, masat qeveritare për mbështetje do të mund t'i shfrytëzojnë mbi 7.000 kompani, ndërsa efektet nga masat do t'i masë ekipi në suaza të ASHAM-it që duhet t'i tregojë rezultatet konkrete. Angjushev u përqendrua edhe në pagën mesatare e cila në janar të këtij viti ka treguar rritje prej 6,5 për qind në krahasim me janarin e vitit 2017. Kjo, siç vlerësoi, është rezultat i ngritjes së limitit të pagës minimale. Ministri i Financave, Dragan Tevdovski, gjithashtu është panelist në Forum, vlerësoi se rritja ekonomike prej 3,2 për qind është e realizueshme.

Ekonomia e Maqedonisë fillon të lëvizë dhe mund të realizojë rritje më tepër se katër për qind", nënvizoi Tevdovski. Para fillimit të Forumit, ambasadori britanik Çarls Garet porositi se financat publike janë çelës për demokraci të shëndoshë. Qytetarët duhet të dinë si dhe për çfarë shpenzohen paratë e tyre, ndërsa kjo është shumë me rëndësi edhe për biznesin i cili në bazë të të dhënave konkrete, të sakta vendos për investimet e veta. Financat publike, nënvizoi Garet, duhet lehtë të jenë të kapshme dhe lehtë të kuptueshme.

## SUBVENCIONIMI SHTETËROR I BIZNESIT PRIVAT

# DISKRIMINIM I FSHEHUR PËR KOMPANITË SHQIPTARE

Profillet që kanë kompanitë shqiptare operojnë në sektorë të cilët realisht nuk janë të përfshira në ligjin për përkrahje financiare të investimeve dhe e dyta ato pak kompani që kryejnë veprimtari të sektorëve të paraparë me ligj e kanë shumë vështirë të plotësojnë kushtet për të qenë bartës të ndihmave financiare shtetërore

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 28 mars - A mjafton mbështetja shtetërore prej 50 milionë euro për biznesin privat, që është parapa për sivi? Kësaj pyetje i përgjigjen me skepticizëm si përfaqësuesit e biznesit privat, ashtu edhe analistët ekonomikë, të cilët vlerësojnë se një kujdes i shprehur nga ana e shtetit vetëm për 10 për qind të kompanive, nga 73 mijë kompani sa janë gjithsejt, është i pamjaftueshëm, por nuk mund të konsiderohet edhe si fakt i kryer.

### POLITIKË JOFAVORIZUESE SHTETËRORE

Fatmir Bytyqi, analist ekonomik, thotë se krijimi i një politike vetëm për 10 për qind të kompanive kundrejt 90 për qind të kompanive tjera, është politikë jofavorizuese dhe shumë e gabueshme. Edhe pse 10 për qind e kompanive që i plotësojnë kushtet për të aplikuar për ndihmën shtetërore në bazë të raporteve vjetore financiare të tyre, jam më se i sigurt se jo të gjitha prej tyre do të vetëm do të fitojnë të drejtën e subvencioneve.

"Nëse nga 73 mijë kompanive sa ekzistojnë për momentin vetëm 10 për qind apo 7300 kompani plotësojnë kushtin për të aplikuar për ndihmën financiare shtetërore, realisht jo më shumë se 1500 kompani do të fitojnë të drejtën e marrjes së subvencioneve shtetërore. Prandaj me të drejtë shtrohet pyetja se pse shteti duhet të krijojë politika për një numër shumë të vogël të kompanive që në mesin e



këtyre kompanive që mund të jenë fitues të ndihmave financiare shtetërore, ndoshta edhe nuk e meritojnë përkrahjen financiare nga shteti", thotë Bytyqi duke shtuar se duhet të kihet parasysh se ndihmat shtetërore financiare që do të shkojnë për 10 për qindëshin e kompanive vendore sa ato kanë kontribuar në mbushjen e arkës buxhetore gjate vitit të kaluar. Ndërsa sa i përket çështjes së kompani shqiptare i plotësojnë kushtet për të aplikuar për ndihma financiare nga shteti Bytyqi shprehet shumë pesimist.

### LIGJI FAVORIZON KOMPANITË QË PRODHONJË

"Shumë pak kompani shqiptare, te mesme dhe te vogla, i plotësojnë kriteret për të aplikuar për ndihmë financiare shtetërore, ndonëse, në parim, ky ligj në vetë përmban një diskriminim të fshehur për kompanitë shqiptare edhe pse faji është i dy anshëm. E para është për shkak se profilet që kanë kompanitë shqiptare operojnë në sektorë të cilët realisht nuk janë të përfshira në ligjin për përkrahje financiare të investime-

ve dhe e dyta ato pak kompani që kryejnë veprimtari të sektorëve të paraparë me ligj, e kanë shumë vështirë të plotësojnë kushtet për të qenë bartës të ndihmave financiare shtetërore", vlerëson Fatmir Bytyqi. Në anën tjetër, shteti kur e ka përgatitur këtë ligji ka krijuar qëllimshëm barriera të shumta burokratike që shumë kompani, e në veçanti kompanitë shqiptare, duhej t'i nënshtrohen shumë kushteve bazë për të aplikuar për marrjen e ndihmave financiare.

Edhe nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore (OEMVP) vlerësojnë se nga shumica e përgjithshme e paraparë për subvencione, nuk do të përfitojnë shumë kompani për faktin se me Ligjin për mbështetje financiare të investimeve, në parim, përparësi ju jepet kompanive që prodhojnë.

"Duke pasur parasysh faktin se kriteret e dhënies së subvencioneve nuk janë ende të shpallura publikisht, nuk mund të japim numër. Në përgjithësi, kompanitë shqiptare, nga TOP 100 kanë shënuar sukses vite me radhë. Mirëpo, sipas informatave që janë në pu-

blik, kushtet që kompanitë duhet t'i plotësojnë, duhet të jenë në mënyrë kumulative, gjegjësisht të gjitha menjëherë. Andaj, një kalkulim më i saktë mund të bëhet vetëm në momentin e shpalljes së rregulloreve", thonë nga OEMVP-ja.

Ndërkaq sa i përket paralajmërimeve se vetëm 10 për qind e kompanive, nga mbi 70 mijë kompani sa janë aktive në Maqedoni, prej të cilave sa prej tyre mund të jenë shqiptare, nga OEMVP-ja thonë se nuk mund të japim përqindje për faktin se ende nuk janë të qarta rregullat e lojës dhe se kjo njëherit është edhe një dëshmi se shteti nuk ka për qëllim të ndihmojë njësoj të gjitha kompanitë në Maqedoni.

"Ende s'kemi rregullore, ose në instancë të fundit s'kemi garanci se teksti i ligjit do të miratohet siç është apo do ketë ndryshime substanciale. Me rëndësi është të kemi rregulla të qarta, afate të arsyeshme, zbatim joselektiv dhe eliminim të faktorit njeri në procesin e dhënies së subvencioneve", thonë nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore.

## CILAT KRITERE S'I PLOTËSOJNË KOMPANITË SHQIPTARE?

"Shumë pak kompani shqiptare, te mesme dhe te vogla, i plotësojnë kriteret për të aplikuar për ndihmë financiare shtetërore, ndonëse, në parim, ky ligj në vetë përmban një diskriminim të fshehur për kompanitë shqiptare edhe pse faji është i dy anshëm. E para është për shkak se profilet që kanë kompanitë shqiptare operojnë



në sektorë të cilët realisht nuk janë të përfshira në ligjin për përkrahje financiare të investimeve dhe e dyta ato pak kompani që kryejnë veprimtari të sektorëve të paraparë me ligj, e kanë shumë vështirë të plotësojnë kushtet për të qenë bartës të ndihmave financiare shtetërore", vlerëson Fatmir Bytyqi.

AZIRI NË INSTITUTIN E TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE TË SHQIPTARËVE

# IKSHKSH, ALFA DHE OMEGA E KULTURËS SHQIPTARE

Në mesin e projekteve që pritet të kenë impakt më të madh në projeksionet e këtushme kulturore, janë evaluimi i dyzërëshit të shqiptarët e Maqedonisë, që më vonë përgatitet për konkurrim në UNESCO

Shkup, 28 mars - Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, të mërkurën e vizitoi sekretari shtetëror i Ministrisë së Kulturës, Valmir Aziri, i cili realizoi takim me drejtorin e Institutit, Skender Asani, dhe bartësit e projekteve të miratuara nga Ministria e Kulturës për vitin 2018. Me këtë rast, drejtori i Institutit e falënderoi sekretarin Aziri për angazhimin në përkrahjen e 11 projekteve, meqë për herë të parë nga kjo ministri, sivjet janë mbështetur të gjitha projektet me të cilat Instituti ka konkurruar. "Kemi të bëjmë me një vistër të gjerë të projekteve që vijnë nga sfera e trashëgimisë shpirtërore e kulturore, botimet e librave dhe revistave,



projekte nga fusha e folklorit, si dhe projekte interdisciplinare dhe ndërkombëtare", tha drejtori Asani. Ndërsa, sekretari shtetëror i Ministrisë së Kulturës, Valmir Aziri, theksoi se kjo ministri është e hapur për institucione kredibile dhe serioze, të cilat merren me ruajtjen dhe kultivimin e kulturës shqiptare. "Ne vlerësojmë se Instituti është alfa dhe omega për çështje që kanë të bëjnë nga sfera e trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore të

shqiptarëve këtu, prandaj mbështetja jonë e rezervë nuk ka munguar, dhe e njëjta duhet të forcohet edhe më tutje nga institucionet tjera relevante. Ministria e Kulturës, Institutin e sheh si një partner serioz në realizimin e projekteve që kanë rëndësi të madhe në ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës shqiptare në Maqedoni", u shpreh Aziri.

Në mesin e projekteve që pritet të kenë impakt më të madh në

projeksionet e këtushme kulturore, janë evaluimi i dyzërëshit të shqiptarët e Maqedonisë, që më vonë përgatitet për konkurrim në UNESCO. Pastaj është seminari i ballkanologjisë dhe komunikimeve interballkanike, i cili starton sivjet, me pjesëmarrjen e një numri të madh të studiuesve të njohur nga gjithë Ballkani, si dhe prezantimi i kulturës dhe traditave të shqiptarëve katolikë të Shkupit në arenën ndërkombëtare. (E.H)

## Gjendet një trup i pajetë, dyshohet të aktorja shqiptare

Adea Shabani

Shkup, 28 mars - Detektivët e departamentit të policisë në Los Anxhelos që hetojnë zhdukjen e aktore 25-vjeçare nga Shkupi, Adea Shabani u përgjigjën se në një vend në verilindje të Sakramentos, dje kanë gjetur një trup të dekompozuar, që me gjasë është kufoma e mundshme e aktore njoftoi një dëshmitar okular. Sipas tij, mësohet se një njeri që vrau veten pas një ndjekjeje të shkurtër në zonën e Los Anxhelos, ishte i dashuri i shqiptares Shabani, e zhdukur në Holli-vud. Sipas zyrës së sherifit, hetuesit nga të dy agjencitë e zbatimit të ligjit dhe antropologët nga Koll Stejt Çiko ishin në vendin e ngjarjes të martën në një përpjekje "për të përcaktuar nëse mbetjet e gjetura janë të lidhura me çështjen e personave të zhdukur të LAPD-së, në këtë rast dyshohet të jetë trupi i shqiptares 25-vjeçare". Trupi u gjet në një varr të cekët në Kaliforni jugore, rreth 80 km nga Sacramento, mirëpo policia e Los Anxhelosit ende nuk e ka konfirmuar informacionin se trupi është i Aedeas. Adea Shabani u zhduk më 23 shkurt nga shtëpia e saj në Los Anxhelos. Hetimet nuk ka dhënë ndonjë rezultat derisa fundjavën e kaluar, kur Kris Spoc, aktori 33-vjeçar me të cilin Adea ishte në lidhje romantike kreu vetëvrasje me të shtëna në kokë. U zbulua se ai ishte një nga të dyshuarit kryesorë në hetimin për Adean e zhdukur. Në të njëjtën kohë, mediat kanë shkruar se policia ka një dëshmitar, i cili pa aktoren duke u futur me dhunë në bagazhin e makinës së Kris. Adea u zhvendos në Amerikë dy vjet më parë. Ajo studioi në Akademinë e Stella Adler dhe u përpoq të bënte një karrierë në Hollivud.

## Të ardhurat mbi 1000 euro të taten me 18 për qind

Shkup, 28 mars - Në muajin prill, siç ishte paralajmëruar, do të fillojë debati për vendosjen e taksave progresive. Siç tha ministri i Financave, Dragan Tevdovski, propozohet për të ardhura deri në një mijë euro tatim, ndërsa për çdo të ardhura të

realizuara mbi kufirin prej një mijë eurove - tatimi të jetë 18 për qind, ndërsa të tillë janë rreth 2 për qind e qytetarëve të Maqedonisë. "Ky është propozimi fillestar i Ministrisë së Financave që do të vendoset në debatin publik. Propozimi është

përkthyer edhe në propozim-zgjidhje ligjore e cila do të vendoset në ENER që të mund qytetarët ta shohin dhe të japin propozime, sugjerime dhe mendime të tyre", theksoi Tevdovski në forumin "Ekonomia e Maqedonisë midis vizionit

dhe dilemave". Sipas tij, përvoja me vendosjen e tatimit progresiv, siç tha Tevdovski, tatim të drejtë ka Shqipëria e cila normat e tatimit personal i ka rritur në 13 dhe 23 për qind dhe me këtë rast nuk e ka humbur konkurrencën.

LËSHUAN NË QARKULLIM MJETETË DËMSHME PËR MJEKIM

## PADI PËR DY BARNATORE NGA KUMANOVA

Shkup, 28 mars - Pronari i Shoqatës për tregti me shumicë dhe pakicë "Geo-farm" dhe pronari i farmacisë "Shendi Farm" nga Kumanova kanë marrë kallëzime penale për lëshimin në qarkullim të mjeteve të dëmshme për mjekim dhe për evazion tatimor. Kallëzimi penal kundër 50 vjeçarit M.B. pronar i "Geo-farm" është parashtruar për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizim, prodhim dhe lëshim në qarkullim të mjeteve të dëmshme për mjekim, evazion tatimor dhe falsifikim të dokumenteve, ndër-

sa 44 vjeçari A.I. nga farmacia "Shendi farm" dyshohet për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizim, prodhim dhe lëshim në qarkullim të mjeteve të dëmshme për mjekim dhe evazion tatimor. Sipas policisë, në periudhën nga 28 marsi deri më 27 prill të vitit të kaluar, pronari dhe drejtuesi i "Geo-Farm" në pesë raste të kozmetikës farmaceutike dhe industrisë dietetike nga Maqedonia ka furnizuar 57.000 kuti analgetik opijat "tramadol" në vlerë të përgjithshme prej 2.920.942 de-

narë. Farmacisë "Shendi farm" vitin e kaluar i ka shitur 34.000 kuti në vlerë prej 1.955.000 denarë, ndërsa pjesën e mbetur prej 23.000 kutive në vlerë prej 1.414.099 denarë ua ka lëshuar në qarkullim personave të panjohur, për çka në evidencën për llogaridhënie ka treguar të dhëna të rreme me çka ka fshehur pagesën e tatimit prej 67.332 denarëve. Pas kontrollit të kryer më 9 shkurt të këtij viti nga prilli i Agjencisë për ilaçe dhe pajisje mjekësore, M.B. ka përgatitur pesë fatura në të cilat ka theksuar

se në periudhën nga 31 janari deri më 5 shkurt të këtij viti farmacisë "Shendi farm" i ka shitur 34.000 kuti "tramadol". Nga ana tjetër, A.I. si pronar i farmacisë "Shendi farm" në periudhën nga 28 marsi deri më 16 maj të vitit të kaluar, kontrollat e bëra sipas faturave nga furnizuesi, në 17 rast nga "Geo-farmi" ka furnizuar 34.000 kuti "tramadol" në vlerë të përgjithshme prej 2.052.920 denarë. Për furnizimin i ka kryer pagesë "Geo-farm" që është evidentuar përmes certifikatave të llogarive bankare,

ndërsa sasinë e furnizuar të "tramadolit" aspak nuk e ka treguar në kontabilitetin material gjatë vitit 2017. Gjatë kontrollit nga Agjencia për ilaçe dhe pajisje mjekësore, përveç parregullsive të theksuara është konstatuar se farmacia e ka dhënë analgetikun pa recetë nga specialisti me çka është shmangur pagesa e tatimit prej 97.750 denarë. Të denoncuarit së bashku e kanë dëmtuar Buxhetin e Republikës së Maqedonisë në vlerë të përgjithshme prej 165.082 denarë. (O.XH)



RRITET NUMRI I PACIENTËVE QË NUK I PËRBALLOJNË DOT  
NDRYSHIMEVE KLIMATIKE



Krahas simptomave të gripit, po ashtu pacientët në këtë periudhë përballen edhe me lodhje, mungesë të koncentrimin, pagjumësi..., të cilët janë pasojë e ndryshimit rapid të klimës dhe temperaturave gjatë ditës, nënvizojnë mjekët

# NDRYSHIMET E KOHËS MBUSHIN AMBULANCAT

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 28 mars - Edhe pse zyrtarisht pranvera ka filluar më 21 mars, këtë vit erdhi me ndryshime të mëdha klimatike. Përdërisa qytetarët kaluan një dimër jo relativisht të ftohtë, megjithatë marsi u karakterizua me borë, reshje të shiut dhe ndryshime të shpeshta të klimës.

Kjo ka bërë që kohëve të fundit, sëri- sh të stërmbushen me pacientë ambulancat private dhe ato të mjekësisë së përgjithshme. Me shumë vështirësi këta ndryshime klimatike i përballojnë pacientët me sëmundje kronike, fëmijët dhe të moshuarit. "Zakonisht, në këtë periudhë më shumë këto ndryshime ndikojnë tek pacientët e moshuar, ata që kanë problem kardiovaskulare dhe të sëmurit kronik. Të njëjtit nuk mund të përballojnë këta ndryshime të temperaturave që ndodhin brenda ditës, prandaj edhe kemi pasur numër të shtuar të pacientëve", tha mjeku Bekim Ismaili. Sipas tij, kjo ka ndikuar edhe tek fëmijët, të cilët qëndrojnë pranë shokëve të tyre që kanë patur grip. "Kjo ndodh edhe tek fëmijët që shkojnë në çerdhe apo shkolla, ku ka më shumë fëmijë në një ambient të

mbyllur dhe kjo më pas përcillet. Prandaj, në këto raste duhet të kenë më shumë kujdes", theksoi Ismaili.

Krahas simptomave të gripit, po ashtu pacientët në këtë periudhë përballen edhe me lodhje, mungesë të koncentrimin, pagjumësi..., të cilët janë pasojë e ndryshimit rapid të klimës dhe temperaturave gjatë ditës, nënvizojnë mjekët.

"Këtu nuk përjashtohet edhe kategoria e moshës nga 18 vjet deri në 40 apo 45 vjet, të gjitha kategoritë, grupmoshat janë të kapluara, por si ashtu si target grupa e popullsisë janë ato pacientët të cilët kanë sëmundje kronike, pacientët me sëmundje reumatike të ndryshme, pacientët të cilët kanë probleme me tensionin e gjakut gjegjësisht ata me hipertension, sëmundje të sistemit respirator të mushkërive, siç është astma, mandej kemi të bëjmë me pacient të cilët kanë pasur ndonjë ndërhyrje kirurgjikale, të cilët po ashtu kanë dhimbje", pohojnë mjekët në Ndhimën e Shpejtë të Tetovës. Pacientët zakonisht janë ankuar për dhimbje koke, kollitje, temperaturë dhe problem me tensionin e gjakut. "Por ka edhe pacient të cilët kanë sëmundje bakteriale,

kemi të bëjmë edhe me pacientë të cilët kanë pësuar, gjegjësisht janë sëmurë, ftohur nga mos kujdesi i ndryshimeve klimatike, për shembull ata të cilët nuk janë kujdesur sa duhet sa i përket veshjes edhe tek ata paraqiten dhimbje të ndryshme të muskujve, apo dhimbje eshtrash nëse janë të sëmurë kronik", apelojnë mjekët. Mjeku Bekim Ismaili thotë se në këtë periudhë që vjen, pritet që të kenë probleme edhe personat me alergji. Gjithnjë, sipas tij, edhe ky numër është në rritje e sipër.

"Me ardhjen e pranverës kur ka edhe më shumë gjelbërim, ka më shumë lule që çelin dhe normalisht ka shumë qytetarë që e kanë problem këtë stinë, sidomos ata me alergji. Prandaj edhe rekomandohet që në këtë kohë ata të jenë më të kujdesshëm dhe të marrin terapinë e nevojshme që të mos kenë përkeqësime të shëndetit", sqaroi ai. Ditëve në vijim pritet të përmirësohet koha dhe përfundimisht qytetarët të shkëputen nga sezoni i dimrit, i cili edhe këtë vit shënoi numër rekord të të sëmurëve me virusin e gripit. Nga ky repart theksojnë se qytetarët duhet që të kenë kujdes në këtë periudhë që vjen.

## Mjekim falas për personat deri në 18 vjet nga familjet sociale

Shkup, 28 mars - Personat të moshës deri në 18 vjet familjet e të cilave janë shfrytëzues së ndihmës sociale në para nuk do të paguajnë participim gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore. Këtë vendim të mërkurën në seancë e mori Qeveria, ndërsa e elaboroi ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, i cili së bashku me ministren e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska dhe kryetari i Komunës Gjorçe Petrov, Aleksandar Naumovski, e vizituan organizatën civile "Lil", e cila e ngriti nismën që këta persona të lirohen nga pagesa e participimit. "Me këtë presim të rritet qasja e shërbimeve

shëndetësore dhe të kursethet ky grup i rrezikuar nga shpenzime shtesë financiare gjatë realizimit të së drejtës për mbrojtje shëndetësore. Këta të rinj falas do të kurohen në të gjitha institucionet shëndetësore publike, veprimtari konsultative dhe spitalore. Bëhet fjalë për program të cilin do ta zbatojë Ministria e Shëndetësisë me të cilën do të përfshihen 20.000 persona dhe nga buxheti janë ndarë 20 milionë denarë", tha Filipçe. Ministrja Carovska theksoi se bëhet fjalë për masë humane e cila do të jap cilësi në jetesën e familjeve marrës së ndihmës sociale në para. Lirimi nga

participimi për shërbime shëndetësore, kurim spitalor dhe veprimtari konsultuese specialiste", theksoi Carovska, janë mbështetje shtesë dhe e rëndësishme për familjet të cilat marrin ndihmë sociale në para. "Për ne si Qeveri çdo fëmijë është i rëndësishëm dhe çdo fëmijë duhet të ketë të drejtë të zhvillohet dhe rritet në kushte të shëndosha dhe përkatëse. E dimë se mbrojtja shëndetësore ende është në nivel të ndjeshëm për këtë shkak se trashëguam një sistem të shkatërruar. Me uljen e shpenzimeve mbesin më shumë mjete për jetë", tha Carovska.

## KRONIKË

### Shkup, 9 aksidente me dy të lënduar rëndë

Lëndime të rënda trupore kanë marrë një këmbësor dhe një motoçiklist në dy prej gjithsej nëntë aksidenteve që kanë ndodhur gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB-Shkup. Në pesë aksidentet lëndime më të lehta kanë marrë shtatë persona, ndërsa në dy është shkaktuar dëm material. Nga MPB informojnë se mbrëmë policia e komunikacionit ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të shkeljeve. Tridhjetë e tre shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, pesë shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, tre shoferë nuk kanë dhënë përparësi për kalimin e këmbësorëve në vendkalim për këmbësorë dhe katër shoferë për tejkalim të parregullt. Është sanksionuar edhe një këmbësor, i cili ka kaluar rrugën jashtë vendkalimit për këmbësorë. Nga trafiku janë përjashtuar një shofer për shkak të drejtimit të automjetit nën ndikim të alkoolit, 13 të tjerë janë përjashtuar nga trafiku para se ta marrin të drejtën për drejtim të automjetit, dhe një shofer fillestar, si dhe një ka drejtuar automjetin teknikisht të parregullt dhe 14 automjete të paregjistruara. Janë hasur edhe 91 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit special "karrotrec" janë larguar 80 automjete.

### Sulmohet 27 vjeçari para marketit të tij

27-vjeçari me iniciale B.G nga Reçica e Vogël, të martën mbrëmë pas mesnate ka denoncuar se gjashtë persona, nga të cilët disa i ka njohur, rreth orës 20:30 minuta i kanë shkaktuar lëndime të rëndë. Në afërsi të marketit të tij "Europetrol", në rrugën e Ilindenit në Tetovë, fillimisht pasi ka dëgjuar zëra të zhurmshëm dhe ka parë se të gjashtë personat po konsumonin drogë, ka kërkuar nga ata që ta lëshojnë vendin. Pas kësaj, menjëherë është sulmuar fizikisht duke i shkaktuar lëndime në fytyrë dhe thyerje të hundës dhe më pas menjëherë janë larguar. Po ndërmerren masa dhe aktivitete për gjetjen e sulmuesve si dhe zbardhjen e plotë të rastit.

### Djali sulmon nënën në Gostivar

66-vjeçarja me iniciale S.G nga Gostivari ka denoncuar dhunë familjare, të cilën e ka kryer djali i saj, 44-vjeçari me iniciale D.G. Ditën rreth orës 13 ai nga nëna e tij ka kërkuar 500 denarë, ndërsa kur ajo nuk i ka dhënë shumën e kërkuar të parave, me grushte ka filluar që ta godas në trup, si dhe me një kablo e ka goditur disa herë në shpinë. I denoncuar D.G është arrestuar dhe mbajtur në stacionin policor të Gostivarit për zbardhjen e plotë të rastit dhe të gjitha detajeve të tjera që ndërliken me rastin në fjalë.

### Gruaja sulmohet nga qentë endacak

43-vjeçarja me iniciale SH.B nga fshati Skudrinjë i Rekës së Poshtme, dje ka denoncuar se një ditë më parë, rreth orës 14.00 në vendin e ashtuquajtur Fariçovci në afërsi të shkollës së fshatit është sulmuar dhe kafshuar nga dy qen, të cilët i kanë shkaktuar lëndime në dy këmbët e saj. Një kalimtar i rastit ka arritur që ta shpëtojë dhe më pas menjëherë është drejtuar për ndihmë në Spitalin e Gostivarit. (U.H)

Një nga ngjarjet më të mëdha ndërkombëtare këtyre ditëve është çështja e gjithë të dhënave që eksitojnë në botën digjitale dhe si janë përdorur për qëllime politike. Për ta thënë më direkt, çdo "like" në Facebook, krijon gjurmë, nga të cilat, ata që i shohin mund të krijojnë profilin tuaj politik. Pra, preferencat tuaja zbulojnë preferencat politike dhe si rrjedhojë ju mund të "sulmoheni" me propagandë të targetuar veç ndaj jush, me qëllim që të ndryshoni mendjen dhe në fund të votoni kundër opsionit që preferoni. Keni luajtur ndonjëherë ndonjë kuic? Lojat me pyetje nga më të ndryshmet, çfarë kafshë jeni? Cila është origjina juaj e vërtetë? Kujt personazhi i ngjan? Et të tjera si këto, pikërisht këto dhe gjithë reagimet tuaja në rrjetet (a)sociale ju kanë "zhveshur" dhe i gjithë karakteri juaj, dëshirat tuaja, janë në dorë të reklamuesve dhe tashmë dhe propaganduesve politik.

E gjithë kjo çështje me privatësinë, intimitetin dhe politikën doli në sipërfaqe para disa muajsh kur në median botërore filloi të qarkullojë emri i kompanisë Cambridge Analytica. Kompania e konsulencës u përmend se kishte influencuar votuesit pro Presidentit Trump, apo dhe pro Brexit. Që pastaj vetëm para pak ditësh të njoftohet se kompania në fakt kishte ndikime të mëdha në procese zgjedhore në më shumë vende të botës.

Nëse hyn në faqen e internetit, slogani i kësaj kompanie thotë: Të dhënat janë shtysë për gjithçka që ne bëjmë (Data drives all that we do). Dhe po gjithçka ka të bëjë me informacione që shkojnë deri te brekët e secilit dhe më shumë.

Ajo që bën kompania britanike e konsulencës, ose përshkrimi i punës së saj nënkupton kombinimin nga gërmimi i të dhënave (proces që do të thotë gjetjen e veprimeve rutinë në sasi të mëdha informacionesh), shitblerjen e të dhënave nga kompani të ndryshme dhe analizën e të dhënave. E gjitha kjo me komunikime strategjike për qëllime elektorale. Ose në përkthim, përpunim i të dhënave dhe përhapje të mesazheve për manipulime zgjedhore.

Para se të kaloj në shtjellimin e çështjes se pse kjo është e rëndësishme për ne, për TY, ajo që dihet deri më tani është se kompania britanike ka përdorë 50 milion profile nga Facebook-u pa leje për të ndërtuar sistem i cili shënjestronte votuesit amerikan me mesazhe të personalizuar politike të bazuara në profilin e tyre psikologjik. Pra, edhe një herë, për secilin prej nesh mund të ndërtohet profil psikologjik, bazuar nga preferencat dhe reagimet tona në Facebook dhe pas kësaj mesazhet politike ndërtohen për secilin prej nesh veç e veç. Që tmerri të jetë më i madh, punonjësit si dhe drejtori tani më i pezulluar i

## Facebook-un siç nuk e njihni

Cambridge Analytica, Alexander Nix, janë filmuar ku pranojnë se kanë krijuar skandale seksuale, lajme të rrejshme dhe truqe të padrejta për kundërshtarët politik të klientëve të tyre, për të arritur rezultatet zgjedhore në favor të klientëve të tyre.

Facebook-u në këtë skandal është përfshirë sepse ka pasur paralajmërimet se të dhënat që ka për secilin prej nesh mund të keqpërdoren nga kompania që është në qendër të skandalit, por e ka bllokuar atë vetëm muajin që shkoi. Si rrjedhojë edhe Facebook po hetohet kurse aksionet e tij janë në rënie të lirë.

E tani, si lidhet e gjithë kjo me ne? E para fare është se në Veles, ka disa të rinj që prodhojnë lajme të rrejshme dhe i publikojnë ato në faqe interneti me emra të ngjashme të mediave me relevancë. Lajmet shkruhen me stil dhe strukturë profesionale, por përmbajtja dhe faktet nuk janë të vërteta. Në këtë mënyrë, ashtu siç përshkruhet edhe me skandalin e Cambridge Analytica, përdoren rrjetet sociale për të përhapur këto lajme me qëllim që të ndikohet elektorati. Që tmerri Facebook-ian të jetë edhe më i madh, dihet tashmë se kompania britanike ka bashkëpunuar edhe me një organizatë nga Maqedonia, e cila nga ana e saj ka marrë pjesë në fushata elektorale. Për korrektësi, sepse ende nuk ka informacione nëse kjo kompani këtu te ne,

ka përdorë metoda të ngjashme si Cambridge Analytica, nuk po e përmend më emër, por gjithsesi dyshimet janë të mëdha se manipulimet e pista teknologjike mund të kenë qenë opsion nga kush do.

Por, ajo që mund të them me siguri, duke ndjekur rastin personal, është se në një moment të tentimit të zhvlerësimit të imazhit tim, dolën një sërë lajmesh të rreme, me deklarata të pathëna nga ana ime me kontekst fetar, të cilat përhapeshin në rrjetet sociale nga faqe dhe profile në gjuhën shqipe që kishin emra të ngjashëm me emisione ose medie që ta bëjnë mashtrimin sa më të besueshëm. Një përvojë të tillë ndër të tjerë, kaloi edhe Anita Latifi, influensuesja e njohur në rrjetet sociale, apo dhe politikanë të ndryshëm. Këto raste tregojnë se keqdashësit, (që nga një hetim i vogël personal lidhen indirekt me struktura aktuale politike) që duan të kenë përfitime politike mund të përdorin metoda nga më të ndryshme me teknologji për të arritur fitore zgjedhore, por që nuk janë të drejta.

Tek ne ende nuk ka rregulla të qarta për këtë fushë, nuk dihen se cilat kompani mund të kenë të dhëna që janë vjelë nga mbjelljet e pëlqimeve dhe komenteve që kemi lënë në rrjetet sociale. Kjo formë e re e propagandës së sofistikuar me teknologji, mbase as nuk kuptohet nga një pjesë e

**Forma e re e propagandës së sofistikuar me teknologji, mbase as nuk kuptohet nga një pjesë e madhe e popullsisë, por efektet e saj duken se janë të tmerrshme. Nga hetimet paraprake me kompaninë Cambridge Analytica, del se ajo mund të ketë ndikuar me pa të drejtë dhe duke rrëmbyer konceptin e demokracisë në zgjedhje...**



madhe e popullsisë, por efektet e saj duken se janë të tmerrshme.

Nga hetimet paraprake me kompaninë Cambridge Analytica, del se ajo mund të ketë ndikuar me pa të drejtë dhe duke rrëmbyer konceptin e demokracisë në zgjedhjet presidenciale në SHBA dhe gjatë referendimit për largimin e Britanisë së Madhe nga BE. Pavarësisht se çdo të nxjerrin hetimet, një gjë është e sigurt, të dhënat dhe përpunimi i tyre me algoritme e sisteme mund të sjellin një tjetër propagandë, e cila mund të përdoret nga struktura politike që me hile të vinë në pushtet. Është e qartë tashmë se këto të dhëna përdoren për arsye komerciale, dhe këtë mund ta vini re, ku në profilin tuaj, shfaqen reklama të ndryshme nga të afërmit tuaj, sepse reklamuesit ju targetojnë sipas preferencave. Tashmë është e evidente se kjo do të bëhet edhe për qëllime politike, proces ndaj të cilit ende nuk kemi shumë imun. Pas skandalit me Cambridge Analytica që përfshin shumë vende në gjithë botën, një eksperte e teknologjisë sugjeronte se bota digjitale ka hyrë aq thellë në intimitetin tonë, sa në disa raste mund të jetë dhe i vonë reagimi. Megjithatë porosia e saj ishte: Mbylleni profilin në Facebook! Por, a e bëni dot?

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)



Nga Nazim RASHIDI

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 28 mars | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

**N**ë viset me furtunë rriten pishat e gjata, është fjalë e urtë, thua se pa autor, meqenëse është përvetësuar nga shumë popuj. Ajo është shfrytëzuar edhe nga shumë shkrimtarë duke e përdorur si titull veprash letrare. Edhe unë do ta shfrytëzoj këtë mundësi për ta përdorur atë si titull të këtyre pak rreshtave të këtij shkrimi. Simbolika e saj më pëlqen shumë për shkak të simbolikës së saj dhe për një "çik" vlere aksiomatike që ka. Këtë të dytën e shoh kështu, ndoshta, për shkak të një deformim profesioni që më ka mbetur mua mësuesit të dikurshëm të matematikës. Aksiomat merren si të vërteta të gatshme, sepse ato nuk kanë nevojë për prova.

Këto vise tona, gjatë historisë së tyre, janë rrahur me furtuna të mëdha, e në këto kushte të këtilla janë rritur edhe lisa të këtillë, të cilët vazhdimisht i ka rrahur era. Pranë tyre janë zhvilluar edhe shkurre, mirëpo ato as si ka rrahur era, e as mbi to ka rënë rrufeja. Fjalët lis e shkurre shërbejnë edhe si simbole që në rastin në fjalë konsistojnë zëvendësimin e emrit - njeri si objekt. Lisi emrin e njeriut të madh, por jo vetëm për gjatësinë dhe forcën e madhe që ka, por edhe për një mori vetish pozitive të tij, përkundër shkures si simbol që konsiston zëvendësimin e emrit të njeriut të vogël, pa energji, po edhe pa ose me shumë pak veti pozitive.

#### NË BALLKAN ENDE KA BURRNESHA

Ka njerëz që e meritojnë simbolin lis, njerëz që të lavdërohen prej njerëzve që i rrethojnë për vërtetë e tyre njerëzore që kanë. Unë në këto pak fjalë të këtij teksti, do të vë në pah emrat e dy grave për madhësinë e treguar këto ditë, në këtë ambient tonin të zymtë, të cilat me qëndrimet e tyre, me veprën, thua ja burrërore, ngjasonin shumë me personazhe femrash të veprave klasike, mbështetur në mitologjinë greke.

Në këto skuta të Ballkanit, dmth. dhe ndër ne në këtë shtet, tonin të vogël, jetojnë ende të këtilla burrneshash. E kam fjalën për dy gra, nëna fëmijësh, por krijesa burrash të vërtetë në sjellje. Them nëna për ta dalluar këtë tip burrneshash nga ai tip që i përmend historigrafia shqiptare, të cilat me veshje dhe sjellje burrash plotësonin dëshirën e prindërve, në mungesë të mashkullit në vatër. Jo të këtilla, por gra - nëna e pastaj edhe burrneshash. Me këto pak rreshta dua t'i përshëndes nënën e madhe të Almiriut të vogël që e pësoi nga një vrasës fëmijësh dhe, zonjën e madhe, Frosina Remenski, deputete e LSDM-së në parlamentin e R. së Maqedonisë, e cila ngriti zërin e para, para të gjithë burrave, kundër atyre mburrave që trazonin

# Në viset me furtunë rriten pishat e gjata



Nga  
Haki YMERI-BINA



**Në këto skuta të Ballkanit, dmth. dhe ndër ne në këtë shtet, tonin të vogël, jetojnë ende të këtilla burrneshash. E kam fjalën për dy gra, nëna fëmijësh, por krijesa burrash të vërtetë në sjellje. Them nëna për ta dalluar këtë tip burrneshash nga ai tip që i përmend historigrafia shqiptare, të cilat me veshje dhe sjellje burrash plotësonin dëshirën e prindërve, në mungesë të mashkullit në vatër. Jo të këtilla, por gra - nëna e pastaj edhe burrneshash**

njerëz të pafajshëm, e edhe më keq, frikësonin dhe terrorizonin fëmijë në gjumë. Këto zonja mund të krahasohen me ato femra të mitologjisë greke që shquheshin për trimëri, drejtësi, besnikëri, shpirtmadhësi, normalisht edhe me bukuri, të cilat rregullisht gjendeshin në vende ku duhej ndihmuar i varfëri, i dhunuari, i pafati etj. Ato, përgjithësisht, mbanin anën e të voglit dhe të të pamundurit.

Ndodhën protestat para shtëpive të deputetëve të grupit parlamentar të partisë së LSDM-së, në kohë pa kohë, protesta që ngjasonin me ato të natës së thikave. Aty, këta protestues nuk zgjidhnin mjete për t'i fyer dhe ofenduar kolegët parlamentarë të partisë kundërshtarë, familjet e tyre, po edhe të fqinjëve të tjerë, sepse këta, sipas tyre, nuk menduan ashtu si ç' mendojnë protestuesit. Nuk patën mëshirë as ndaj fëmijëve, të cilët i frikësuan edhe i torturuan pa masë.

Në këto momente të rënda del në pah figura madhështore e një gruaje trimëreshë, deputete e parlamentit të R. së Maqedonisë, e cila si votuese e Ligjit të gjuhëve dhe mbrojtëse e të drejtave, jo vetëm të shqiptarëve, por edhe e të gjitha kombeve të shtetit tonë, u sulmua në prag të shtëpisë së saj. Parullat dhe fjalët e ndyra që u thanë në shtëpitë e të pambrojturëve, i quajti pafytyrësi dhe elemente fashizmi, ndërsa pjesëmarrësit në këto protesta i quajti "varrtarë të paqes dhe të ardhmërisë së shtetit tonë, si dhe të fesë në të cilën ata në mënyrë të rrejshme po betohen". Në fund të paraqitjes me hidhërim dhe me trimëri të pashoqe para asaj turme të tmerrshme, pa asnjë pikë frike, ju tha: "Tani e

tutje do të jem, jo vetëm maqedonase, por edhe shqiptare, turke, rome, boshnjake...", me porosi se këta demonstrantë të padenjë mund ta thërrasin atë si të duan.

Kjo femër - trimëreshë - me këtë deklaratë ua bëri demonstruesve në dije se ky ligj nuk është vetëm për gjuhën shqipe, po për të gjitha gjuhët të cilat do ta plotësojnë një ditë këtë kusht të 20% (20 përqindëshit), ligji i cili edhe në disa pika të R. së Maqedonisë, po tolerohet pa e plotësuar këtë kusht, siç është rasti i Komunës së Vrapçishtit me turqishten, ose rasti i komunës së Luboshit, të Shkupit, me boshnjakishten.

Ndër shumë protesta të tjera, u organizua edhe protesta lidhur me vrasjen e Almiriut katërvjeçar. Më drejt një protestë kundër padrejtësisë së prokurores Suzana Kusigerska dhe prokurorit Lubomir Jovevski për rikualifikimin e veprës penale të të pandehurit Boban Iliq, prej asaj vrasjeje me paramendim, në aksident komunikacioni me pasojë të rëndë-vdekje. Po, mu kjo padrejtësi e madhe që ju bë prindërve të Almiriut preku shpirtit e shumë njerëzve. Protestë dinjitoze. Askush nuk u fye, madje as për vrasësin e as për shtetin në të cilin veprojnë këso prokurorësh dhe gjykatësish të ngarkuar me kësosh paragjykimesh, të cilët me këso ndarje të drejtësisë nuk meritojnë të kryejnë detyra të këtilla, prandaj me të drejtë u kërkua largimi i tyre nga kjo detyrë.

#### TË NDJEHESH BURRË I DOBËT PARA NËNËS SË ALMIRIT

Në këtë protestë, në momentin e leximit të letrës, doli në pah një Nënë-burrneshë e madhe, lexuese e kësaj letre. Kjo fisnike e lexonte

letrën pa iu dridhur aspak zëri. Nuk i pikonte asnjë pikë loti. E them me siguri se kjo NËNË e madhe e kishte zemrën e përvëlur, por në këtë situatë të rënduar tregohej madhështore. Isha vetëm në dhomë dhe e dëgjoja. E ndjeva veten burrë të dobët pse më rridhnin lot, por nuk u turpërova. ALMIRI i vogël i meritonte këto pika loti të një plaku të shtyrë mjaft në moshë. NËNA e madhe vazhdonte të lexojë, duke thënë se: Në protestë nuk kishte dalë vetëm për fëmijën e saj, por për të gjithë fëmijët që rrezikohen nga kriminelë të këtillë, të cilët i mbron shteti. Almiri nuk dinte të bënte dallime etnike... "ai kishte ëndrra fëmijërore që një ditë të shkonte në shkollë, të lozte me shokët, por fatkeqësisht një kriminel me dashje ia ndaloi këtë. Almiri im nuk do të kthehet më, por të paktën, fëmijët tuaj të jetojnë të lirë...". Paramendoni një shpirtmadhësi kaq të madhe të një nëne shumë fisnike, e cila edhe në këto momente, mendon për fëmijët e të tjerëve.

E nderuara ZONJË E MADHE, ju e humbët Almirin Tuaj. Atë nuk mund Tua kthejë askush. Ne mundohemi, sado pak, Tua zvogëlojmë atë dhembje të madhe që e keni. Jam më se i sigurt se emri ALMIR, tash e tutje, do të jetë emër më i shpeshtë në familjet tona. I pari që do të lind në këto ditë, me siguri do të pagëzohet me emrin e bukur ALMIR. Edhe të gjithë Almirët e tjerë që do të lindin e do të pagëzohen kështu, do të jenë të bukur si ALMIRI Juaj. Besomëni se, tash e tutje, nuk do të ketë emër më të bukur se emri ALMIRIT tuaj. Ju lutem, ju dhe bashkëshortit Juaj dhe tërë familje suaj t'i pranoni ngushëllimet e përzemërta nga një bashkëqytetar i Juaji.

VISAR ETEMI, AKTOR

# HUMORI QË TË MBAN PËRHERË NË KËMBË!



Momentin kur babai përgatite gardërobën e shfaqjeve, e mbaj mend edhe këtë ditë, ai përgatiste veshjet e aktorëve të asaj kohe, që sot edhe nuk janë në mesin tonë. E unë qëndroja prapa skenës dhe vështroja çdo lëvizje të babait dhe aktorëve. Kështu që kuptova se do të merrem me këtë profesion

Koha

Delvina KËRLUKU

Visar Etemi ka lindur më 9 janar të vitit 1983, në Shkup. Filloren e kreu në shkollën "LIRIA", gjimnazin në "Zef Lush Marku", ndërsa Fakultetin e Arteve në "Shën Kirili dhe Metodi", ku edhe i përfundoi studimet në vitin 2007. Deri më tani ka 40 role që ka interpretuar. Është i punësuar në Teatrin Shqiptar të Shkupit dhe ka 11 vite karrierë. Si kryetari i shoqatës "Abrakadabra", do të luaj një rol të rëndësishëm për aktivitete të ndryshme, si një shoqëri e aktorëve profesionist, për film dhe teatër. Në teatrin shqiptar të Shkupit ka luajtur shfaqen e parë "Vdekja aksidentale e një anarkisti". Më pas shfaqjen "Pergiti", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Kuçedra", etj. Visari, sa e hodhi hapin në skenë, do të marrë meritat më të mëdha, ku edhe ju hapën shtigjet për të marrë role të veprave të ndryshme. Ka vepruar si aktor brenda dhe jashtë vendi. Është i martuar dhe ka dy vajza.

**KOHA: Mbjam mend që në fëmijëri kemi patur shumë qejf jo vetëm shfaqjet teatrore, por edhe filmat. Çfarë e lidh jetën e fëmijërisë tuaj me teatrin ose kinematografinë?**

**ETEMI:** Unë rrjedh nga një familje shqiptare e Shkupit. Babai im ka qenë pjesë e Teatrit të Shkupit, si rrobaqepës. Sa here që ikte ai në teatër, e ndiqja dhe kjo ndodhte shpesh, thua se çdo ditë. Isha vetëm 7 vjeç, kur kuptova se Teatri ishte shtëpia jonë e dytë. Momentin kur babai përgatite gardërobën e shfaqjeve, e mbaj mend edhe këtë ditë, ai përgatiste veshjet e aktorëve të asaj kohe, që sot

edhe nuk janë në mesin tonë. E unë qëndroja prapa skenës dhe vështroja çdo lëvizje të babait dhe aktorëve. Kështu që kuptova se do të merrem me këtë profesion. Madje, që në moshë të hershme vërehej se jam i lidhur pas këtij arti. Kam edhe hartimin nga klasa e tretë fillore, ku e ruaj edhe sot, pra të shprehurit me shkrim, me temë "çka do të bëhesh", kam shkruar se do të bëhem aktor dhe kjo ëndërr u realizua. Ishte takimi me teatrin që zgjoi pasionin dhe ëndrrën time, se pas filmave nuk isha shumë i dhënë. Ne e dimë të gjithë se çfarë probleme dhe mangësi kemi patur atë kohë. Nuk kishim televizor ose edhe kur u bëmë me të, nuk ishin programet e Shqipërisë, Kosovës... Ne në Maqedoni nuk kemi patur të zhvilluar edhe aq kinematografinë. Të gjitha filmat që i kemi ndjek për fëmijëri i kemi ndjek në gjuhën maqedonase. E mbaj mend që babai kur shkante në Shqipëri, përherë në çantën e tij kishte kaseta me filma dhe mund të them se ato filma më vonë i kemi shikuar pesëdhjetë herë në familjen time.

**KOHA: Afrimi me aktrimin ishte një okazion? Besoni se në jetë ndodhin çudira? Si e përshkruani ciklin e jetës tuaj në sferën e artit?**

**ETEMI:** Kam kryer studimet në vitin 2007. Si fillim kam ndjekur fakultetin në Universitetin e Tetovës, pastaj kalova në fakultetin e arteve në "Shën Kirili dhe Metodi". Jam i punësuar në Teatrin Shqiptar të Shkupit dhe kam 11 vite karrierë. Roli im i parë ka qenë "Vdekja Aksidentale e një Anarkisti", të Dario Fo, ku kam patur rolin e policit dhe pastaj

varguan rolet e tjera, ku janë më së paku 40 role.

**KOHA: Interesi i madh që është shfaqur për telenovelat brenda dhe jashtë vendit është bërë shkak edhe për të ndal hapin e publikut për në teatër. Si të dalim nga ky ngërç dhe si të zgjojmë interesimin e publikut për teatrin?**

**ETEMI:** Është për ta thënë se unë jam kryetari i shoqatës "Abrakadabra", për art dhe kulturë. Një shoqëri e aktorëve profesionist vetëm për film dhe teatër, ku edhe kam patur disa projekte. Në vitin 2010 e kemi patur një telenovelë, e cila u transmetua në televizionin Alsat-M. Ka qenë "Hoteli i Mihanës", gjegjësisht aktorët e Maqedonisë. Por mund të them se ne

jemi vetë ato që e lindim dhe e mbysim fëmijën tonë, me duart tona. Por e kemi një ves ne që nuk pyesim për punën një javë e më shumë, ndërsa nuk e dimë se vdesim për bukë javën e dytë, fatkeqësisht. Ne duam të bëhemi të pasur brenda muajit me profesionin tonë, ndërsa nuk i shohim kolegët tanë që nuk kanë patur bukë e kulme, por pikërisht janë këta që e kanë mbajtur teatrin me qindra herë më mirë se ne. Kjo është një ditë e sotshme, ku i kemi kushtet në nivel të lartë, në krahasim me ato (të parët tanë).



Kam dëgjuar që një institucion i lartë ka marrë hapin që ti prish "telenovelat", ku edhe kanë marrë hov përhapja e tyre, ndërsa ne nuk kemi prodhimin tonë. Telenovela shikohen në gjithë botën, por më pak në Shqipëri dhe Kosovë, se kjo e fundi ka tre seriale të veta, kurse Shqipëria ka seriale të ndryshme në nivel të lartë siç mund të përmend "Apartamenti 2 XL" dhe "Portokallia", ku ky i fundit ka zgatur, deri më tani, 18 vite, si asnjë seria tjetër. Jam "xheloz" ndaj kolegëve tanë që jetojnë në Shqipëri. Por, me plot bindje mund të them, që aktorët që jetojnë në vendin tonë janë shumë më të mirë se të Kosovës dhe Shqipërisë, por fatkeqësisht vlerësimi është i pakët. Kemi patur rastin që aktori Xhevdet Jashari nga vendi jonë ta kemi në serialin "O sa mirë", i cili bëri zhurmë të madhe dhe seriali mori një hap tepër të madh. Me këtë desha të tregoj se çfarë kualiteti kemi ne. Ndërsa ne, shqiptarët në Maqedoni, kemi një serial "Hoteli i Mihanës", por u ndërpre shkaku i financave. Unë personalisht nga ai serial nuk kam marrë asnjë qindarkë, edhe pse 3 vite kishim punuar. Premtime për pagesa plot kemi patur, por asnjëherë nuk i kam marrë pagesën e duhur. Pastaj, nga Alsat-M, ku edhe transmetohej e transferuam në MTV 2, me vetë iniciativën time, ku edhe u bëra producent me dy kolegët e mi. Dhe, për dy vite u transmetua në televizionin shtetëror të Maqedonisë. Por, atë që desha ta them se nuk duhet ta gënjejmë veten se nuk kemi publik, kur në "YouTube", persona që bëjnë incizime dhe i bartin në internet (pa ofenduar kënd) ose në "facebook" dhe në përgjithësi rrjete sociale, arrijnë me mijëra klikime. Kjo do të thotë se audienca jonë është e uritur për aktivitete të ndryshme. Sidomos publiku shkupjan aq e mirëpret komedinë sa nuk ndodh në ndonjë vend tjetër, por fatkeqësisht nuk organizojmë. Ndërsa, telenovelat shihen, por më e mira e interpretimit në televizion është se rriten imazhin e aktorit. Ne kemi Teatrin e Shkupit, por edhe të Tetovës ku ka aktorë shumë të mirë, të cilët ishte mirë që të paktën tre ose katër aktor të angazhohen në seriale, për të mirën e aktorit. Këtë "famë" e kam ndje tre vite dhe e di se çfarë dashurie më pas të falë publiku. Interesimi shtohet edhe i mediave, por edhe njerëzit gjatë rrugës të ndalin kërkajnë një fotografi ose një nënshkrim. E di që këtë intervistë do ta lexojnë shumë dashamirës të mi, ku vetë dëshmitare është shoqja ime, ku në një pushim në bregdet - njerëzit filluan të më afrohen duke më thënë "aktori i televizionit". Kjo është kënaqësia më e madhe për një aktor. Por, them që publiku më i sinqertë janë fëmijët. Ata nuk dinë politikë, prapavijë. Ai është publiku real dhe tregon të vërtetën. Kam patur rastin që prindërit e tyre

më janë lutur që të jem prezent në ditëlindjen e fëmijës së tij, ose të jem i pranishëm në shkollë. Këto janë momente më të bukura për mua si aktor, ku edhe shpesh kujtoj të bukurën në momentet më të vështira, që përballemi në jetë.

Momentalisht Teatri i Shkupit është duke u rinovuar goxha vite, mund të them lirisht, por edhe jam tepër i bindur se kur do të bëhet hapja solemne e teatrit, drejtuesit e kësaj shtëpie të koncentrohen më shumë në PR (marrëdhënie me publikun) dhe besoj që teatri jonë do të ketë të paktën tre repriza ose tre shfaqe në javë. Se do ta kemi teatrin në nivel dhe nuk mund të themi se nuk kemi publik, kur ne kemi një numër të caktuar të shkollave të mesme, në Shkup, që janë rreth 5000 nxënës. Kemi mundësi të ndryshme për ta sjell publikun, por nuk jam kompetent për këtë çështje.

**KOHA: Në vendet e zhvilluara, në metropolet e Turqisë numri i shkollave të aktrimit po rritet me shpejtësi. Kuptohet një rol të madh këtu kanë edhe shumtë e mëdha të parave që marrin aktorët. Te ne si ndodh?**

**ETEMI:** Unë kam qenë pjesë e një seriali të Turqisë, por dihet që interesi i publikut për art dhe kulturë në atë vend është shumë i madh. Por, është një fenomen që nëse publiku nuk është i interesuar për një serial, në episodin e tretë ndërpritet seriali. Isha pjesë e serialit "Fati Sultan Mehmet", ku kam interpretuar një bektashi të Shqipërisë. Kam patur fatin që ta luaj, por fatkeqësisht nuk ka dal në opinion edhe pse kam nënshkruar kontratën ose kam bërë provat e kostumit. Kam arrit deri te prova e serialit 13, por u ndërpre. Gjithsesi, një eksperiencë shumë e bukur. Atje bota e artit është shumë interesante, për shembull ne kemi detyrimisht që në një pjesë skenike të marrin pjesë aktorët, atje mund të jetë që rolin kryesor e ka një kuzhinier, si për shembull personazhin Pollati, i cila gjatë jetës së tij është marrë me përgatitjen e ushqimeve. Por ai vazhdoi në atë drejtim, sepse një serial që zhvillohet një sezon, ata paguhen shumë dhe e kanë jetën e siguar, jo vetëm për vete, por edhe të familjarëve. Kam kolegë nga Turqia që kanë patur pagën për një muaj 28.000 euro.... Ata nuk duan të pyesin pa mos nënshkruar kontratën. Ndërsa, te ne ndodh e kundërta, ne primaren e kemi modestinë.

**KOHA: Keni kryer shkollën në Akademinë e Shkupit. Programet tona të studimit kanë qëllim që të njohë, mbështesë dhe zhvillojë inteligjencën vizuale individuale të studentit. Të ndërtojë tek çdo student një mënyrë të të kuptuarit të arteve nëpërmjet informimit e qëndrimit kritik, e lidhur kjo me kontekstin e nevojave të tyre krijuese dhe intelektuale. Sa e rëndësishme ka qenë Akademia e Artit, dhe ç'rol ka luajtur në jetën tuaj?**

**ETEMI:** Tregova që kam qenë student në Universitetin e Tetovës, ku brenda një viti e ndërpreva, për

arsye personale. Ndërsa, vazhdova në Akademinë e Arteve të Shkupit, ku kam qenë student i profesorit Refet Abazi, të cilit i jam mirënjohës dhe jam krenar që kam qenë student i tij. Ku për moment po punojmë në veprën "Vdekja e Dom Tonic", ku kjo shfaqe edhe përgatitet për hapjen solemne të Teatrit tonë shqiptar. Unë kam patur të luaj me profesorin vetëm në një film, që në Greqi e kemi patur.

**KOHA: Ju keni kolegë të shkolluar që kanë kryer studime në Fakultetin e Arteve të Bukura në Tiranë, Prishtinë, Shkup, etj. Ku takohen dhe ku diferencohen këto fakultete ndërmjet veti dhe sa larg jemi nga fakultetet e Evropës?**

**ETEMI:** Mund të krahasoj fakultetin e arteve të Tiranës, Prishtinës ose ndonjë vendi tjetër, por fakulteti i arteve në Shkup është njëqind herë më i fortë se këto që përmenda. Sepse, nuk mund ta shohim godinën dhe ta vlerësojmë se çfarë ka brenda, por profesorët që janë në Universitetin e Shkupit të "Shën Kirili dhe Metodit", kanë qenë profesorë më me shumë merita në tërë Jugosllavinë. Duke u nis nga profesor Slobodan Unkovski, Vladimir Millçini, Ljubisha Georgevski, Refet Abazi, Iljesa Kaso, e shumë të tjerë, të përkushtuar e me plot merita.

Mund ta them me plot gojë që është një ndër fakultet më të forta në Ballkan e më gjerë. Unë e them që aktorët maqedonas janë shumëfish më të aftë se ato të Beogradit, si Nikolla Ristanovski, Igor Xhambaso, ku nuk krahasohet me asnjë shou-men tjetër. Pra, nga Fakulteti i Arteve në Shkup, të gjithë kanë dal faqebardhë.

**KOHA: Visar, keni interpretuar role, personazhe të veprave të autorëve të mëdhenj, nga veprat e autorëve shqiptar si Gjergj Fishta deri te autori botëror Shekspiri. Çfarë mund të na flisni për rolet tuaja?**

**ETEMI:** Aktori duhet që të mos i ndajë rolet. Por, unë jam aktor që e pëlqej komedinë. Mund të përmend këtu shfaqen e fundit të regjisorit Sulejman Rushitit me shfaqen teatrale "G", të At Gjergj Fishta, autor i cili për mua është një nga personalitetet më të shquara të të gjitha kohërave shqiptare. Kam patur fatin që të luaj në këtë shfaqe, me rolin e gomarit të Baba Tasit. Mund të them që është një përvojë shumë e mirë, të punosh me regjisorin Rushiti. Por edhe me veprën e Shekspirit, kam bashkëpunuar me regjisoren e mirënjohur Diana Dobrova, kemi punuar tre muaj, ku ishin ditë të lodhshme, por besoj që kemi bërë një mega spektakël. Me këtë shfaqe kemi marrë pjesë në dy festivale në Turqi, festivalin e Bursës dhe festivalin e Anlalisë, ku është për t'u veçuar se kemi patur pesëmbëdhjetë minuta duartrokitje, në fund të shfaqjes. Aty ka patur 800 persona, në publik dhe nuk do ta harrojë kurrë atë ndjenjë që më përshkroi pas brohoritjeve të tyre. Dhe shumë shfaqe të tjera, që secila ka mbresat e veta.



**KOHA: Është pikërisht loja e aktorëve ajo që arrin të përcjohet edhe intencën e regjisorit duke na ofruar një cikël të jetës në tërësi. Cili është raporti juaj me regjisorët?**

**ETEMI:** Si fillim do të them që me secilin aktor i kam marrëdhëniet e mira, personalisht më pëlqejnë raportet e mira dhe shpesh krijoj atmosferë në mesin e kolegëve e miqve. Mes nesh ka një humor, që na mban përherë pranë dhe në këmbë. Është e vërtetë që me regjisorët kemi role të ndryshme, por raportet mes nesh janë të atilla që herë ka përkëdhelje e herë "diktaturë", por qëllimi është që në fund të nxjerrim më të mirën. Kam patur të bashkëpunoj me Ilir Vokshi, me Dino Mustafiqi nga Bosnja dhe Hercegovina, i cili është një regjisor i mrekullueshëm, ku nëntë vite më herët e ka punuar shfaqen "Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur", ku po ky regjisor e punon shfaqen "Vdekja e Dan Tonic". Kam patur rastin bashkëpunim edhe me regjisorin Slobodan Umkovski e shumë regjisorë të tjerë, të merituar.

**KOHA: Ju si aktor lëvizni nga një vend në një vend tjetër, por si e përshkruani shtëpinë e aktorit, pra Teatrin Shqiptar në Shkup?**

**ETEMI:** Hapja solemne e Teatrit të Shkupit, si godinë, është bërë në vitin 1976, ashtu siç kam dëgjuar unë -ka qenë një teatër me akustikë më të mirë në Jugosllavi, dhe kjo do të thotë që themelet si teatër janë në nivel. Por, mirë që investohet sot, që një ditë ta merr pamjen e vërtetë. Në këtë teatër kam luajtur shfaqen e parë të

karrierës sime "Vdekja Aksidentale e një Anarkisti", kam luajtur shfaqen "Pergiti", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Kuçedra", etj. Në fakt, me renovimin e teatrit, që zgjat, mund të them se kemi humbur shumë vite karriere.

**KOHA: Një rol shumë të rëndësishëm për kulturën e vendit luan vlerësimi i artit, ngase pranimi i artit në përgjithësi, tregon për kulturën që e posedon një vend. Kur ka pranimit dhe vlerësim të mirëfilltë anashkalohe kriza në art? Në çfarë gjendje sot është arti?**

**ETEMI:** Të themi se jemi në gjendje të mjerueshme, nuk jemi. Por, edhe me thënë se jemi në një gjendje të mirë, poashtu nuk gjendemi. Jemi në një situatë të varur dhe në mëshirë të kohës, si aktorë. Përveçse teatrit nuk kemi një stacion tjetër, ku të dalim e të takohemi me kolegë. Se, anija ndalet në limane të ndryshme, e ne ndalemi vetëm në një liman, në teatër. Është e vërtetë që kemi lakmi kolegët tanë të Tiranës, Prishtinës, të Beogradit, të cilët i kanë nga dhjetë "limane" në muaj. Të shqepësh nga një honorar dëshiron apo s'dëshiron do ta kemi jetën më të lumtur si financiarisht apo profesionalisht do të jemi të përmbushur. Kurse ne jemi në pritje të një page mujore, të cilën pagë, vetëm për nevojat thelbësore të jetës mund të shfrytëzohet, jo më shumë. Mos mendoni se një aktor nuk i ka mbyllur njëherë sytë, që ka thënë se do ta lë këtë profesion e do të shkoj të punoj krah pune në Evropë e gjetiu.



**KOHA: Aktori në skenë qesh edhe kur i qan shpirti. Si e përshkruani jetën e përditshme rreth miqve dhe familjes?**

**ETEMI:** Kam patur batica zbatika në jetën time, prandaj falënderoj të gjithë kolegët. Në jetën time ka patur një moment, ku u rrëzova tërësisht, dhe shpëtimi i vetëm mund të ishte vetëm litari ose plumbi. Momentin kur kam qenë më së keqi, personat që më kanë dhënë dorë kanë qenë kolegët e mi. Jam njeri që nuk e harroj kurrë të mirën dhe të keqen ua fal ata që kanë vepruar në mua. I riu si veriu, fluturon dhe se mendon. Dy vite nuk kam marrë pagë, sepse paga ime ka shkuar diku tjetër. Janë vite ku kanë qenë disa kolegë, që vërtet më kanë mbajtur me bukë. Nuk dua ti përmend me emra, sepse e di që do ta lexojnë këtë intervistë dhe ata vetë do ta gjejnë veten e tyre. Ata janë njerëz, që më thonë se asnjëherë mos e përmend ndihmën tonë, sepse e kanë quajtur si detyrim moral. Kështu që, teatri është si një familje, ndonjëherë e ke vëlla, por disa herë nuk mund ta durosh. Ne në të mirë e në të keqe jemi e duhet të jemi bashkë. Gjithsesi, jam tepër i lumtur edhe pse kam patur shansa të ik për në Evropë, jo për të punuar në profesionin tim, por është familja dhe kolegët që më kanë mbajtur në vendin tim. Krenohem me ta dhe familjen. Kam babain Qerim, mamin Myrvete, të cilët i kam shtyllë mbështetëse, për çdo veprim që unë kam bërë. Ata kanë ndez fitil, në çdo ëndërr që kam patur, për të marr hapin. Kam dy motra, të mrekullueshme, Sibelin dhe Suerën. Poashtu kam gjetur njeriun, bashkëshorten time, Yllkë, që është mjeke, në spitalin shtetëror. Ajo është mburoja dhe krahu im, ku jemi njëzet vite bashkë. Më kupton në çdo veprim që bëj dhe asnjëherë s'më ka penguar në hapat e mia si aktor. Dashuria jonë u kurorëzua me ardhjen në jetë e vajzës Anda dhe Dua. Anda e ndje se do ta trashëgojë profesionin tim, sepse ajo më rri kudo që unë shkoj, pra në teatër. Dhe kur bie mbrëmja ajo përshkruan çdo moment, me aq delikatesë, shfaqen që ka pa. Pra, teatri për Andan është ëndrra e çdo nate dhe ky pasion i saj më bën të kuptoj se ajo do të jetë aktore.

## Serbve u ka dhembur shumë poshtërimi i Gjuriçit

ROSU e la Gjuriçin që të futej në një ambient të mbyllur, me vetëm një dalje duke u mbrojtur nga një numër i madh serbësh. Ishte një arrestim me mjaft risk. Ata ndejtën për 10 minuta ballë për ballë me kordonin e serbve që po mbronin Gjuriçin, shkruan gazeta e Beogradit "Blic"

Serbve u ka dhembur shumë arrestimi dhe poshtërimi i Marko Gjuriç nga Njësia Speciale e Intervenimit të Kosovës duke u përpjekur kështu që të gjejnë gabime të policëve, të cilat i ka publikuar gazeta beogradase "Blic". Në një shkrim mjaft tendencioz, të titulluar "5 arsye se përse ROSU është një bandë e organizuar", "Blic" rendit sipas saj disa gjoja "faulle" të specialëve të Kosovës, të cilët e bënë Gjuriçin të shihte tmeririn me sy. Sipas serbve, ROSU bëri këto gabime gjatë arrestimit të Gjuriçit:

**1. STRATEGJIA:** ROSU e la Gjuriçin që të futej në një ambient të mbyllur, me vetëm një dalje duke u mbrojtur nga një numër i madh serbësh. Ishte një arrestim me mjaft risk. Ata ndejtën për 10 minuta ballë për ballë me kordonin e serbve që po mbronin Gjuriçin.

**2. PAJISJET.** Ndërkohë që serbët që mbronin Gjuriçin ishin me fytyrë të mbuluar, një numër i madh forcash speciale të Kosovës nuk kishin kapuç. Krahas kësaj, sipas serbve, armatimi i tyre ishte i ndryshëm. "Janë regjistruar të paktën katër lloje të ndryshme armësh".

**3. RRESHTIMI I GABUAR.** Ndërkohë që lideri i grupit të policëve ishte duke negociuar me kordonin e serbve, policët nuk krijuan një kordon të mirëfilltë para tyre, por ishin të çorganizuar. Kjo u vërtetua edhe kur njëri prej tyre mori një goditje në fytyrë nga një serb.

**4. BOMBA SHOKUESE.** Janë hedhur disa bomba shock-u kur policët hynë brenda, por të paktën dy prej tyre dëmtuan më shumë policët se sa turmën e serbve. Bombat u hodhen në një largësi jo më të madhe se dy tre metra, kurse një tjetër tek këmbët e policëve.

**5. ARRESTIMI I DHUNSHËM.** Gjuriç ishte i paarmatosur dhe i dorëzuar, por ata e kapën me duar nga pas duke e trajtuar si kriminel. Forcat speciale ndërhyjnë shpejt dhe pastër.

ANALIZË E MEDIAVE NDËRKOMBËTARE

# RUSIA NDËRRHYN NË TENSIONET MES KOSOVËS E SERBISË

Tensionet mes Kosovës dhe Serbisë u rritën një ditë pasi një politikan serb u arrestua në Kosovë dhe më pas u dëbua në Serbi, dhe tani në këtë mosmarrëveshje ka hyrë Rusia kurse Bashkimi Evropian po provon të shmang ndonjë kacafytje të mëtejme

Serbët e Kosovës vendosën bllokada në rrugë në qytetin e ndarë të Mitrovicës për të monitoruar qasjen në territorin e dominuar nga serbët, dhe politikanët serbë u tërhoqën nga qeveria e Kosovës dhe kërcënuan me formimin e administratave të tyre lokale përgjatë Kosovës ku jeton pakica serbe, raporton "The Washington Post".

Shefja e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, bëri një udhëtim urgjent në Beograd për të biseduar me presidentin e Serbisë në tentim për të parandaluar krizën e thellë. Zyra e presidentit Aleksandar Vuçiq në një deklaratë për media tha se Mogherini është pajtuar për të gjetur "mënyra të reja" për të zgjidhur problemet mes Kosovës dhe Serbisë paqësisht.

Mogherini nuk komentoi menjëherë, por deklarata e citonte atë të ketë thënë se "ajo çfarë ndodhi dje nuk duhet të përsëritet".

"Bashkimi Evropian pret që paqja të ruhet me qetësi e përmbajtje", ka thënë Mogherini sipas deklaratës. Në ndërkohë, ministria e Jashtme ruse lëshoi një deklaratë me fjalë të ashpra, duke akuzuar BE-në dhe SHBA-në se po dëshirojnë "të shtypin ashpër" përpjekjet e serbëve të Kosovës për të "ruajtur interesat e tyre legjitime".

"Është krejtësisht e qartë se kosovarët (shqiptarët e Kosovës) gjithmonë ndjekin këshillat e patronëve të tyre amerikanë e evropianë, të cilët shkelin ligjin ndërkombëtar dhe veprojnë në bazë të arbitraritetit", ka



thënë MPJ ruse në një deklaratë të përcjellë nga agjencia ruse e lajmeve "Tass". Derisa Rusia mbështet pretendimet e Serbisë për ish-provincën e saj, SHBA dhe shumica e shteteve evropiane e kanë njohur pavarësinë e Kosovës një dekadë më parë. Rusia ka provuar të zgjerojë ndikimin e saj në Ballkan kryesisht përmes aleatit të saj tradicional sllav, Serbisë.

Këto zhvillime erdhën një ditë pasi Marko Gjuriç, shef i zyrës qeveritare serbe për Kosovën, u ndalua përkohësisht në qytetin e ndarë të Mitrovicës sepse hyri në vend pa lejen zyrtare të Kosovës. Policia e Kosovës të hënën përdori gaz lotsjellës dhe granata tronditëse për të shpërndarë protestuesit serbë në Mitrovicë.

Gjuriç tha se është rrahur derisa ka qenë i ndaluar dhe se arrestimi i tij kishte për qëllim poshtërimin e serbëve në Kosovë si dhe, sipas tij, ishte një stërvitje për një përpjekje të mundshme nga Policia e Kosovës për të marrë veriun e Kosovës.

"Duke më tërhequr zvarrë sikur një qen, duke më tërhequr për kollare, ata deshën të më poshtërojnë duke menduar se mund të poshtërojnë popullin serb", ka thënë Gjuriç gjatë një konference për media të martën.

Por presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, incidentin e quajti si provokim nga Serbia. "Ngjarjet e së hënës janë në kundërshtim me përkushtimin ndaj dialogut dhe ndërtimin e një paqjeje të qëndrueshme në Kosovë", tha ai në një deklaratë të hënën.

Politikanët përfaqësues të pakicës serbe në Kosovë u takuan me presidentin e Serbisë në Beograd, duke thënë se më nuk do të mbështesin qeverinë e Kosovës. Kjo mund të nxis një krizë qeveritare nëse ministrat serbë nuk zëvendësohen shpejt nga shqiptarët.

Goran Rakiq, që drejton Listën Serbe në parlamentin e Kosovës, ka thënë se serbët do ta formojnë vetë Asociacionin e komunave serbe në Kosovë, që është paraparë me marrëveshjen e vitit 2013 në Bruksel por që asnjëherë nuk është vazhduar tutje nga autoritetet e Kosovës. "Ky nuk është hap i njëanshëm. Është hap i detyruar", ka thënë Rakiq. "Kemi prituri për pesë vjet të na japin atë që na takon. Ne do ta formojmë atë për të cilën ata kanë nënshkruar, atë që na është garantuar pesë vjet më parë". Ky veprim mund të nxis edhe më shumë fërkimet mes Serbisë dhe Kosovës, e cila shpalli pavarësinë më 2008 përkundër dëshirave të Beogradit, transmeton Koha.net.

## Tadiq e vlerëson të kotë krijimin e Asociacionit pa miratimin e Prishtinës

Ish-kryetari i Serbisë dhe kryetar SDS-së, Boris Tadiq, deklaroi se "është e qartë se prania e delegacioni serb të shfaqur në Mitrovicë, nuk ishte e miratuar nga pala kosovare dhe që pralajmërimi për formimin e AKS nga ana e përfaqësuesve serbë në Kosovë është lëndim i mendjes së shëndoshë". Në një deklaratë me shkrim, Tadiq theksoi se ngjarja e së hënës "s'ishte tjetër veç pasojë e shfaqjeve të tilla, që kanë ndodhur edhe më parë". Ai në shkrimin e tij akuzoi kryetarin serb, Aleksandar Vuçiq, për rolin e tij "prej marketingu medial që paraqesin rrethëm si një person që kujdeset për fatin e kombit dhe garantues i

paqes, që, mjerisht, po përkrahet edhe nga bashkësia ndërkombëtare, por që nuk duhet harruar se kështu kishin vepruar edhe me Millosheviqin, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së Dejttonit", transmeton RTK. Tadiq, më tej, sqaron taktikën e veprimit të kryetarit serb, Vuçiq, i cili "me taktikën e ndezjes së zjarreve dhe konflikteve nacionaliste", ka për qëllim të ofrojë kombin përreth vetes, duke krijuar figurën e 'udhëheqësit shpëtimtar', duke rrënuar qytetërimin serb dhe shumë shpejt mund të djegë interesin kombëtar serb edhe në Kosovë, si dhe mundësinë e zhvillimit ekonomik"



Aktivistët thonë se Facebook ka lejuar reklamuesit e shtëpive me qera, të mund të përjashtojnë nga oferta e tyre, gratë, familjet me fëmijë dhe personat me invaliditet

# PADITET FACEBOOKU, AKUZOHET SE ËSHTË STREHË E DISKRIMINIMIT



## ZUCKERBERG KËRKON PUBLIKISHT FALJE, POR KJO NUK MJAFTON

"Ju premtoj se do punojmë më mirë në të ardhmen", shkroi drejtori ekzekutiv i Facebook, Mark Zuckerberg në gazeta. Por falja me shkrim me sa duket nuk është e mjaftueshme. Përmes reklamave në gazeta Mark Zuckerberg kërkoi publikisht falje për skandalin mbi përdorimin e paaautorizuar të të dhënave të miliona përdoruesve të Facebook. "Ju ndoshta keni dëgjuar se aplikacioni i një kuici të një shkencëtari u ka dhënë në mënyrë të paligjshme të dhënat e Facebookut të

miliona njerëzve në vitin 2014", thuhet në njoftimin e nënshkruar nga Zuckerberg që zë një faqe të plotë në gazetën Süddeutsche Zeitung dhe "Frankfurter Allgemeine Zeitung". "Kjo ishte prerje në besë dhe unë kërkoi falje që ne nuk kemi ndërmarrë asgjë në lidhje me këtë gjë më përpara." Facebooku po merr hapat e nevojshëm që kjo të mos ndodhë përsëri. Zuckerbergu kishte kërkuar falje të dielën edhe në disa gazeta britanike për skandalin me të dhënat.

Grupe të ndryshme civile me prefiks të mbrojtjes të të drejtave të njeriut, kanë ngritur një padi federale kundër Facebook-ut, me akuzën se ka lejuar të shndërrohet në strehë të diskriminimit. Aktivistët nën ombrellën e organizatës National Fair Housing Alliance (NFHA), akuzuan se praktikat e Facebook-ut, u mundësojnë pronarëve dhe agjentëve të patundshmërive, të mund të reklamohen vetëm te një grup i caktuar njerëzish. Organizata NFHA thotë se pronarët e patundshmërive kanë një mundësi të shmangin shfaqjen e reklamave të tyre, duke bërë të njëjtat të padukshme për gratë dhe familjet. "Në vazhdim të shqetësimit publik gjatë ditëve të kaluara se Facebook ka keqpërdorur të dhënat e përdoruesve të tij, hetimi ynë nxjerrë në dritë se Facebook u ka mundësuar, madje edhe ka inkurajuar reklamuesit me pagesë të diskriminojnë, duke u

dhënë në disponim një sërë të dhënash personale" tha Lisa Rice, presidente e NFHA-së. "Përdorimi dhe keqpërdorimi i të dhënave perso-

nale nga ana e Facebook-ut për qëllime diskriminuese duhet të ndalojë. Tashmë është shndërruar në një sfidë për gratë, familjet me fë-

mijë dhe njerëzit me invaliditet të gjejnë një shtëpi për vetë", tha Rice, e cila akuzoi se me këtë mundësi, pronarët mund të përjashtojnë nga

oferta e tyre, gratë, familjet me fëmijë, personat me invaliditet dhe secilin të papërshtatshëm për të marrë me qera shtëpinë e tyre. Në fillim të muajit mars, u bë e ditur se një grup konsulent politik gjatë vitit 2016 ka shfrytëzuar të dhënat personale të përdoruesve të Facebook-ut, duke i përdorur gjatë fushatës së kandidatit presidencial Donald Trump. Kreu i Facebook-ut, Mark Zuckerberg personalisht kërkoi falje, megjithatë rrjeti social mbeti i zhytur në aferën e cila e përfshiu, me pyetjen kryesore se si është e mundur që një palë e tretë të marrë qasje në të dhënat e përdoruesve. Ditë më parë, komisionerja e Bashkimit Evropian (BE) për Drejtësi dhe Mbrojtjen e Konsumatorit, Vera Jourova, kërkoi nga menaxhmenti i kompanisë Facebook të prononcohet nëse ka patur keqpërdorim të të dhënave personale të përdoruesve evropianë, të cilët janë mbledhur në mënyrë të pakontrolluar. Jourova për gazetën gjermane "Bild am Sonntag" deklaroi se një abuzim i tillë i të dhënave personale është absolutisht i papranueshëm.

## Nataliteti në Gjermani më i larti në 20 vjet

Numri i foshnjave të lindura në Gjermani në vitin 2016 është më i larti në 20 vjet, bëjnë të ditur të dhënat e publikuara nga Zyra Federale e Statistikave. Si-

pas tyre, në Gjermani kanë lindur 792,131 foshnje më 2016. Ky është niveli më i lartë i lindjeve qysh në vitin 1996. "Ky zhvillim ndodh kryesisht për

shkak të faktit se gratë e moshës 30 deri në 37 vjeçe kanë më shumë fëmijë", tha Zyra Federale e Statistikave. Megjithatë, rritja e natalitetit

nuk ka ndodhur në mënyrë të barabartë. Ndërsa në perëndim numri i lindjeve u rrit me 8 për qind, në lindje ai ra për 4 për qind.



## Mekë, përfundon projekti për rregullimin e burimit Zemzem

Autoritetet e Arabisë Saudite kanë njoftuar se projekti për rregullimin e infrastrukturës të burimit Zemzem në kompleksin e Mesxhidul-haremit në Mekë ka përfunduar. Drejtoria e Mesxhidul-haremit dhe Xhamisë së Profetit ka thënë se projekti ka përfunduar me sukses dhe se të gjitha barrierat që ishin vendosur për arsye sigurie në kompleksin rreth Qabesë janë hequr. Në kuadër të projektit janë ndërtuar kanale të veçanta për rrjedhjen e ujit nga burimi i cili ndodhet 21 metra nga Qabeja. Poashtu janë instaluar edhe sisteme të veçanta për pompimin e ujit dhe pllaka mbrojtëse për rreth burimit. Projekti për rregullimin e burimit Zemzem filloi në fund të tetorit të vitit të kaluar me urdhër të mbretit saudit Selman bin Abdelaziz.

## RUSIA SYNOI TA NDAJË PERËNDIMIN

Mattis tha se incidenti në Sallsbëri ka përfshirë përdorimin e qartë të një "arme të shkatërrimit në masë", të cilën Qeveria britanike e ka identifikuar si agjenti nervor Novichok, i prodhuar në Rusi gjatë Luftës së Ftohtë



ri në gjithë botën njoftuan për dëbimin e 144 diplomatëve rusë për shkak të helmimit, Mattis tha se mohimi i përgjegjësive nga ana e presidentit të Rusisë, Vladimir Putin, për "tentim-vrasjen" e Sergei Skripalit dhe vajzës së tij, Yulia, në Sallsbëri të Anglisë, nuk mund të merret seriozisht.

Mattis tha se incidenti në Sallsbëri ka përfshirë përdorimin e qartë të një "arme të shkatërrimit në masë", të cilën Qeveria britanike e ka identifikuar si agjenti nervor

Novichok, i prodhuar në Rusi gjatë Luftës së Ftohtë. Sipas zyrtarit amerikan, strategjia e Rusisë ka nisur të shihet qysh në vitin 2014 në Ukrainë, kur Moskë ka dërguar njerëz të armatosur në Krime pa shenja identifikimi.

Rusia, shtoi Mattis, ka vazhduar më pas me përpjekjet e fshehta për të ndikuar zgjedhjet presidenciale në SHBA, më 2016. "Ajo i heq shenjat e uniformave të ushtarëve dhe hyn në Krime. Ajo thotë se nuk ka të bëjë asgjë me

separatistët në lindje të Ukrainës", tha Mattis, duke iu referuar Rusisë. "Nuk jam i sigurt se si mund ta thonë këtë pa i ndryshuar shprehjet në fytyrë, por bëjnë gjëra që besojnë se mund t'i mohojnë", tha Mattis. NATO iu bashkua dhjetëra qeverive që kanë dëbuar diplomatët rusë nga ambasadat dhe misionet e tyre.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se dëbimet do t'i dërgojnë mesazh Rusisë se ka "kosto dhe pasoja për sjelljen e papranueshme". Udhëheqësit britanikë thanë se dëbimi i diplomatëve rusë "është një pikë e mundshme kthese", ndërsa Rusia tha se e gjithë kjo është rezultat i presionit "kolosal" nga Shtetet e Bashkuara dhe u zotua se do të përgjigjet. Stoltenberg tha se NATO do të mbetet "e hapur për dialog me Rusinë", ndërsa Mattis tha se Rusia "ka ende potencial që të jetë partner me Evropën".



Nga Qerim LITA

Përveç asaj që pati një zgjidhje fatkeqe, zbatimi i saj ishte edhe më ogurzi, prandaj pjesa shumë e madhe e elementit mysliman thuajse u proletarizua ndërsa shumë familje ranë në një varfëri të skajshme. Kjo erdhi për arsye se toka nuk u morr vetëm nga pronarët e mëdhenj, por edhe nga poseduesit e vegjël, që për ta përbënte pasuria e vetme, ndërsa bujqësia, profesioni dhe burimi i vetëm për ekzistencë. Me një plan aq drastik shumë familje myslimane falimentuan ekonomikisht, që shkaktoi pasoja të rënda edhe në sferat tjera të jetës, sepse pa mbështetje materiale nuk mund të ketë as ç'farë përparimi. Për këtë arsye, te bota myslimane, edhe nëse do të kishte kuptim, vullnet e dëshirë për ngritje kulturore e arsimore, u mungonin mjetet materiale, prandaj kjo mund të konsiderohet si pengesa më kryesore...”, thuhej ndër të tjerave në raport.

Ishin pikërisht këto arsyt kryesore që Këshilli i Kuvendit Mearif të Vakëfit, rëndësi të madhe t'i kushtoj ndarjes së bursave si për nxënësit e shkollave të mesme, po ashtu edhe për studentët të cilët studiojnë në Universitetin e Beogradit e atë të Zagrebit. Këtë e shohim në buxhetet e viteve 1937/38, 1938/39 dhe 1939/40, ku një shumë e madhe ishte caktuar për këtë lëmi. Buxheti i vitit 1937/38 shuma e përgjithshme arrinte shifrën prej 11.385.500 dinarë, prej saj 650.000 ishin paraparë për bursa të studentëve. Shuma e njëjtë ishte në buxhetin e vitit 1938/39, ndërsa në vitin 1939/40 kjo shumë u rritë në 800.000 dinarë. Nga kjo shumë përfituan bursa mbi 150 studentë shqiptarë, turq e boshnjak. Në mesin e bursistëve pati edhe disa personalitete të cilët kanë lënë gjurmë në historiografinë shqiptare: Esad Doko, Dr. Zyrap Sejfullau, akademik Esad Mekuli, Mexhid Esadi, Nexhmedin Besimi, Xhevdet Pallaska, Jahja Osmani, akademik Idriz Ajeti, Sokol Dobroshti, Tahir Ismaili, Ibrahim Lutfiu, Shaip Kamberi, Shaip Mustafa, Kurtesh Agushi, etj..

Veprimtaria atdhetare e kreut të BFI-së në Shkup, e cila erdhi pas zgjedhjeve të mbajtura më 30 maj 1937, ku siç dihet fitoi krahu opozitar shqiptar me në krye Ferhat bej Dragën, i prishi të gjitha planet e projektet antishqiptare, të parapara nga ana e udhëheqjes së atëherëshme jugosllave, në radhë të parë, atë të shpërnguljes. Në këto rrethana, Qeveria Cvetkoviç-Maçek, urdhëroi ministrin e Drejtësisë, L. Markoviç, të ndërmer masa ndëshkuese ndaj BFI-së në Shkup. Ky i fundit, me vendimin

PRIJËS I LËVIZJES KOMBËTARE TË VITEVE '30 TË SHEKULLIT TË KALUAR (6)

# SHQIPTARËT DHE JOSHQIPTARË SIPAS FERHAT BEJ DRAGËS

Ish-kryeshefi i Ministrisë së Drejtësisë - dhoma për fe në Shkup, Hasan Rebac, i shkruante Këshillit Shtetëror në Beograd, se udhëheqja e Bashkësisë Fetare Islame në Shkup, po zbaton një politikë "nacional-shoviniste". Sipas tij, "Ferhat bej Draga, këtë e ka shtruar në mënyrë të qartë në mbledhjen e datës 19 prill 1939, duke i ndarë myslimanët e jugut në "shqiptarë e joshqiptarë"

nr. 42554/40-IV, të nënshkruar më 17 maj 1940, suspendoi të gjitha organet e Bashkësisë Fetare Islame në territorin e Mexhllisit të Ulemasë në Shkup, dhe në vend të organeve legjitime, emëroi një komesarat shtetëror, i përbërë prej tre vetësh: Mehmet Zeki, Dervish Sheqerkadiq dhe Murat Sheqeragiç, që të tre, njerëz më të besueshëm të politikës serbomadhe. Një vendim i till, siç u mundua ta arsyetoj ministri, kishte ardhë për shkak, se gjoja Ministrisë së Drejtësisë, i kishin arritur "ankesa nga një numër i konsiderueshëm i myslimanëve" nga territori i Mexhllisit të Ulemasë në Shkup "nga të cilat vihet në dukje se në Bashkësinë Fetare Islame në atë territor që nga zgjedhjet e Kuvendit Mearif të Vakëfit në Shkup të kryera në vitin 1937, mbisundon një situatë e jashtëzakonshme...".

Emërimin të Komisarit shtetëror, rëndësi të veçanti i kushtoi shtypi i atëherëshëm ditore e periodik. Fletushka për gjoja "ngritjen" kulturore dhe ekonomike të myslimanëve "Nash Dom", redaktor i së cilës ishte përkrahësi i politikës serbomadhe, Zyfer Musiq, në numrin e jashtëzakonshëm të datës 21 maj 1940 në faqen e parë me shkronja të mëdha shkruante: "U vendos komesarati në Bashkësinë Fetare Islame në Jug", ndërsa si nëntitull: "I erdhi fundi i arbitrarizmit dhe shkeljes së ligjit në Bashkësinë Fetare Islame". Duke e përkrahur pa asnjë rezervë vendimin, në të thuhej: "Nuk mund të paramendohet, e ku më të përshkruhet, ajo veprimtari arbitrarë e joligjore, të cilin e ka zbatuar grupi i z. Ferhat Dragës në Bashkësinë Fetare Islame në Jug. Këtë më së miri e ka të qartë pasuria e Vakëfit, e cila është shpenzuar në mënyrë të paskrupullit. Ky grup i njerëzve kanë harruar, se ajo është institucion i të gjithë myslimanëve, e jo vetëm i bejlerëve, të cilët përbëjnë lungun e rrezikshëm në trupin e myslimanëve mbarë e me këtë edhe të botës punëtore shqiptare në vendin tonë...".

Ndërkohë, Ferhat bej Draga, më 20 qershor 1940, në cilësinë e kryetarit të Kuvendit Mearif të

Vakëfit në Shkup, Këshillit Shtetëror në Beograd i dorëzoi një padi prej 17 faqesh kundër vendimit të lartpërmendur. Në vazhdim po e paraqesim një pjesë të asaj padie: "...Me këtë urdhëresë, si individualisht po ashtu edhe në tërësi, është shkelë hijë më pak se autonomia e Bashkësisë Fetare Islame, e garantuar me Ligjin për Bashkësinë Fetare Islame të Mbretërisë Jugosllave, ndërsa me ato masa arbitrare është suspenduar thuajse flet për flete Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Islame...Bashkësia Fetare Islame administrohet sipas ligjeve dhe Kushtetutës së saj, të cilat, në këndvështrimin juridik, është identike për shembull me Ligjin për Kishën Ortodokse Serbe dhe me Kushtetutën e Kishës Ortodokse Serbe. Ligjëvënësi është kujdesur me vëmendje, që gjatë përpilimit të Ligjit fetar të mos ketë as dyshimin më të vogël të diskriminimit apo padrejtësisë. Ja, për shembull ne nuk mund ta paramendojmë, që në Shtetin tonë mund të gjendet ndonjë ministër i drejtësisë, madje edhe nëse nuk do të ishte serb i besimit ortodoks, por jashtë atij besimi - të themi kroat, slloven ose, madje edhe shqiptar - i cili do të merrte guximin qoftë kjo edhe teorike për ta plotësuar qëllimin që autonomisë së Kishës Ortodokse Serbe t'ia hartoj kësulën në mënyrë, siç tash praktikisht ministri i Drejtësisë po bënë përpjekje ndaj autonomisë së Bashkësisë Fetare Islame. Në atë rast mund të paramendohet, askush nuk mund t'u shmangej pasojave të rënda, sepse ne ende e kemi të freskët furtunën e paradokohshme... Theskuam se, vendimi i sjell as që mund të kuptohet, e ku më të vlerësohet, mbi bazën e kriterit të drejtësisë. I njëjtë vendim nuk përmban as çfarë arsytimi të dokumentuar, me çka do të mund të hulumtoheshin reagimet e arsyeshme, me të cilat zoti ministër i Drejtësisë mbështetet gjatë sjelljes së tij. Në atë hamendje do të ngeleshim edhe më tutje, po që se zoti Reis-ul-ulema në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit Mearif të Vakëfit në Sarajevë, të mbajtur më 14 qershor të vitit 1940

(sipas informatave të gazetës zagrebese "Obzor" nr.138 nga 15 qershori 1940), duke protestuar për shkak sjelljes së vendimit kundërligjor, veç tjerash, konstatoi: 'Kur gjatë debatit me ministrin e drejtësisë biseduam për këto çështje, ai më deklaroi, se kjo nuk është çështje juridike por politike'. Nëse ky konstatim është i këtyllë (ndërsa nuk kemi arsye të dyshojmë në fjalët e zotëris Reis-ul-ulemasë), atëherë sjellja e zotit ministër të drejtësisë mund të jetë e kuptueshme vetëm në disa këndvështrime, të papërcaktuara dhe të pakuptueshme për ne, të interesit politik, mirëpo me këtë ky veprim ende nuk është arsyetuar nga këndvështrimi i Ligjit, rregullimit juridik, sigurisë juridike e të moralit publik. Për këtë arsye lus, Këshillit Shtetëror, që ta miratojë këtë padi nga arsyet e lartpërmendura dhe ta hedhë poshtë në tërësi vendimin e zotit ministër të drejtësisë të datës 17 maj të vitit 1940".

Një ditë më pas, pasoi padia edhe e Mexhllisit të Ulemasë, drejtuar të njëjtit institucion, në të cilën veç tjerash në të thuhej: "...Duke e pas parasysh se akti për suspendimin e Kuvendit Mearif të Vakëfit në Shkup ashiqare është JOLIGJOR, sepse zoti ministër i Drejtësisë kontrollin e nevojshëm ka mund ta kryej paralelisht me ekzistimin e Kuvendit, meqenëse Reis-ul-ulemaja e Bashkësisë Fetare Islame nuk e pranon e as që do ta pranojë aktin për vendosjen e Komisarit Shtetëror në Drejtorinë e Vakëfit në Shkup prandaj me të njëjtin nuk pranon as çfarë bashkëpunimi, meqenëse Mexhllisi i Ulemasë në frymën e Kushtetutës e të Ligjit për Bashkësinë Fetare Islame është i obliguar t'i përmbahet urdhëresave dhe instruksioneve të Reis-ul-ulemasë si udhëheqësin e tij suprem, prandaj Mexhllisi i Ulemasë nuk ka mundësi ligjore të veproj sipas urdhëresës së z. ministër të drejtësisë në vendimin e bashkangjitur, për çka pason padia jonë deri te Këshilli Shtetëror me lutje që ky vendim i z. ministër të drejtësisë të hidhet poshtë si antiligjor".

Duke u munduar t'u kundërvihej dy padive të mësipërme, ish



kryeshefi i Ministrisë së Drejtësisë - dhoma për fe në Shkup, Hasan Rebac, i shkruante Këshillit Shtetëror në Beograd, se udhëheqja e Bashkësisë Fetare Islame në Shkup, po zbaton një politikë "nacional-shoviniste". Sipas tij, "Ferhat bej Draga, këtë e ka shtruar në mënyrë të qartë në mbledhjen e datës 19 prill 1939, duke i ndarë myslimanët e jugut në "shqiptarë e joshqiptarë". Në këtë frymë të re të imponuar, theksonte në vazhdim, Rebac "sikurse tërë kryesia po ashtu edhe i tërë Këshilli kuvendor dhe i tërë Këshilli i kontrollit, i ashtuquajtur i keshilli i punës përbëhen vetëm nga shqiptarët" e nëse merret parasysh se edhe të gjithë anëtarët e Mexhllisit të Ulemasë janë shqiptarë, "atëherë mund të paramendohet se në ç'farë gjendje nënçmuese janë myslimanët - joshqiptar, përkatësisht, myslimanët-serb...".

Për dallim nga Hasan Rebac, udhëheqësi suprem i BFI-së në Sarajevë, Reis-ul-ulemaja Fehim ef. Spaho, në mënyrë kategorike e hodhi poshtë vendimin e ministrit, të cilin ai e quante antiligjor dhe arbitrar, duke kërkuar nga Mexhllisi i Ulemasë në Shkup, t'i ndërpret çdo lloj bashkëpunimi me Komisaratin Shtetëror. Këtë e shohim në urdhëresën me numër 98/40, të datës 21 gusht 1940, përmbajtja e së cilës është si vijon: "Me rastin e vendosjes së komisarit shtetëror në Drejtorinë e Vakëfit në Shkup, aktin e ministrit të Drejtësisë numër 42554/40 nga data 17 maj 1940, me aktin e këtushëm Proc. nr. 67/40 nga 6 qershori k.u., ia kam bërë me dije Mexhllisit të Ulemasë t'i ndërpret të gjitha shkresat me këtë komesarat të vendosur në mënyrë joligjore, pasi ky komesarat sipas Kushtetutës dhe Ligjit të BFI-së nuk ka as çfarë legjitimiteti legal për ekzistimin e vet, prandaj tërë veprimtaria e tij nga pikëpamja e Kushtetutës dhe Ligjit të BFI-së janë joligjor dhe pa bazë



morale. Në lidhje me këtë, lutet Mexhlisi i Ulemasë, që përmes një qarkore t'ua bëj me dije të gjithë imamëve të rretheve e të xhematit, që edhe ata të mos mbajnë as çfarë korrespondence me këtë komesariat, sepse të gjitha vendimet e këtij trupi janë të pavlefshme juridikisht, ndërsa për të njëjtat duhet të prononcohet edhe Drejtoria e Vakëfit në Shkup". Në anën tjetër, Ferhat bej Draga, më 18 nëntor 1940, i dërgoi një letër nënkryetarit të Qeverisë së Mbretërisë jugosllave, Vllatko Maçekut, ku veç tjerash shkruante: "Meqenëse me vendimin e 17 majit të këtij viti të ministrit të Drejtësisë në mënyrë joligjore e ka suspenduar Kushtetutën e Bashkësisë Fetare Islame në territorin e Mexhlisit të Ulemasë në Shkup, dhe në mënyrë arbitrare ka emëruar komesariat, tërë popullsia myslimane këtë e ka parë si një grusht ndaj institucioneve të veta fetare dhe si një atentat të ri ndaj të drejtave elementare të myslimanëve në trevat jugore. Pas rrugës plot me ferra përmes së cilës myslimanët e viseve jugore e sidomos ata të kombësisë shqiptare ishin të detyruar të kalojnë në mbrojtjen e pasurisë së tyre fshatare nga grabitqarët zullumqar, e cila zbatohet përmes të ashtuquajturës reformë agrare dhe kolonizim, e cila edhe pse gjoja është ndërprerë përkohësisht, ende u kërcënohet si shpatë mbi kokë, tash atyre u kërcënohet edhe në të drejtën e vetme, të cilën ata e kanë gëzuar në këtë shtet, në autonominë e tyre fetare. Përndryshe, Juve, Zotëri Kryetar, U janë të njohura rrethanat përsëafërmi se në ç'farë përmasash janë zhvilluar përndjekjet e myslimanëve tanë, për arsye se herpashere edhe vet kam pasur nderin, për tërë këto të Ju informoj..."

Për sa u tha më sipër, mund të konkludojmë se Lëvizja Kombëtare Shqiptare, të cilës gjatë viteve tridhjeta të shekullit të kaluar i printe atdhetari dhe veprimtari i shquar shqiptar, Ferhat bej Draga, pati rol të rëndësishëm dhe vendimtar si në pengimin e shpërnguljes së popullsisë shqiptare nga vatrat e tyre për në Turqi, po ashtu edhe në ndërgjegjësimin nacional të tyre. Ky rol erdhi në shprehje, veçmas gjatë periudhës kohore 1938-1941, përkrahësisht pas Konventës së parafuar turko-jugosllave, e cila siç u tha më sipër, parashihte që brenda periudhës kohore 1939-1944, nga trevat shqiptare nën Jugosllavi të shpërnguleshin 40.000 familje shqiptare. Deri te kjo nuk u arrit falë veprimtarisë së palodhshme e sakrifikuese të Ferhat bej Dragës e të bashkëveprimtarëve të tij siç ishin: Ibrahim Lutfiu, Kadri Saliu, Sherif ef. Langu, mulla Idriz Gjilani, Ataullah ef. Kurtishi, Bedri ef. Hamidi, Iliaz ef. Agushi, Shaban ef. Jashari, Azem Hoxha, Abdullah Musliu, Shaip Kamberi, Shaip Mustafa, Asim Luzha, Mustafa Dërguti e shumë të tjerë. (fund)



Nga Agim RUSHITI

Në një shoqëri, ku tani më vite të tëra nuk respektohen standardet dhe kriteret për vendosjen, ruajtjen dhe zhvillimin e kualitetit në arsim, këto norma ligjore nuk mundën për një kohë të shkurtër ta ndryshojnë realitetin. Por, presim që këto norma ligjore ta projektojnë realitetin normativ për të cilën mëtojmë të bëhet edhe realitet në një të ardhme sa më të shpejtë. Apo thënë më realisht, njëfarë realiteti normativ në një kontekst real. Çështjet kyçe që e determinojnë këtë ligj të ri të arsimit të lartë, që tani më kaloi fazën e parë të saj të miratimit nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (Në mbledhjen e 13 Marist 2018 u miratua dhe u mor vendim që të lëshohet në procedurë parlamentare), janë: është përkufizimi i autonomisë universitare. Autonomia e universitetit përfshin lirinë akademike të ngritjes profesionale, autonominë në drejtim dhe udhëheqje, përcaktimin e hapësirës universitare, autonominë financiare dhe përcaktimin e vetë asaj autonomie. Në të njëjtën kohë, ofrohet edhe një koncept i ri i luftës ndaj korrupsionit në radhët e profesorëve, por edhe në radhën e vetë studentëve.

Momente të reja në Ligjin për arsimin e lartë janë edhe: Dekoncentrimi i fuqisë të ministrit për arsim dhe shkencë (e me të edhe të Qeverisë), dekoncentrimi i fuqisë së Rektorit të Universitetit, vendosja e "funksionit" Kryetar i Senatit, mandat i shkurtuar (dyvjeçar) për rektorin dhe anëtarët e Senatit të Universitetit, formimi i Kuvendit universitar të studentëve, formimi i trupave të reja për sigurimin e kualitetit në arsimin e lartë. Sipas këtij Ligji të ri të arsimit të lartë, Rektori, si organ udhëheqës i universitetit, zgjidhet me mandat trevjeçar, me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat (për dallim nga ligji ekzistues, ku mandati i tij ishte katërvjeçar, me të drejtë edhe për një rizgjedhje), nga radhët e profesorëve të rregullt (ordinar) të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune në universitet (Në ligjin e tanishëm në fuqi, të drejtë të jetë rektor ka edhe profesor shtetas i huaj). Rektori zgjidhet nga radhët e profesorëve të rregullt (ordinar), përmes shpalljes publike, përmes zgjedhjeve të lira, të drejtpërdrejta dhe të fshehta nga ana e anëtarëve të këshillave arsimore-shkencore, shkencore dhe ato arsimore të njësive (fakulteteve) përbërëse të universitetit. Ky solution len hapësirë për konkurrim për rektor edhe të profesorëve me

# ÇKA OFRON LIGJI I RI I ARSIMIT TË LARTË?

thirrje akademike profesor ordinar që janë në marrëdhënie pune në ndonjë universitet tjetër. Senati i universitetit formon komision zgjedhor prej shtatë anëtarësh e cila e miraton listën e kandidatëve që konkurrojnë për rektor, i vlerëson plotësimin e kushteve për zgjedhje të rektorit dhe i përmbledh rezultatet e votimit për rektor. Procedura e mëtutjeshme për zgjedhjen e rektorit rregullohet me statutin e universitetit. Rektori (i cili më tani nuk përfaqëson edhe Kryetarin e Senatit të universitetit), me këtë ligj të ri, ka obligime të kufizuara kryesisht menaxheriale, i realizon vendimet e senatit të universitetit, vendos për çështje financiare dhe materiale që nuk janë në kompetencë të senatit të universitetit, promovon doktorët e shkencave, ndan shpërblime të universitetit, propozon zgjedhjen e prorektorëve dhe të sekretarit gjeneral të universitetit, e përshtat veprimtarinë e arsimit të lartë, atë artistike, shkencore-hulumtuese dhe aplikative dhe punën tjetër të universitetit, e udhëheq bashkëpunimin ndërkombëtar të universitetit, inicon bashkëpunimin me universitetet tjera në vend dhe jashtë tij, udhëheq me pasurinë e universitetit dhe kryen edhe punë tjera të përcaktuara me statutin e universitetit dhe aktet tjera të institucionit që drejton. Senati i universitetit, si organ drejtues dhe po aq menaxhues, i përbërë nga përfaqësues të njësive të universitetit, të njësive asociuese të universitetit dhe të përfaqësuesve nga kuvendi universitar studentor, me një mandat prej tri vitesh (me të drejtë edhe një herë për rizgjedhje, në përjashtim të përfaqësuesit të studentëve i cili zgjidhet me mandat për një vit dhe pa të drejtë rizgjedhjeje), drejtohet nga Kryetari i Senatit (si risi e këtij ligji). Kryetari i Senatit, i cili zgjidhet nga radha e senatorëve, është përgjegjës për ligjshmërinë në punë, konform ligjit dhe statutit të universitetit, të vetë Senatit. Senati sjell Statutin e universitetit, jep pëlqim për statutet e njësive në përbërje të universitetit (risi e këtij ligji: sjellja e statuteve edhe për njësitë e universiteteve), vendos për veprimtarinë arsimore, shkencore, artistike dhe asaj aplikative, i miraton programet studimore të fakulteteve, vendos për ndryshimet statutore, sjell Programën vjetore dhe atë dyvjeçare për zhvillimin dhe punën e universitetit, jep mendim

dhe propozon propozime për Programën për veprimtari të arsimit të lartë, miraton Planin vjetor financiar të universitetit, zgjedh dhe shkarkon rektorin dhe prorektorët e universitetit, sjell rregullore për zgjedhjen në thirrje të personelit mësimor, për regjistrimin e studentëve në të tri ciklet e studimit, transferin e studentëve nga një program në programin tjetër studimor, për ofrimin e veprimtarisë arsimore, shkencore-hulumtuese dhe asaj aplikative, zgjedh sekretarin gjeneral të universitetit, zgjedh personin e autorizuar (nga radha e profesorëve të rregullt) për pranimin e ankesave për korrupsion, zgjedh avokatin studentor të popullit, si dhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin e universitetit.

Në institucionet e arsimit të lartë ku realizohen programe studimore të ciklit të tretë të studimeve të doktoraturës, mentor i punimit të doktoraturës mund të jetë vetëm profesori inordinar dhe ai ordinar, nga lëmia përkatëse, i cili është i punësuar në institucionin e arsimit të lartë, profesor inordinar dhe ordinar, të cilit është duke i pshuar marrëdhënia e punës, ose profesor ordinar në pension i cili ka qenë në marrëdhënie pune në atë institucion. Në kuadër të universitetit, mësimi duhet të zhvillohet në gjuhën angleze, në më së paku, në dy programe studimore të ciklit të parë dhe në dy programe studimore akademike dhe atyre profesionale të ciklit të dytë (për dallim nga dispozitat në fuqi e cila në ciklin e dytë e detyronë institucionin e arsimit të lartë që të sigurojë kushte për realizimin e katër programeve studimore të ciklit të dytë të studimeve). Bashkësinë akademike e përbëjnë personat e zgjedhur në thirrje shkencore-arsimore, shkencore, arsimore dhe profesionale, bashkëpunëtorët/asistentët si dhe (për herë të parë) edhe studentët. Profesorët e rregullt, edhe pas pensionimit të tyre, mbesin anëtarë të bashkësisë akademike.

Për herë të parë, në këtë ligj, institucionet e arsimit të lartë të formuara nga ana e bashkësisë fetare mund të jenë edhe në përbërje të universitetit, si njësi të universitetit (që hap shteg edhe për financimin e veprimtarisë së tyre dhe të mbulimit të shpenzimeve për mësimdhënës të punësuar brenda atyre institucioneve të arsimit të lartë fetar), ose si njësi shoqëruese. Për zhvillimin dhe ruajtjen e kualitetit në arsimin e

lartë, në çdo tri vite (për dallim që deri më tani ishte në çdo dy vite), patjetër realizohet rangimi i të gjitha universiteteve të regjistruar në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë. Rangimi do të kryhet nga ana e personit juridik të cilin e zgjedh ministri i arsimit dhe shkencës në një procedurë për ndarjen e kontratës për prokurim publik, në përputhje me Ligjin për prokurim publik. Përveç këtij rangimi, në interes të zhvillimit dhe ruajtjes së kualitetit në arsimin e lartë, në çdo tri vite, patjetër realizohet edhe rangimi i veçantë edhe i instituteve të pavarura shkencore të cilët zhvillojnë veprimtari të arsimit të lartë, në përputhje me këtë ligj.

Një ndër risitë që parasheh ky ligj, e që ishte dispozitë që figuronte edhe në ligjin ekzistues të arsimit të lartë, por që kishte afat të prolonguar implementimi, është e drejta për organizim të studimeve të ciklit të tretë të studimeve, të njohura si studime doktorature. Sipas këtij Ligji, programe studimore nga cikli i tretë i studimeve mund të organizojnë vetëm universitete të cilat janë të ranguar në mesin e shtatë universiteteve të regjistruara në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë në vend, të dala nga rangimi i fundit i tyre. Një propozim i tillë është thik me dy tehe dhe nuk pasqyron gjendjen më të duhur për përcaktimin e kualitetit. Ndoshta, zgjidhje më e mirë do ishte të përcaktohet standarde, kriteret dhe mekanizma tjerë për një "prerje" të tillë akademike.

Në këtë propozim të ri ligjor, definohet prerazi edhe kushti për funksionim të një programi të ri studimor, respektivisht të marrjes së lejes për punë të tij. Kushti konsiderohet i plotësuar për punë në raport me institucionin e arsimit të lartë, po që se në universitet janë të zgjedhur mësimdhënës, në thirrje arsimore-shkencore, shkencore dhe në ato arsimore, në marrëdhënie të plotë të rregullt pune, që sigurojnë mbulim dhe realizimin e më së paku 70% nga orët mësimore të parashikuara në programin studimor për të cilin program kërkohet akreditim (leje për punë), kurse të kenë të siguar edhe më së paku 10 persona me thirrje arsimore-shkencore, në marrëdhënie të plotë të rregullt pune, në çdo fakultet në përbërje të institucionit të arsimit të lartë që kërkon akreditim të programit studimor.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Çmimi për regjisorin më të mirë iu nda Kushtrim Bekteshit për shfaqjen "Ata që ikin". Duke qenë se regjisor Bekteshi vjen nga Shkupi, ai tha ky çmim përveçse e gëzon atë përmban një simbolikë shumë të rëndësishme se MRKS, hapësirën kulturore shqiptare e sheh si tersi

## ÇMIMI PËR "REGJISORIN MË TË MIRË" SHKON TE KUSHTRIM BEKTESHI



cmim falënderoi ministrin dhe jurinë për ndarjen e këtij çmimi, e veçmas Fatos Berishën, regjisorin e shfaqjes "Armiku i Popullit". Regjisor Fatos Berisha tha se është nder i madh që ta pranoi këtë çmim.

"E falënderoi Teatrin e Prizrenit që ma ka dhënë mundësinë së pari, për mua si regjisor dhe ideator i projektit, ky është gëzimi më i madh por mendoj që falënderimi duhet të shkojë për gjithë ekipin e shfaqjes", u shpreh Berisha sot në ceremoninë e ndarjes së çmimeve.

Çmimi për regjisorin më të mirë iu nda Kushtrim Bekteshit për shfaqjen "Ata që ikin". Duke qenë se regjisor Bekteshi vjen nga Shkupi, ai tha ky çmim përveçse e gëzon atë përmban një simbolikë shumë të rëndësishme se MRKS, hapësirën kulturore shqiptare e sheh si tersi.

"E falënderoj jurinë profesionale dhe nuk mund mos ta falënderoj edhe drejtorin e Teatrit të Prizrenit, Fetah Paçarizin me të cilin çdo herë që bëj shfaqje, e dëshmon se është një menaxher i jashtëzakonshëm. Është hera e dytë që unë punoj në Teatrin e Prizrenit dhe është hera e dytë që shpërblehem", u shpreh Bekteshi

Çmimi për vepër jetësore iu nda aktore Myrvete Kurtishi, ndërsa Çmimi për shfaqjen më të mirë Teatrit të Qytetit të Prizrenit "Bekim Fehmiu", për shfaqjen "Armiku i Popullit" të Fatos Berishës.

Ministri i Kulturës, Kujtim Gashi tha se këto çmime janë ndarë nga një juri shumë profesionale për të shpërblyer artistët që kanë kontribuar në aktivitetet e teatrit.

"Ministria e Kulturës dhe unë si ministër do të jemi vazhdimisht në përkrahjen e juaj në vazhdimësi edhe përmes ndarjes së çmimeve vjetore por edhe përmes rrugëve të tjera alternative që të keni mbështetje të krijimtarisë tuaj", u shpreh ministri Gashi, i cili më tutje i uroi të gjithë aktorët që po e mbajnë gjallë kulturën dhe tea-

trin. Myrvete Kurtishi, mes emocioneve të shumta pranoi Çmimin për Vepër Jetësore ndërsa tha se për gjithë dyzetë vite ka pritur për këtë çmim.

"Ndoshta kisha dalë para një mijë personash për ta dhënë shfaqjen, pa mu dridhur duart dhe goja por kjo është sakrificë ime për dyzetë vite", u shpreh Myrvete Kurtishi, e cila falënderoi të gjithë bashkëpunëtorët që e kanë përkrahur gjatë gjithë karrierës së saj për katër dekada.

"Falënderoj edhe publikun tim i cili më ka rrit, më ka kriju, më ka frymëzuar dhe më ka prurë deri në këtë moment që t'i fitoi këto", tha

ndër të tjera aktorja.

Çmimet janë ndarë nga juria e përbërë nga Vlora Nikçi, Luan Daka, Nëntor Fetiu, Mirsad Ferati dhe Liridon Cahani. Luan Daka, përfaqësuesi i jurisë tha se dhjetëra role të shkëlqyeshme të aktore Kurtishi në Teatrin e Gjakovës dhe në teatro të tjera e bëjnë atë bartëse të denjë për çmimin për vepër jetësore.

Çmimi për shfaqjen më të mirë iu nda Teatrit të Qytetit të Prizrenit "Bekim Fehmiu", për shfaqjen "Armiku i Popullit" me regji të Fatos Berishës. Fetah Paçarizi, Drejtori i Teatrit të Prizrenit "Bekim Fehmiu" derisa pranoi këtë



## Mit'hat Frashëri parashihte çlirimin e Kosovës në veprën e tij

Vepra historike të botuara në shtypin periodik prestigjioz të Parisit, Londrës, Brukselit e Gjenevës, por edhe çështja e Epirit, marrëdhëniet e Shqipërisë me Italinë, Turqinë dhe marrëdhëniet shqiptaro-sllave, shohin dritë në vëllimin e dytë dedikuar veprës së Mit'hat Frashërit.

Nipi i Abdyl, Sami e Naim Frashërit, ligjërimet e Mit'hat Frashërit, figurës historike në mbrojtjen e çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris dhe Lidhjen e Kombeve nën cilësinë e Kryetarit të Delegacionit Shqiptar, vijon për lexuesin për herë të parë nën optikën e një njeriu avangardë, që e shihte të ardhmen e Shqipërisë, shumë vite përpara.

"Ai sa një njeri që parashikon ngjarjet, është një parashikues gjenial i zhvillimeve historike në Shqipëri, parashikon edhe çlirimin e Kosovës, parashikon edhe zhvillime të tjera shqiptare, por në këtë botim veçoj shqetësimin e tij të madh për çështjen çame, që është edhe aktuale sot dhe pastaj relacionet e marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Greqisë, një kontribut shumë i madh, por edhe një mësim shumë i madh për politikën, për historinë, por edhe qytetarinë shqiptare", tha Uran Butka, shkrimtar, studiues. Butka shton se nga vepra e pasur e Lumo Skëndos janë ende 13 vëllime të tjera të pabotuara si edhe një biografi e tij.

## U promovua romani "Kufiri" i Luan Starovës

Në Bibliotekën e qytetit "Braça Milladinovci" është promovuar romani "Kufiri" nga akademiku Luan Starova.

"Kufiri" është libri i gjashtëmbëdhjetë i sagës ballkanike, punë e rëndësishme letrare për kufijtë ballkanikë, për përfshirjen e tyre në fatin e njerëzve dhe ajo, në teksturën e saj intime, dëshmon për tragjedinë ballkanike", kumtoi Biblioteka në paralajmërimin e promovimit.

Laun Starova (1941) është au-



tor i 16 romaneve, të cilat e përfshijnë sagën ciklike, e cila nga autori është emëruar "Saga bal-

lkanike". Romanet e tij janë përkthyer në shumë gjuhë, ndërsa për veprën e tij letrare

është fitues i shumë çmimeve prestigjioze vendore dhe të huaja.

Është fitues edhe i mirënjohjes prestigjioze franceze Komandat nga radhët e artistëve dhe letrarëve dhe të dekoratës franceze – Oficer kombëtar i legjionit të nderit. Shkruan në gjuhën shqipe si gjuhë amë, maqedonase dhe frënge.

Për romanin më të ri të Luan Starovës ka folur studiuesja e letërsisë prof.dr. Elizabeta Sheleva.

## U HAP EDICIONI I VI-të I FESTIVALIT TË MUZIKËS SERIOZE

Në Tetovë ka hapur siparin edicioni i VI-të i Festivalit të muzikës serioze, organizuar nga Skena e Muzikës Serioze Shqiptare. Hapjen solemne e ka bërë sekretari shtetëror në Ministrinë e Kulturës Valmir Aziri Aziri, siç thuhet në kumtesë, përshëndeti të pranishmit dhe përgëzoi organizatorët për punën e tyre të palodhshme të cilët vite me radhë i shtojnë skenës kulturore emra me peshë dhe mes tjerash ai potencoi që Ministria e Kulturës në vazhdimësi do të jetë mbështetje e të bukurës dhe pasurimit të kulturës shqiptare duke ofruar maksimumin për artistët të cilët japin kontribut të madh në këtë drejtim. Orkestra që perfor-



moi gjatë natës së kaluar ishte "West Coast Symphony" nga Vankuver, me dirigjent Bujar Llapaj, solistë Xhulia Nolan – saksofon, Guineth Xhons – klarinet dhe Xhim Hopson – trombon.

Publicitet

Organizata humanitare Ogranok na M.I.H.O. Tetovë, në bazë të vendimit IS/2018/8-1 bën shpallje publike për ndërmarrjet që merren me tregti të produkteve ushqimore, për dorëzimin e ofertave për paketa me produkte ushqimore në kuti prej kartoni në dimensione të përshtatshme për të paketuar përmbajtjen e pakos si vijon në bashkëngjitjen më poshtë.

Artikujt ushqimorë për projektin Ramazani 2018

nr	Artikulli ushqimor	Marka	Sasia (kg/litar)	Çmimi për kg	total
1	Miell		5KG		
2	Vaj Ushqimor		3Litra		
3	Sheqer		3 copa 0.9 kg		
4	Oriz		5 copa 0.9 kg		
5	Krip		1kg		
6	Fasule		2 copa 0.9 kg		
7	Makarona		6 copa 0.35 kg		
8	Fide		2 copa 0.40 kg		
	Gjithsej				

Sasia e pakove është afër 1500 copë. Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësohen nga ana e kompanive që do të dorëzojnë ofertat janë: Çmimi duhet të jetë me transport deri në destinacionin e caktuar sipas nevojës ku do të bëhet shpërndarja e pakove shfrytëzuesve. Vendosija e Logos së Organizatës nëpër pakot e ushqimit. Koha e realizimit Maj 2018. Për detaje të tjera tel. kontakt (044/332-554). Ofertat të dërgohen në adresën Ogranok na MIHO Tetovë. Rruga 134, Nr 12, në Tetovë me rekomandim në afat deri më 29.03.2018.

Nga Drejtorja

Për gazetën KOHA ka rrëfyer edhe njëherë emocionet e fitores ndaj Skander Hakimi, por edhe rrugëtimin e tij të deritanishëm, përgatitjet dhe mbështetjen që e ka nga menaxheri dhe klubi i tij, por jo edhe nga shteti i Maqedonisë. Në fillim, 19-vjeçari edhe njëherë rrëfeu emocionet për fitoren ndaj kik-boksierit nga Afganistani, por që garon për shtetin e Zvicrës, Skander Hakimi

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 28 mars - Javën e kaluar, kik-boksieri i talentuar nga Shkupi Hadis Ramadani, e arriti fitoren e dhjetë nga gjithsejtë dhjetë meçet prej kur nga ai amator, filloi të garojë si profesionist. Me rezultatin 2-1, Ramadani mundi kik-boksierin Skander Hakimi, duke vazhduar kështu serinë e fitoreve dhe duke rritur kështu vetëbesimin për sfidat që e presin. Ai për gazetën KOHA ka rrëfyer edhe njëherë emocionet e fitores ndaj Skander Hakimi, por edhe rrugëtimin e tij të deritanishëm, përgatitjet dhe mbështetjen që e ka nga menaxheri dhe klubi i tij, por jo edhe nga shteti i Maqedonisë. Në fillim, 19-vjeçari edhe njëherë rrëfeu emocionet për fitoren ndaj kik-

RAMADANI TREGON EMOCIONET E FITOREVE NË KIK-BOKSIN PROFESIONIST

# JAM I FASCINUAR



**Përkundër rezultateve të shkëlqyeshme që po i arrij në sportin e kik-boksit, nuk kam ndihmë nga askush, përfshi këtu edhe Agjencinë për Rini dhe Sport. Sinqerisht nuk dua të merrem me këtë gjë, këtë ua lë atyre që drejtojnë këtë institucion (Agjencinë për Rini dhe Sport), e imja është të vazhdoj me këtë temp. Realisht unë e përfaqësoj Maqedoninë dhe realisht duhet të më kishin ftuar deri më tani, por as që janë interesuar**

boksierit nga Afganistani, por që garon për shtetin e Zvicrës, Skander Hakimi. "Meçi siç e dini u zhvillua në Folkecvill të Zvicrës, ndaj një kundërshtari i cili deri para përballjes me mua kishte nëntë meçe profesionale dhe bëhej fjalë për një kik-boksier shumë të fortë, i cili dallohej për luftën me këmbë. Aj me prejardhje është nga Afganistani, por meçet i zhvillon për Zvicrën. Fitova me rezultatin 2-1, një rezultat i ngushtë, por falë goditjeve të mia, arrita të fitoj. Në fakt meçi zgjati tre runde, ku raundi i parë më takoi mua, në të dytin kundërshtari ishte më i mirë, por siç thash me një goditje të mirë në raundin e tretë 'high kick', fitova pikën që më solli fitore, respektivisht të dhjetën nga po aq meçe", sh-

prehet Ramadani, i cili shfrytëzon rastin të falënderon të gjithë ata që e përkrahën në natën e mbrëmjes, por edhe ata të cilët kanë uruar më pas atë për fitoren. "Siç e dini meçi u zhvillua në Zvicër, para një numri të madh, rreth dy mijë shikues, ku pothuajse të gjithë ishin shqiptar. U krijua një atmosferë shumë e mirë, ku gjatë tre rundeve nuk më mungoi përkrahja dhe kjo bëri që unë të jap maksimumin dhe përkrahjen që ma dhanë tua rikthej me fitore. Më vjen keq edhe të tjerët që jetojnë në Shkup dhe gjithë ata tifoz që i kam, nuk patën mundësi përkundër paralajmërimeve, ta shohin ndeshjen drejtpërsëdrejti, e gjithë kjo për shkak të problemeve teknike me të cilat u ballafa-

qua organizatori. Megjithatë, ata nuk nguruan të më urrejnë me mesazhe dhe komente në faqen time zyrtare në 'Facebook'. I falënderoj të gjithë nga zemra dhe ju premtoj

fitore të reja", shtoi më tej kik-boksieri shkupjan. Ndryshe, Hadisi pranon se nuk e kishte pritur një seri të gjatë të fitoreve prej kur filloi të garojë si profesionist, ndërsa premtonte se nuk do të ndalet me kaq dhe se menjëherë ka filluar përgatitjet për meçin e radhës. "Dhjetë meçe, dhjetë fitore, jam i fascinuar. Kur u shpërngula nga meçet amatore në ato profesionale, hyra me bindjen që mos të humbi asnjë meç. Të jem i sinqertë nuk e kisha pritur që në dhjetë meçet të kem po aq fitore, por në çdo meç kam dhënë maksimumin dhe fitoret vinin një pas një. Derisa, presidenti i 'Eku' është Skender Shahini, të cilin e kam edhe menaxher dhe i cili i organizon meçet e mia në Zvicër. Ai planifikon që në muajin maj të kem meçin e radhës, por deri atëherë do të shohim, me rëndësi është që unë jam i gatshëm për sfidat e reja". Në fund, Ramadani tha se përkrahjen e vetme e ka nga menaxheri Skender Shahini, ndërsa nuk mungon edhe përkrahja nga klubi i tij dhe trajneri Andrej Georgiev. "Përkundër rezultateve të shkëlqyeshme që po i arrij në sportin e kik-boksit, nuk kam ndihmë nga askush, përfshi këtu edhe Agjencinë për Rini dhe Sport. Sinqerisht nuk dua të merrem me këtë gjë, këtë ua lë atyre që drejtojnë këtë institucion (Agjencinë për Rini dhe Sport), e imja është të vazhdoj me këtë temp. Realisht unë e përfaqësoj Maqedoninë dhe realisht duhet të më kishin ftuar deri më tani, por as që janë interesuar. Gjitha meçet që janë mbajtur deri më tani, është përkujdesur menaxheri im, ndërsa prapa kam edhe klubin dhe trajnerin tim", përfundoi Hadis Ramadani, kik-boksieri nga Shkupi.

## Mavraj përfundon te skuadra e dytë e Hamburgut!

Trajneri i Hamburger SV, Kristian Titz (46 vjeç), po mundohet të ushqejë shpresën e mbetur për mbijetesë në Bundesliga, teksa rrezikon shumë. Pas mesfushorit Valas, mbrojtësi qendror shqiptar, Mërgim Mavraj (31 vjeç), nga tani e tutje dhe deri në një urdhër të mëtejshëm do të stërvitet me U-21 të klubit. Kjo gjë është lojtarit të kombëtares së Shqipërisë nga shefi i përkohshëm sportiv, Tomas von Heesen, dhe drejtori sportiv, Bernhard Peters. "Për arsyet e stërvitjes, drejtuesit e ekipit ven-

dosën të mos luajë Mërgim Mavraj, që nga sot. Prandaj, ne e kemi udhëzuar atë të vazhdojë trajnimin me U-21 deri në një njoftim tjetër", - tha Peters. Ndryshe, Mavraj ka bërë këtë sezon 17 paraqitje në Bundesligë, teksa në miqësoret parsezonale krijoi me Kyriakos Papadopoulos dueti e qendrës së mbrojtjes së Hamburger SV, por më pas humbi terren dhe së fundi nuk po aktivizohet thuhet fare. Dërgimi te U-21 duket se e mbyll sezonin për 31-vjeçarin.



## Libri i ndeshjeve të trukuara, të përfshirë edhe shqiptarë

Libri më i ri i dalë në tregun suedez, "Match Fixing", flet për lidhjet e forta mes mafies ballkanase me futbollistët e kategorive të ndryshme në kampionatet suedeze. Në ndikimin e rezultateve, rolin kryesor e luajnë mafiozë me origjinë shqiptare, kosovare, boshnjake dhe serbe. Të gjithë janë personazhe të njohur për organet e rendit në Suedi. Gazetarët kanë udhëtuar në Shqipëri dhe Kosovë, ku kanë gjetur agjentë të futbollistëve me origjinë nga Ballkani, të cilët janë të dyshuar nga policia suedeze për ndikime në rezultatet e ndeshjeve. Investigimi i gazetarëve suedeze nxjerr në pah se të përfshirë në ndikimin e ndeshjeve në Skandinavi janë edhe drejtues të lartë në futbollin shqiptar dhe në Kosovë. Pjesë e investigime-

ve të kryera nga Magnus Svenungsson dhe Jens Littorin ishte edhe ish-gazetari i "Fiks Fare", Ervin Dushi (V.O), i cili bëri të mundur kontaktet me futbollistët nga Shqipëria, Kosova e Bosnja, si dhe intervistimin e një pjesë të tyre në vendet përkatëse. Në "rrjetën" e gazetarëve nuk mungojnë as arbitrat, të cilët nuk ngurrojnë të japin penallti të drejta apo faulle inekzistentë. Rasti më domethënës është edhe arbitri me origjinë boshnjake, i cili në bashkëpunim me shqiptarin nga Kosova, D.B, fiksojnë ndeshje të kategorive të dyta me shuma nga 10 deri në 50 mijë euro. Pas investigimeve të kryera dhe publikimit të tyre nuk kanë munguar kërcënimet nga elementë kriminalë me banim në Suedi dhe Shqipëri.







Esigurt është se, në momentin kur një nga klubet e mëdha do të sigurojë shërbimet e njërit prej trajnerëve, pjesa tjetër do të bëjë të njëjtën gjë me një lëvizje të qartë të "efektit domino". E njëjta gjë ndodh me lojtarët e mëdhenj, që lakohen në merkato, si Robert Levandovski, Eden Hazard, Paulo Dybala, Harry Kin dhe të gjitha yjet, që dëshirojnë klubet e mëdha evropiane

"EFEKTI DOMINO" I TRAJNERËVE PËR GJIGANDËT E EVROPËS



# ME VALIXHE NË DUAR

Luis Enrike, ish-trajneri i Barcelonës, tashmë ka përfunduar turneun e tij në Afrikën e Jugut, ku mori pjesë në "Cape Epic", testin e biçikletës malore, që e ngacmon shumë atë. Tani, pas kthimit, ai do t'i shqyrtojë përsëri ofertat që ka në tryezë. Siç është raportuar edhe më parë në mediat iberike, "Lucho" ka në plan të kthehet në stol dhe do të donte ta bënte këtë në Premier Ligë, ku, kryesisht, Çellsit, por edhe Arsenalit, kanë qenë të interesuar për të. Këto dy klube, së bashku me PSZH, janë tri entitete, që kanë bërë lëvizje të qarta pranë trajnerit asturian. Pavarësisht nga thashethemet, duket se Bajern Munihi nuk ka lëvizur drejt tij, sepse Luis Enrike nuk di gjermanisht dhe kjo është themelore për bavarezët. Ish-trajneri i skuadrës katalanase dëshiron, nëse është e mundur, të çojë përpara mbylljen e negociatave me klubin e tij të ardhshëm, për të qenë në gjendje të formojë ekipin dhe të fillojë përgatitjen e sfidës së re. Në rastin e klubit parisien, Luis Enrike kishte mbështetjen e Nejmarit, edhe pse shumë thanë ndryshe. Nejmar i tha presidentit Nasser Al Khelaifi, në takim që mbajtën në Brazil, se nuk kishte asnjë problem me të. Ai foli shumë mirë për "Lucho" si një trajner i mundshëm për PSZH. Buri met e afërta me sheikun e Katarit,

Tamim bin Hamad Al Thani, nuk e mohojnë praninë e asturianit në Doha, disa javë më parë.

Por, situata e Luis Enrikes është praktikisht e njëjtë si ajo e Karlo Ancelotit, trajnerit prestigjioz italian, i cili do të rikthehet në Premier Ligë, aty ku ka drejtuar Çellsin më parë. Ish-trajneri i Real Madridit dhe Bajern Munihi, ndër të tjera, ka marrë vend-banim në Londër, me gruan e tij, që është me origjinë spanjolle, Mariann Barrena. Ai do të donte të kthehej në stolin e "Stamford Bridge", ku mban një marrëdhënie të mirë me Roman Abramoviç, ose të marrë përsipër postin e trajnerit në "Emirates", ku duket se orëve të Arsen Venger në stolin e Arsenalit po u vjen fundi. Çuditërisht, madje edhe për disa ditë, PSZH ka trokitur në derën e tij, sepse disa lojtarë, si Marko Verratti dhe Tiago Silva avokuan rikthimin e italianit në "Parc des Princes". Por, as drejtori teknik, Antero Henrique, as presidenti Nasser Al Khelaifi, madje as sheiku i Katarit, nuk kanë shfaqur ende interes konkret. Në Itali po flasin për angazhimin e

Ancelotit në krye të kombëtares axurre, por ai ka një handikap, se dikur i tha "jo" ish-presidentit të "Feder calcio", Karlo Taveçio.

Interesante është situata e Antonio Kontes, i cili nuk po ecën shumë mirë këtë sezon në Premier Ligë. Ai është një nga trajnerët më të çmuar në këtë listë të improvizuar të teknikëve me valixhe në duar. PSZH ka folur direkt me të përmes Antero Henrique. Ata kanë diskutuar mbi projektin e ri dhe kanë folur edhe për çështjet ekonomike. Po ashtu, ish-trajneri i Juventusit ka një mundësi rikthimi në krye të axurrëve, me të cilët bëri mirë në të kaluarën e afërt, që kulmoi me paraqitjen në "Euro 2016". Antonio Conte është në rreshtin e parë për të trajnuar PSZH, edhe pse nuk është i vetmi kandidat.

Antero Henrique ka negociuar, gjithashtu, me Hoze Murinjo, aktualisht në drejtimin e Mançester Junajtedit, por që nuk e sheh të ardhmen e tij vetëm në Premier Ligë. Marshimi i Murinjos do të ishte një tërmet dhe e vërteta është se portugezi tashmë ka nisur të pu-

nojë për sezonin e ardhshëm, duke piketuar përforsimet e mundshme në merkaton e verës.

PSZH ka vlerësuar edhe mundësinë e marrjes së shërbimeve të Mauricio Pochettino, ish-lojtar i parisienëve, por argentinasi preferon të qëndrojë te Totenhemi. Prej andej, vetëm Real Madridi do ta merrte atë, me lejen e presidentit Daniel Levy. Por, tani për tani nuk është e qartë nëse Zinedin Zidan e përmbush apo jo kontratën e tij në stolin e "Los Blancos". Ka edhe dy trajnerë të shumëkërkuar, por me kontrata ekzistuese, të tillë si Masi miliano Allegri (Juventus) dhe Diego Pablo Simeone (Atletiko Madrid). Ata janë autentikë, të lakmuar nga drejtuesit e PSZH. Allegri dhe Simeone i pëlqejnë presidentit Nasser Al Khelaifi, sepse janë në gjendje të "qeverisin" një grup të komplikuar, siç është klubi francez, me shumë figura dhe klane kundërshtarë. Duket se PSZH ka arritur nevojën urgjente për të vënë në jetë rezultatet e kërkua, pas dështimit të "Champions"-in e këtij edicioni. Përmendje të veçantë

meriton edhe gjermani Tomas Tuçel, ish-trajneri i Borussia Dortmund, i cili sapo i tha "jo" Bajern Munihi. Disa media gjermane flasin për të, duke e parë si zëvendësues të Arsen Venger në stolin e Arsenalit, por asgjë nuk është përfundimtare. Ai mbetet, gjithashtu, nën interesimin e drejtuesve bavarezë, që duhet të mbushin boshllëkun e lënë nga Jupp Heynkes në fund të këtij sezoni.

E sigurt është se, në momentin kur një nga klubet e mëdha do të sigurojë shërbimet e njërit prej trajnerëve, pjesa tjetër do të bëjë të njëjtën gjë me një lëvizje të qartë të "efektit domino". E njëjta gjë ndodh me lojtarët e mëdhenj, që lakohen në merkato, si Robert Levandovski, Eden Hazard, Paulo Dybala, Harry Kin dhe të gjitha yjet, që dëshirojnë klubet e mëdha evropiane. E njëjta gjë do të ndodhë me portierët, sepse njëri është duke pritur tjetrin, me katër "gardianë" kryesorë në "ankand", Thibaut Kurtoa (Çellsit), David de Gea (Mançester J.), Donnarumma (Milan) dhe Allison Beker (Roma).

NJË LIBËR ZBULON TË FSHEHTAT E PSZH-së

## Përmbysja e Barcelonës dhe Sarkozit pas Nejmarit

Nuk ka mjaftuar zhgënjimi i radhës në Champions për ta trazuar ambientin te PSG-ja. Së shpejti do të publikohet një libër, që do të hedhë dritë mbi atë që kurrë më parë nuk është thënë dhe nuk është shkruar. "PSG, zbulimet e një zbulimi" është libri që del nesër në treg nga "Paris United", një grup tifozësh të klubit parisien, i lindur për të luftuar mediat pro PSZH-së. Në këtë libër flitet për një anarki të

plot në dhomat e zveshjes, që presin shpesh njerëz nga më të ndryshmit, të afërm të lojtarëve që futen për të bërë "selfie", duke shpërqendruar ekipin. Ka të dhëna gjithashtu për përmbysjen e madhe të Barcelonës sezonin e kaluar, ku trajneri Emeri i kërkon falje Kimpembes që nuk e aktivizoi në "Camp Nou" në vend të Tiago Silvës krejtësisht jashtë forme, në mënyrë që ky i fundit të mos

humbiste besueshmërinë në grup. Flitet edhe për doktorë që tymosin cigare bashkë me lojtarët, mes tyre edhe Verratti. Por zbulimi më i madh është ai i blerjes së Nejmarit, që përfshin edhe Nikolas Sarkozit, ish-presidentin e Francës, i cili ka ndërhyrë te Ministri i Sporteve për të mos u marrë me paratë që vijnë nga Katarit për transferimin e lojtarit brazilian nga Barcelona.



**DASHI** 21. mars - 20. prill  
Nuk do të ketë komplikime në jetën tuaj në çift. Një zhgënjim do t'ju çojë në disa grindje me partnerin/en, por për fat të mirë ju do të kuptoni se situata është e zgjidhshme. Beqarët do të duhet të heqin qafe kujtimet e vjetra për të jetuar përvoja të reja. Ditë e rëndësishme për të gjetur kontakte të reja profesionale. Zgjeroni gamën tuaj dhe bëni biznes.

**DEMI** 21. prill - 21. maj  
Nëse nuk doni probleme në dashuri, jini të kujdesshëm në atë që thoni. Kthimi i një pushtimi të së kaluarës do të hedhë hije në marrëdhëniet dhe marrëveshja mund të ndikohet. Beqarët sot do të jenë magnetikë dhe do të jenë në gjendje të bëjnë takime të veçanta me njerëz interesantë. Në punë do të tregoheni shumë energjik.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor  
Ditë e ndritshme, ju jeni shumë energjik dhe të pasionuar dhe do të tregoni anën tuaj të butë për të dashurit, duke pasur parasysh projektet e rëndësishme për të ardhmen së bashku! Për beqarët, takime të reja janë të mundshme, disa prej të cilave mund të jenë shumë interesante. Dikush do t'ju kritikojë dhe nuk do të humbasë mundësitë për t'ju vënë në një dritë të keqe.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik  
Vendosni një porosi të vogël në jetën tuaj dhe jepini përparësi maksimale gjërave më të rëndësishme: bëjeni gjithçka për të gjetur ngrohtësinë në marrëdhënien në çift, Venusi është në anën tuaj. Beqarët do të kenë më shumë besim në vetvetë. Mos i kushtoni vëmendje thashethemeve të zhvendosura nga një koleg ziliqar. Ka qaq shumë që dëshirojnë të jenë në vendin tuaj!

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht  
Sot do të keni mundësi të shkëlqyeshme për të parë njerëz që nuk i keni parë për një kohë të gjatë. Në dashuri duhet të dëgjoni nevojat e personit që doni për të shmangur keqkuptimet. Zemrat e vetmuara duhet të jenë më të vëmendshme ndaj miqësive që ndërrojnë në rrjetet sociale. Shumë situata do të kthehen në favorin tuaj edhe nëse dikush përpiket të vendosë shklopinj nën rrota.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator  
Dashuria sot ju rezervon momente pasioni dhe butësie. Ato janë pak, por për fat të mirë janë të drejta. Beqarët nuk duhet të humbasin shpresën teksa janë në kërkim të shpirtit të tyre binjak, shikoni përreth, ndoshta është afër! Ju keni një forcë të jashtëzakonshme për të përballuar vështirësitë në punë dhe madje problemet e mëdha nuk ju trembin.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor  
Në zemrën tënde ka ndjenja kundërshtuese dhe është rasti të reflektohet për të kuptuar atë që dëshiron. Nëse jeni çift ju do të duhet të përpiqeni dhe të merrni njëfarë hapi në marrëdhënien tuaj. Njohje të reja po vijnë për beqarët, të cilat mund të jenë vendimtare për dashurinë. Do të keni një shans të mirë për të kryer një projekt me sukses.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor  
Disa keqkuptime me partnerin/en do të bëjnë që të lëvizni. Ju ndiheni të hutuar dhe çdo gjë shfaqet në një dritë tjetër. Edhe ata përreth jush mund të krijojnë probleme. Sot beqarët do të realizojnë shumë takime. Lajmi i mirë do të sjellë qetësi për ta. Mos u dorëzoni në atë që keni kryer me vështirësi. Edhe nëse ka pasur disa ngjarje të papritura, së shpejti do të keni kënaqësitë tuaja.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor  
Ndoshta nuk është dita më e mirë për të kërkuar një sqarim në fushën sentimentale, por duhet patjetër të bëni diçka për të sqaruar dyshimet tuaja. Beqarët do të vlerësohen dhe mund të bëjnë takime interesante. Përqendrohuni vetëm në atë që premtori t'ju japë rezultate dhe ndërkohë reflektojnë në një ofertë pune të mirë.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar  
Do të ndiheni si jashtë "orbite" dhe nuk e kuptoni pse, por mos i nënvlerësoni reagimet e partnerit/es që mund t'ju bëjnë nervoz. Për beqarët do të ketë mundësi të shkëlqyera për të marrë një ftesë interesante për mbrëmjen. Ka të gjitha kushtet për një flirt intrigues! Në punë ju do të merrni shumë më tepër nëse rrisni angazhimin tuaj. Diçka duket të lëvizë në horizont.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt  
Sot do të jeni i guximshëm dhe do të habitni partnerin/en me disa lajme. Nëse keni qenë në një marrëdhënie për një kohë të gjatë, do të forconi edhe më shumë lidhjen me diçka të papritur. Beqarët do të kenë probleme me disa miqësi, por në mbrëmje gjithçka do t'i kthehet normalitetit. Kënaqësi të shkëlqyera në sferën e punës.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars  
Vendime të shtyra për disa çështje shumë delikate. Në vend të kësaj, kushtojini vëmendje gjërave të vogla për të rimarrë një marrëdhënie që është gati të degjenerohet. Beqarët do të duhet të tregohen të kujdesshëm në vendimet e tyre për të shmangur zhgënjimet në dashuri. Sot Mërkuri favorizon marrëdhëniet me kolegët. Është një moment i mirë për të forcuar lidhjet dhe bashkëpunimet e reja.



<b>KOHA</b>	NJË NGA TURNETË QË FITOJ TENISTJA NË FOTO, ... OPEN	KOMPANI KOZMETIKE E FRANCËS	LUMË NË RUSI	RUMANIA	BANORI I KËS NDRYSHIMI I ZËRIT, INTONACIONI				
VENDLINDJA E TENISTES NË FOTO								ALI ASLLANI	
SKLLAV				NJË PLANET					
ERBIUMI				QË LIDHET ME VESHËT DHE HUNDËN (MED.)					
GRUP MUZIKOR FINLANDEZ				EKIPI				AGIM POSHKA (TË) RRËZUARA	
EC ME TË META NË KEMBE						VEPRIMTARI ARTISTIKE			
<b>KOHA</b>	VEND QË ËSHTË NË TË DY ANËT E NJË LUMI, LUMARE					SHTETETË E BASHKUARA TË AMERIK.			AZOTI
AUSTRIA	ASTATI	FËMIJË (ITAL.)							ZVARRË, RRËSHQANTHI
ATI, BIRI DHE SHPIRTI I SHENJËTË		RENTGENI							ENERGJIA
								SHKURRE E VISEVE MALORE GJITHNJË E BLERTE	

ZGJIDHJET: T, XHAKA, VELIU, NILS, SHIRIT, F, AR, ETNA, RR, L, IKASI, FLORIDA, AA, ROB, NEPTUN, ER, OTO RINO, NEKTORI, AP, ÇALON, ARTE, LUMISHTË, N, A, BAMBINO, TRINIA, ASHE.

## Sudoku

shumë i lehtë

			6	2			5	
		9	3		5			4
	1		9					
	8					7	9	6
7								2
6	2	1					8	
					9		7	
9			4		6	2		
	6			5	3			

mesatar

								4		
	3	7						8		
	1							9	7	5
									2	
						6			3	
		6	9			5				
		9				6				
	7				9	4				
		2						1		8

Shumë i lehtë: 834621957, 279385164, 516947328, 485132796, 793568412, 621794583, 342819675, 958476231, 167253849. Mesatar: 982576413, 375418926, 146329758, 837194265, 251687394, 469253871, 593862147, 718945632, 624731589.

# Bebe Rexha thyen rekord, renditet e dyta në "SHBA"

Këngëtarja me origjinë shqiptare Bebe Rexha renditet këtë javë në vendin e dytë të këngëve më të suksesshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës duke u bërë kështu shqiptarja e parë që arrin majat e klasifikimit të Billboard Charts. Me hitin "Meant to Be" në bashkëpunim me grupin e muzikës Country Florida Georgia Line, Bebe Rexha ka lënë pas Ed Sheeran, The Weeknd apo Camilla Cabello. Në vendin e parë vazhdon të renditet Drake me God's Plan që nuk lëkundet nga kryesimi i kësaj liste prej disa javësh. Vlen për tu theksuar se Meant To Be e cila prej 16 javësh ndodhet në vendin e parë të "Hot Country Charts" është shkruar nga Bebe Rexha për albumin e saj All Your Fault dhe ka kapur majat e shitjeve në Australi, Zelandë e Re, Britani e Madhe.



## Zbulohet një "organ i ri" i trupit njerëzor



Sipas një studimi të kohëve të fundit, del se është etiketuar gabim një ind lidhës, për shkak të metodës së gabuar që është përdorur për ta ekzaminuar në mikroskop. Zbulimi revolucionar, publikuar në revistën "Scientific Reports" nga universiteti i New York dhe nga qendra mjekësore Mount Sinai Beth Israel, ka të bëjë me anatominë dhe zbulon ekzistencën e një "organi të ri", ndër më të mëdhenjtë në trupin njerëzor: membrana ndarëse. Etiketuar gjithnjë si ind lidhës, kjo lloj membrane ishte lënë "në hije" në kompleksitetin e saj, për shkak të metodave të përdorura për ta ekzaminuar në mikroskop, i cili e bënte të duket të dendur dhe kompakt. Kërkimi shkencor ndër kohë, nxjerr në pah që kjo membranë ndarëse është e shpërndarë në të gjithë organizmin: nën lëkurë dhe në mbështjelljen e aparatit tretës, tek mushkëritë, vena dhe muskuj. "Organi i ri" është i përbërë nga një zgavër plot likuide dhe e mbështjellë nga shumë fibra kolagjeni dhe elastine dhe kjo është arsyeja që, nga një anë reagon si amortizator dhe nga ana tjetër prania e tij mund të shpjegojë shumë fenomene biologjike si: përhapja e tumoreve, plakja e lëkurës, sëmundjet inflamatorë degjeneruese dhe madje edhe mekanizmin veprues të agopunçurës.

## Nëse doni të humbisni peshë, pini kafe



Një studim i ri ka vërtetuar teorinë që një filxhan kafeje mund të ndihmojë në rënien në peshë. Kafja, kanë zbuluar

shkencëtarët Shkencëtarët kanë zbuluar se kjo pije e ngrohtë të jep ndjesinë e ngopjes dhe njerëzit ndihen më pak të uritur, transmeton shendeti.com.al. Rezultatet e studimit, nga Universiteti Northwestern, mbështesin të dhënat e mëparshme se njerëzit që pinë dy filxhanë kafe në ditë mund të mos shojnë peshë. Studimi sugjeron se kafja ndihmon njerëzit për t'u dobësuar jo vetëm duke përshpejtuar metabolizmin, por edhe duke u shuar urinë. Gjatë studimit u analizuan efektet biologjike të kafes tek 47 njerëz, të cilëve iu kërkua që për një muaj të mos konsumonin fare kafe, muajin e dytë të konsumonin 4 filxhanë

dhe të tretin 8 filxhanë. Gjatë studimit 3-mujor u morën analizat e gjakut të konsumuesve të kafes. Shkencëtarët zbuluan se pas konsumimit të kafes, uleshin nivelet e disa përbërësve të prodhuar nga sistemi endokanabionid i trupit. Kafja gjithashtu ndihmon njerëzit për t'u dobësuar falë kafeinës, që përshpejton metabolizmin dhe ndihmon në djegien e shpejtë të dhjemit. Një studim i kryer nga Shkolla Mjekësore Hannover në Gjermani, në vitin 2015, ka zbuluar se përdoruesit e rregullt të kafes (që konsumojnë 2-4 filxhanë kafe në ditë) janë më të predispozuar që mos t'i marrin sërish kilet e humbura më parë.

## Bleu biletë për herë të parë, fiton "jackpot"-in

Një adoleshente kanadeze goditi që me të parën, duke fituar "jackpot"-in në ditën e saj të ditëlindjes. Charlie Lagarde nuk kishte blerë asnjëherë më parë një biletë lotarie, por vendosi ta provonte si për shaka, duke e shoqëruar edhe me një shishe shampanjë për të festuar ditëlindjen e saj të 18. Gërvishja e asaj bilete do t'i ndryshonte jetën. 18-vjeçarja fitoi dhe mund të zgjidhte, ose të pranonte shumën marramendëse të një milion dollarëve kanadezë (780 mijë dollarë, 550 mijë paund), ose të fitonte 1.000 dollarë në javë për të gjithë jetën. Charlie, pasi doli me një konsulent financiar, zgjodhi këtë të dytën. "Është pa taksa, kështu që është e barabartë me një pagë prej më shumë se 100 mijë dollarësh në vit, prandaj është një fillim i madh në jetë për atë zonjushë të re", tha Patrice Lavoie, zëdhënësi i korporatës së lotarisë. Vajza rrëfen se paratë e fituara kaq papritur dëshiron t'i përdorë për të udhëtuar, por edhe për një shkollim dinjitoz. "Dua të studioj fotografinë", shprehet ajo, duke shtuar se një nga ëndrrat e saj më të hershme është të punojë për "National Geographic".



1549 - Themelohet qyteti Salvador da Bahia, kryeqyteti i parë i Brazilit.  
1632 - Nënshkruhet Traktati i Saint-Germain ku ju jepet Kueboku francezëve pasi të jetë okupuar nga anglezët në vitin 1629.

1792 - Mbreti Gustav III Suedisë vdes pasi të jetë sulmuar prapa shpine në maskaradën e mesnatës në Operën mbretërore e Stokholmit.

1795 - Betoveni (24) debutoi si pianist në Vjenë.

1798 - Themelohet Republika e Zvicrës.

1827 - 20,000 njerëz marrin pjesë në funeralin e Ludwig von Beethoven në Vjenë

1831 - Kryengritja e madhe boshnjake: Rebelët boshnjak kundër Turqisë.

1849 - Britania e Madhe përvetëson Panxhabin.

1864 - Britania e Madhe i kthen lshujt Isotop Greqisë.

1949 - Turqia njeh Izraelin  
1994 - Serbet dhe Kroatët nënshkruajnë armëpushim për të ndaluar luftën në Kroaci.

2004 - Bullgaria, Estonia, Latvia, Lituania, Romania, Sllovakia dhe Sllovenia i bashkohen NATO si anëtare të plota.

2004 - Republika e Irlandës është shteti i parë në botë që ndalon pirjen e duhanit në të gjitha vendet e punës, duke përfshirë lokalet dhe restorantet. 2010 - Dy vajza vetëvrasëse me bombë sulmojnë Metronë e Moskës ku vdesin 40 persona.

Orizi është ushqimi kryesor për 50% e popullatës në botë.



Era nuk bën zhurmë po nëse nuk fryn kundrejt ndonjë objekti.

Në Amerikë hidhen 44 milion gazeta në ditë.



### Vampirët dhe Politika

Dy vampirë, babai dhe biri, bisedojnë me njëri-tjetrin.

Babai: Bir, sonte do të hymë në një shtëpi dhe do të pimë pakëz gjak, nesër do të hymë në një tjetër, pasnesër në një tjetër, e kështu me radhë.

Djali: Po mirë. E pse nuk hymë në një shtëpi dhe të pimë përnjëherë gjithë gjakun?

Babai: Mos u bëj ashtu, bir! Ne jemi vampirë, nuk jemi politikanë...



Çdo gjë që është e bukur dhe fisnike është produkt i arsyes dhe i llogaritjes.  
(Charles Baudelaire)



KALENDARI HISTORIK 29 MARS



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS